



# BASHKIA VAU-DEJËS

Plani i Përgjithshëm Vendor

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT (Draft)

---

Vau-Dejës 2017



**BASHKIA VAU-DEJËS**

**STRATEGJIA TERRITORIALE**  
**VIZIONI STRATEGJIK, OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT**

Maj 2017

# Parathënie

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të bashkisë Vau-Dejës mbështetet nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (DLDP) në Shqipëri, përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim (SDC). Në tetor të vitit 2016, në takimin e Komitetit Koordinues të DLDP, ambasadori zviceran Z. Kristof Garf, zyrtarizoi nismën për mbështetjen financiare dhe teknike që do i jepej bashkisë Vau-Dejës për hartimin e PPV. Në atë takim gjithashtu u firmos edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit mes MZHU, AKPT, DLDP dhe Bashkisë Vau-Dejës, si një hap i parë i që përshkruante kornizën e angazhimeve dhe bashkërendimit të aktorëve kryesorë në këtë proces.

Gjatë vitit 2016, Ministria e Zhvillimit Urban, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, ka mbështetur dhe bashkërenduar procesin e hartimit 26 PPV për bashkitë kryesore të vendit. Pavarësisht specifikave dhe kontekstit zhvillimor të secilës bashki të dalë pas Reformës Territoriale Administrative, këto dokumente, shumica prej të cilave të miratuara tashmë, kanë krijuar një bazë solide, orientuese dhe referuese, për të gjithë autoritetet vendore që përfshihen në procesin e planifikimit.

Iniciativa për hartimin e Strategjisë, në kuadrin e PPV-së, vjen si nevojë për një qasje të re në trajtimin dhe konceptimin e situatës aktuale, për t'i dhënë një rrugë zhvillimi të qëndrueshëm dhe të organizuar territorit të bashkisë Vau-Dejës, duke u orientuar drejt një vizioni afatgjatë dhe shumë dimensional të problemeve urbane dhe përdorimit e ruajtjes së burimeve natyrore.

Kuadri ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, përmes direktivave dhe orientimeve që jep, për hartimin e Planeve të Përgjithshëm Lokale, siguron që produkti final i këtij procesi të jetë një dokument orientues strategjik për zhvillimin e bashkisë në tërësi. Synimet dhe objektivat e PPV sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm të bashkisë në aspektin ekonomik, urban, mjedisor dhe çdo element tjetër të rëndësishëm për pesëmbëdhjetë vitet e ardhshëm.

Strategjia e zhvillimit të territorit pasqyron një shkallë ta lartë të përvojës dhe punës së kryer në nivel vendor, lokal e rajonal nga gjithë aktorët dhe specialistët e përfshirë. Ky dokument përpiqet të japë një kolazh shumë planesh dhe gjithëpërfshirës të faktorëve politikë, ekonomikë, socialë, rajonalë dhe kombëtarë që ndikojnë në mënyrë të tërthortë apo të drejtpërdrejtë ecurinë e Bashkisë Vau-Dejës në 15-20 vitet e ardhshëm. Përmes këtij dokumenti arrijmë të kuptojmë objektivat kryesorë të zhvillimit, sfidat mundësitë dhe rreziqet me të cilat ai do të përballlet, duke lehtësuar vendimmarrjen afatgjatë që do të shprehet më tej përmes PPV-së.



Ky dokument ndërtohet jo vetëm mbi bazën e analizave shkencore territoriale, por edhe si shprehës i nevojave dhe dëshirave të banorëve dhe grupeve të interesit në Bashkinë Vau-Dejës. Gjatë periudhës së hartimit janë zhvilluar shumë vizita në terren e në institucione publike, me qëllim grumbullimin sa më të efektshëm të informacionit.

Në vijim Bashkia do të punojë ngushtësisht me konsulentin për të kaluar hapat ligjore e teknike të hartimit të PPV-së dhe rregullores së tij. Finalizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor do të jetë një nga arritjet e para të kësaj bashkie të re, me dëshirën e vullnetin për të përballuar sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, së bashku me komunitetin, që është burimi dhe qëllimi final i këtij vullneti drejt të ardhmes.

Bashkia Vau-Dejës falënderon, së pari, të gjithë stafin e Bashkisë, në veçanti zyrën e planifikimit të territorit, për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve të dobishme të projektit. Të dhënat dhe njohuritë e zgjeruara të tyre, kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin sa më të plotë dhe të saktë të këtij dokumenti.

Së dyti, falënderon të gjithë përfaqësuesit e Njësisë Administrative, si dhe të palëve të interesit dhe qytetarëve të kësaj bashkie, që kanë qenë pjesëmarrës dhe aktivë në çdo Forum Këshillues.

Gjithashtu, i shpreh mirënjohjen DLDP dhe Ministrisë së Zhvillimit të Urban, për iniciimin e këtij procesi dhe mbështetjen e vazhdueshme, si dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, e cila në shumë raste ka dhënë ndihmesën e saj të vyer, gjatë hartimit të dokumentit të Planifikimit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vau-Dejës. Falënderojmë, veçanërisht, koordinatorët e projektit, që me bashkëpunimin e ngushtë, kanë ndihmuar në avancimin e punës për këtë dokument.

Së fundmi, falënderon konsulentin, UTS-01, për mbledhjen e të gjithë materialeve ekzistuese, për dokumentimin e tyre dhe për përditësimin e të dhënave, si dhe për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Territorial të Bashkisë.



# Shkurtime

AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
ASHA	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DIH	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësllës Kanalizimeve
DRB	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
INSTAT	Instituti i Statistikave (Shqipëri)
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KRRTRSH	Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mjedisit
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MZHETS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PDV	Plan i Detajuar Vendor
PKS	Plan Kombëtar Sektorial
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar (Zhvillimit të Territorit të Shqipërisë 2015-2030)
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
ToR	Terma Reference
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZMMTB	Zyra e Menaxhimit dhe Mbrotjes të Tokës Bujqësore
ZRPP	Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

# Lista e figurave

Fig. 1 Hartë veneciane e vitit 1571 e territorit të Vau-Dejës (Dagna).....	12
Fig. 2 Poli i zhvillimit rajonal Shkodër – Lezhë.....	17
Fig. 3 PPK – Skema e rrjetit të gazsjellësve në Ballkan.....	19
Fig. 4 PPK – Potencialet turistike të Mesdheut .....	21
Fig. 5 Fasha A – Det dhe Diell .....	22
Fig. 6 Fasha B – Bujqësia.....	23
Fig. 7 Fasha C – Histori dhe Kulturë.....	23
Fig. 8 Fasha D – Fasha detare .....	24
Fig. 9 Kategorizimi i turizmit sipas PINSB .....	35
Fig. 10 PBB i Shqipërisë për banor.....	37
Fig. 11 Zhvillimi i territorit nga deti në Alpe.....	46
Fig. 12 Njësitë administrative dhe shtrirja në territor .....	50
Fig. 13 Parimi i analizës SWOT.....	51
Fig. 14 Harta e flukseve në territorin e Bashkisë Vau-Dejës Tabela .....	63
Fig. 15 Ndarja në zona sipas shpejtësisë së erës dhe orëve vjetore.....	65
Fig. 16 Energjia diellore në Shqipëri.....	66
Fig. 17 Potenciali dhe konsumi i energjisë .....	70
Fig. 18 Hidrocentralet në territorin e Shqipërisë .....	71
Fig. 19 Fluksi i ujit .....	73
Fig. 20 Konsumi i ujit .....	74
Fig. 21 Prodhimet bujqësore .....	77
Fig. 22 Fluksi i ushqimit .....	78

Fig. 23 Fluksi i mbetjeve .....	80
Fig. 24 Koefficienti bruto i lindjeve (INSTAT, Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2016) .....	84
Fig. 25 Hartat e sistemit natyror .....	89
Fig. 26 Hartat e sistemit ujor .....	90
Fig. 27 Hartat e sistemit bujqësor .....	91
Fig. 28 Hartat e sistemit urban .....	93
Fig. 29 Hartat e sistemit infrastrukturor .....	94
Fig. 30 Pamje ajrore e qendrës urbane Vau-Dejës.....	95
Fig. 31 Hartat e vizionit strategjik.....	98
Fig. 32 Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm .....	108
Fig. 33 Harta e projekteve .....	111
Fig. 34 Parimi i “open government” .....	112



# Lista e tabelave

Tabela 1 Rritja e PBB në Shqipëri 2000-2014.....	38
Tabela 2 Parashikimi për rritjen e PBB në Shqipëri 2015-2021 .....	38
Tabela 3 Të dhëna për strukturën e tokës bujqësore sipas njësive administrative (Local Operational Development Plan Vau-Dejës, UNDP, 2016).....	40
Tabela 4 Fuqia dhe kapaciteti i hidrocentraleve në vend .....	64
Tabela 5 Popullsia banuese në Shqipëri (INSTAT, 2011).....	70
Tabela 6 Njësiti ekonomike familjare në Shqipëri sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje në zonat urbane dhe rurale (INSTAT, 2011).....	70
Tabela 7 Bilanci i energjisë elektrike, në rang vendi (INSTAT, 2011) .....	71
Tabela 8 Fermat në Bashkinë Vau-Dejës (QTTB dhe MBZHRAU, 2014).....	75
Tabela 9 Fermat bujqësor dhe blegtoral në Bashkinë Vau-Dejës .....	76
Tabela 10 Prodhimi bujqësor dhe blegtoral në Bashkinë Vau-Dejës.....	77
Tabela 11 Importi dhe eksporti i mbetjeve në Shqipëri.....	79
Tabela 12 Të dhënat e popullsisë.....	82
Tabela 13 Ndryshimi i popullsisë (INSTAT).....	83
Tabela 14 Popullsia 2000-2015 (Bashkia Vau-Dejës) .....	83
Tabela 15 Ndërhyrjet strategjike sipas objektiveve .....	100
Tabela 16 Strategjitë bazë.....	109

# Përmbajtja

1	STRATEGJIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT.....	13
1.1	PARATHËNIE PËR METODËN .....	13
1.1.1	Qasja strategjike.....	13
1.1.2	Vizioni në shkallë të ndryshme.....	14
1.2	DIREKTIVAT STRATEGJIKE TË PLANEVE KOMBËTARE .....	16
1.2.1	Projektet kryesore sipas PPK.....	16
1.2.2	Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin .....	19
1.2.3	Planet Vendore.....	25
1.2.4	Drejtimit e zhvillimit sipas pesë sistemeve .....	27
1.3	VIZIONI I PERSPEKTIVËS.....	37
1.3.1	Zhvillimi i ekonomisë.....	37
1.3.2	Zhvillimi dhe rigjenerimi i territorit.....	42
1.3.3	Vizioni i përbashkët udhëzues.....	44
2	STRATEGJIA TERRITORIALE.....	50
2.1	IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE, POTENCIALEVE DHE PENGESAVE .....	50
2.1.1	Analiza SWOT për secilin nga pesë sistemet territoriale (N, U, B, UB, IN).....	50
2.1.2	Analiza metabolike .....	62
2.1.3	Analiza e vlerësimeve demografike .....	81
2.1.4	Objektivat e përgjithshme për 5 sistemet territoriale (natyror, ujqor, bujqësor, infrastrukturor, urban) .....	86
2.1.5	Strategjia territoriale për secilin nga pesë sistemet territoriale të Bashkisë Vau-Dejës (N, U, B, UB, IN) .....	88

2.2	VIZIONI STRATEGJIK.....	95
2.2.1	Koncepti territorial .....	95
2.2.2	Objektivat strategjike, programet dhe projektet.....	98
2.2.3	Tipologjitë e projekteve strategjike .....	103
2.2.4	Projektet strategjike .....	106
2.2.5	Skedat e Projekteve.....	108
2.2.6	Strategjia e zhvillimit lokal .....	108
2.2.7	Hartëzimi i projekteve .....	110
2.3	PROJEKTET STRATEGJIKE PRIORITARE.....	112
2.3.1	Zgjedhja e prioriteteve .....	112
3	BURIME FINANCIARE, PLANI I VEPRIMIT.....	115
3.1	Burimet e disponueshme .....	115
3.1.1	Burimet lokale .....	115
3.1.2	Burimet kombëtare .....	115
3.1.3	Burimet Evropiane dhe Ndërkombëtare.....	115
3.2	PLANI I VEPRIMIT .....	119
3.2.1	Burimet e shfrytëzueshme .....	119
3.2.2	Plani i veprimit.....	121
4	ANEKSE .....	132



# HYRJJE

Një ndër instrumentet e planifikimit vendor është: **Dokumenti i Strategjisë Territoriale së Zhvillimit**, e cila është qasja e parë fiziko-hapësinore me Planin e Përgjithshëm Vendor të kësaj bashkie, si shprehja më e lartë e planifikimit të territorit, që pasqyron përparësi e qëllime strategjike, objektiva, mjete e rezultate të pritshme, për të orientuar, drejtuar dhe nxitur proceset e mëtejshme të planifikimit të territorit.

**Strategjia Territoriale** është dokumenti strategjik thelbësor që udhëzon zhvillimin fiziko-hapësinor të njësisë së qeverisjes vendore dhe shërben si bazë për zhvillimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Politika e zhvillimit të territorit është bazuar në fazat e analizës së gjendjes ekzistuese dhe përfshin projeksionet ekonomike dhe demografike për 15-20 vitet e ardhshme. Këto parashikime janë bërë mbi bazën e analizimit të tendencave të zhvillimit në vitet e fundit dhe në të dhënat sociale, ekonomike e demografike të mbledhura në fazat e para. Gjithashtu janë marrë parasysh parashikimet e zhvillimit të ardhshëm të Bashkisë, sipas qëllimit dhe objektivave për vizionin e zhvillimit të këtij territori, që duhet të përfshijë plani i përgjithshëm vendor.

Ky projekt përfshin hartimin e instrumenteve vendore të planifikimit për Bashkinë Vau-Dejës, ku theksi vihet dhe është i orientuar në zhvillimin e njësisë në aspektin ekonomik, urban, mjedisor dhe çdo aspekt tjetër të rëndësishëm për pesëmbëdhjetë vitet e ardhshëm.

Ky dokument ka 3 kapituj kryesorë, që përbëjnë bazën e vlerësimit:

- Strategjia e Përgjithshme e Zhvillimit
- Strategjia Territoriale
- Burime financiare, Plani i veprimit

Një element i rëndësishëm i kësaj faze është **Përfshirja e grupeve të interesit dhe dëgjesa publike** me objektiv kryesor takimet publike për të krijuar transparencë dhe besim në mes të qytetarëve dhe autoriteteve publike, para se të ndërmerren vendime të zhvillimit. Gjatë periudhës së hartimit të këtij dokumenti janë realizuar një seri dëgjësash dhe konsultimesh publike, si dhe janë kryer takime të ngushta me ekspertë vendorë, përfaqësues të biznesit, diasporës e aktorë të tjerë, që operojnë në këtë rajon dhe janë pjesë vitale e zhvillimit me aktivitetin e tyre.

**Strategjia e Përgjithshme e Zhvillimit** shtron një vizion të përgjithshëm të gjithë territorit të bashkisë, duke evidentuar pozicionin dhe rolin që luan ky rajon në tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, sidomos përsa i përket zhvillimit të infrastrukturës, raportit mes

malit dhe detit, veriut dhe jugut, urbanizmit dhe natyrës. Këtu evidentohet lidhja me planet e nivelit kombëtar dhe direktivat që burojnë nga to.

**Strategjia Territoriale** bazohet në gjetjet e fazës së parë dhe potencialet e zonës duke përcaktuar strukturën e ndërtuar të territorit, vizionin dhe strategjinë zhvillimore specifike për Bashkinë Vau-Dejës. Ky proces do të zhvillohet duke ecur në tre hapa:

- Identifikimi i nevojave, potencialet dhe kufizimet
- Formulimi i një vizion dhe strategjie për zhvillimin lokal e njësisë territoriale
- Hartëzimi i Strategjisë së Territorit

Strategjia do të japë orientimet kryesore të zhvillimit, përcaktimet hapësinore dhe sasiore të nevojave, elementët kryesorë të konservimit, si dhe do të ofrojë rekomandime e programe specifike për problemet kryesore dhe transformimet e parashikuara.

Vizioni dhe orientimet kryesore strategjike do të paraqiten në harta, sipas pesë sistemeve territoriale, duke treguar direktivat kryesore, fazat e zbatimit për zhvillime të mëtejshme, si dhe ndryshimet e nevojshme që rrjedhin nga zbatimi i vizionit.

**Burime financiare dhe Plani i veprimit** vjen si një shtjellim i nevojave prioritare të bashkisë dhe si plan i investimeve mbi të cilat do të zhvillohen këta elementë kryesorë. Plani do të bazohet kryesisht në investimet në infrastrukturën e nevojshme për rritjen e cilësisë së shërbimit dhe për të akomoduar rritjen e ardhshme ekonomike, duke identifikuar së pari projektet e investimeve me prioritet të lartë, të nevojshme gjatë pesë viteve të ardhshme. Ky plan do të evidentojë tre tipe projektesh, duke filluar nga shkalla e madhe në projektet e detajuara dhe duke shpjeguar diferencat e rëndësishme të secilit:

- Projekte Bazë
- Projekte Zhvillimi
- Projekte Pilot

Plani do të përfshijë gjithashtu një vlerësim dhe programin e investimeve kapitale financiare për ndërtimin dhe shpenzimet operative të infrastrukturës së re, si dhe zonat e rëndësishme të veçantë për territorin lokal, të konsideruara zona të zhvillimit prioritar dhe që do të luajnë rolin e rasteve studimore për testimin e zhvillimeve të së ardhmes.



Fig. 1 Hartë veneciane e vitit 1571 e territorit të Vau-Dejës (Dagno)



# 1 STRATEGJIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT

## 1.1 PARATHËNIE PËR METODËN

### 1.1.1 Qasja strategjike

Ajo që karakterizon vëmendjen e kohëve të fundit ndaj qasjes strategjike të planifikimit është mundësia, që njëkohësisht të mbahen parasysh, si nevoja e re për konkurrencë e sistemeve lokale, ashtu edhe kriza e modelit tradicional të zhvillimit. Është kjo arsyeja pse, detyra kryesore e PPV-ve të reja është ajo e krijimit të mundësive të reja për shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve lokale, duke përfshirë iniciativat për zhvillim urban, duke ekzaminuar skenarët alternativë, duke vlerësuar efektet dhe duke saktësuar “perspektivat territoriale” referuese.

Disa lloje problemesh nuk mund të përballohen dhe të zgjidhen në nivel lokal. Menaxhimi i zhvillimit lokal, pa përcaktuar horizontet strategjike, mund të bëjë që bashkive t’ju humbasin mundësi shumë të rëndësishme zhvillimi. *Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV)* duhet të përfytyrojë mënyra të reja të organizimit të hapësirës në raport me ripozicionimin strategjik të territorit. Leximi dhe interpretimi i tij më në tërësi, nënkupton kërkimin e shkallës së duhur të planifikimit që përfshin një hapësirë territoriale me karakteristika homogjene, e cila shpeshherë tejkalon kufijtë administrative lokalë.

Me fokus trajtimin e “Zonave në shkallë të gjerë”, në këtë kapitull hyrës të dokumentit të zhvillimit strategjik, analiza shtrihet në një territor më të gjerë se kufijtë territorialë të bashkisë duke përfshirë edhe njësitë vendore kufitare. Në rastin e këtij studimi Vau-Dejës, së bashku me territorin e bashkive Lezhë, Kurbin dhe Krujë në jug, dhe Shkodër në veri paraqet një homogjenitet funksional dhe hapësinor, edhe pse nuk mungojnë situatat specifike lokale.

Mundësia e funksionimit me sukses e një programi lokal zhvillimi varet edhe nga krijimi i situatave të tjera shtesë të favorshme si: ndërtimi i rrjetit të grupeve të interesit, marrëveshja mes institucioneve për realizimin e tij, pajtimi social me iniciativën etj.

Në këtë drejtim mund dhe duhet të punohet që planet e reja të jenë një mundësi për të tejkalar dështimet e të shkuarës, duke ndërtuar një listë ndërhyrjesh prioritare që të kenë kushtin e dyfishtë:

- të jenë të sakta nga pikëpamja teknike
- të jenë të zbatueshme dhe të qëndrueshme nga pikëpamja ekonomiko-sociale.

Në mënyrë që Plani i Përgjithshëm Vendor të mund të jetë një instrument efikas për zhvillimin e territorit, ai duhet:

- të kuptojë synimet ekonomiko-sociale të komunitetit në nivel strategjik;
- të evidentojë veprimet strategjike që mund të realizohen në një kohë të shkurtër me anë të resurseve të disponueshme dhe/të përdorshme;
- të përcaktojë objektiva konkretë dhe afatet kohore të tyre;

Nga kjo rrjedh nevoja e krijimit të proceseve qeverisëse në disa nivele, të bazuara në marrëveshje (si horizontale, ashtu edhe vertikale) mes institucioneve të niveleve dhe llojeve të ndryshme.

Plani i ndërtuar sipas një qasjeje strategjike mund t'i krijojë sistemit vendor mundësi të reja zhvillimi, por për të bërë këtë, programi i ndërhyrjeve dhe i veprimeve që duhen vënë në funksion, duhet të ndërtohet duke u nisur nga çka ofron dhe sugjeron territori, i nënkuptuar në formën e dyfishtë: pushteti lokal dhe bashkësia grupeve të interesit.

Vizioni Strategjik duhet konsideruar si qasja projektuese e një "perspektive territoriale", e ndërtuar duke u nisur nga "ambiciet ekonomiko-sociale" të komunitetit lokal. Bëhet fjalë për ndërtimin e një politike të re urbane në harmoni më të madhe me logjikën ekonomike. Duke qenë se një detyrë e tillë zhvillimi nuk mund t'i lihet vetëm PPV-së, siç nënkuptohet tradicionalisht, procesi duhet të parashikojë ndërtimin e një perspektive territoriale si kalim nga ambiciet ekonomiko-sociale të projektet e ndërhyrjet.

Një PPV e hartuar sipas logjikës së mësipërme ka këto avantazhe:

- menaxhon transformimin e tokave, në kuadër të një objektivi koherent të nxjerrjes në pah të vlerave ekonomike;
- garanton funksionalitetin e secilës prej ndërhyrjeve, në lidhje me sistemin e përgjithshëm të rrjeteve;
- favorizon pikat (vendndodhjet) e mundshme prodhuese, që janë të afta të thithin investime nga jashtë.

Në këtë kontekst, Plani i Përgjithshëm Vendor duhet të dijë të përballojë me vetëdije raportin mes vendit dhe rrjetit, si në hapësirë ashtu edhe në shkallë, domethënë të përfytyrojë lloje të reja organizimi të hapësirës dhe t'i përfytyrojë ato në lidhje me pozicionimin strategjik të vendit krahasuar me dinamikën e rrjeteve.

### 1.1.2 Vizioni në shkallë të ndryshme

Transformimi i një Plani të Përgjithshëm Vendor në një projekt zhvillimi, nënkupton shpjegimin e atyre ideve që mund t'i shtojnë planit mundësi të reja zhvillimi konkrete dhe të menjëhershme.

Në përputhje me një vizion të përbashkët në shkallë territoriale, PPV-ja duhet të marrë përsipër detyrën e parashikimit të "mundësive taktike" të afta për t'i bërë realitet zgjedhjet strategjike. Pra duhen parashikuar të gjithë elementët domethënës, që kanë aftësinë ta transformojnë në një projekt të zbatueshëm, që të mund të garantojë realizueshmërinë e strategjive të evidentuara në shkallë territoriale, si edhe sigurinë e shpejtësinë procedurale për realizimin e këtyre parashikimeve të bëra.

Një PPV mund të kthehet në projekt zhvillimi pavarësisht nga shkalla e aplikimit. Përcaktimi i një konfigurimi të dëshiruar hapësinor dhe evidentimi i bashkësive të veprimeve që duhen vënë në funksion për arritjen e tij është një operacion që mund të bëhet në çfarëdo shkalle, për të rindërtuar një qytet por edhe për të realizuar një sistem objektesh të vogla me karakter shërbimi të shpërndarë në territor ose një rrjet të organizuar për menaxhimin e një fluksi mallrash apo njerëzish.

Raporti midis projektit të zhvillimit dhe PPV-së, shtjellohet në shkallë të ndryshme dhe i përshkon vertikalisht shkallët në kuptimin, që plani mund të shkaktojë projekte ndërhyrjesh në shkallë të ndryshme nga ato për të cilat është hartuar, ashtu sikurse një projekt mund të provokojë efekte në shkallë të ndryshme nga ajo në të cilën zbatohet. Për shembull, shpeshherë nënvleftësohet influenca e ndërsjellë mes organizimit të hapësirave në shkallë lokale dhe dinamikave ekonomiko-sociale në shkallë globale. Politikat e zhvillimit ekonomik janë akoma shumë të shkëputura nga politikat e qeverisjes së transformimeve të hapësirës territoriale dhe urbane. Ndërsa lidhja funksionale mes projektimit të hapësirës së urbanizuar dhe strategjive të zhvillimit të kontekstit është e fortë dhe e ndërsjellët. Zgjedhjet hapësinore, në shkallë territoriale dhe urbane, mund të kenë influencë mbi dinamikat ekonomike kontekstuale, ashtu si zgjedhjet strategjike të sistemit mund të përftojnë mundësi të reja zhvillimi urbanistik.

Veprimi i bashkërenduar i planifikimit të territorit dhe i projektimit të hapësirave urbanizuese duhet të përcaktojë kushtet e kontekstit që favorizojnë tërheqjen e investimeve, të cilat nuk janë më të lidhura vetëm me shërbimet ndaj prodhimit (zonat ekonomike – industriale), por edhe me shërbimet e integruara me njeriun (sisteme urbane), duke parë që me gjithë globalizimin e marrëdhënieve virtuale, janë akoma qytetet ato që tërheqin dijen dhe favorizojnë nxitjen e proceseve të inovacionit.

Planifikimi strategjik, në riprojektimin e rrjeteve infrastrukturore, mund të transformojë boshllëqet urbane (hapësira të pa urbanizuara brenda zonës urbane) në mundësi të reja zhvillimi. Plani urbanistik i një qyteti mund të jetë themelor për krijimin e kushteve të duhura të kontekstit, në mënyrë që ai qytet të jetë më tërheqës kundrejt personave dhe kapitaleve. Konfigurimi hapësinor i një nyjeje infrastrukturore mund të përcaktojë kushtet bazë, që një lidhje e thjeshtë intermodale të transformohet në një "ndërlidhje komplekse", e aftë të krijojë dinamika të reja zhvillimi social dhe ekonomik.

Marrja në konsiderate, në mënyrë të vetëdijshme, e raporteve në shkallë të ndryshme lejon që territori të konceptohet në raport me marrëdhëniet e tij të shumëfishta hapësinore, si të brendshme edhe të jashtme, gjë e cila mundëson kapërcimin e vështirësive të zakonshme të përkthimit të kompleksitetit të rrjeteve në një imazh projektual, gjithashtu kompleks. Vetëdija për raportet në shkallë të ndryshme është kushti i parë që projekti i hapësirave njerëzore të jetë koherent dhe sinergjik me rregullat më të përgjithshme të planifikimit të përdorimit të tokës në shkallë të gjere.

## 1.2 DIREKTIVAT STRATEGJIKE TË PLANEVE KOMBËTARE

### 1.2.1 Projektet kryesore sipas PPK

Në aspektin ligjor dhe teknik, dokumenti i Planit të Përgjithshëm Kombëtar “Shqipëria 2030” vendos kornizat ligjore dhe parametrat madhorë të zhvillimit, të detyrueshëm për zbatim nga organet vendimmarrëse në nivel qendror dhe lokal. Si i tillë, ky dokument ofron referencën bazë për zhvillim strategjik afatgjatë e cilësor të territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim:

- sigurimin e zhvillimit të balancuar ekonomik e social të vendit,
- menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore të tij,
- mbrojtjen e mjedisit, ndërkohë që siguron përdorimin racional të tokës.

Bazuar në hierarkinë e vendosur nga kuadri ligjor për planifikimin e territorit, PPK do shërbejë si dokumenti kryesor orientues në procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vau-Dejës.

Në Planin e Përgjithshëm Kombëtar janë identifikuar dhe njohur burimet bujqësore, mjedisore dhe turistike të territorit të Bashkisë së Vau-Dejës.

Në terma të hierarkisë urbane, Vau-Dejës konsiderohet si pol terciar. Ai varet nga ana hierarkike nga dy pole kufitare dhe të baraslarguara, të nivelit të dytë që janë Shkodra dhe Lezha. Në fakt, sipërfaqja e Vau-Dejës është vendosur në të njëjtën “zonë funksionale ekonomike” të Shkodrës dhe Lezhës.

*Propozimi i PPK-së për Polin e zhvillimit rajonal Shkodër - Lezhë, porta perëndimore e rajonit malor verior, ku përfshihet edhe bashkia e Vau-Dejës.*

Ky pol përbëhet nga 5 bashki, ku bashkia Shkodër parashikohet si qendra kryesore, bashkia Lezhë si qendër e specializuar dhe bashkitë Vau-Dejës, Malësi e Madhe, Kurbin, janë qendra lokale. Bazuar në të dhënat e INSTAT-it në vitin 2001 në rajon numëroheshin 344.213 banorë, ndërsa në vitin 2011 308.797 banorë, duke shënuar një pakësim të popullatës me 10.3%. Gjithsej sipërfaqja territoriale e tij është 310.093 ha dhe përbëhet nga 37 njësi administrative. Ndonëse ky pol nuk ka sipërfaqe territoriale të konsiderueshme, ai është shumë i pasur me pasuri

natyrore dhe me vlera kulturore ku vlen të përmendet plazhin i Shëngjinit, i Velipojës, liqeni i Shkodrës, lumi Mat, Buna, Drini, Alpet e thepisura, fushat e pasura bujqësore, aktivitetet agroturistike, folklori dhe muzika karakteristike, toleranca fetare etj.




Fig. 2 Poli i zhvillimit rajonal Shkodër – Lezhë

Ndër projektet më të rëndësishëm, që parashikohen nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar janë:

Referuar sistemit natyror, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Shpallja dhe promovimi i parkut kombëtar të Alpeve si park me rëndësi rajonale dhe hartimi i politikave dhe instrumenteve financiare për nxitjen e zhvillimit të turizmit malor.

Referuar sistemit ujqor, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Përcaktimin e Vijës Blu dhe respektimin strikt të saj si kufiri i zonave mbrojtëse të të gjitha burimeve ujore, sipas përcaktimeve të legjislacionit sektorial në fuqi dhe Rregullores së Planifikimit të korrikut 2015, në mënyrë që të mbrohet ekosistemi natyror i zonës.
- Qendrat primare dhe sekondare duhet të pajisen me impiant të trajtimit të ujërave të ndotur, përpos 3 impianteve ekzistues/të planifikuar Shkodër, Lezhë - Shëngjin dhe Velipojë, në mënyrë që brenda vitit 2030 të mos derdhen më ujëra të zeza në lumenj, det dhe të rritet cilësia e baseneve.
- Itinerarin turistik vozitës lumor - liqenor, duke integruar vozitjen dhe lundrimin në një rrjet rekreativ: Vau-Dejës - Liqeni i Shkodrës - Pulaj - Ishulli i Bojanës.

Referuar sistemit bujqësor:

- Krijimin e një tregu rajonal bujqësor, i cili do të plotësonte zinxhirin ekonomiko-bujqësor në agro-përpunimin e produkteve bujqësore.

Në lidhje me Infrastrukturën e transportit:

- Zhvillimin e qendrës primare të Shkodrës dhe Lezhës si dy qytete-porta, nisur nga modalitetet portuale, hekurudhore dhe rrugëve kombëtare që ofrojnë, si dhe zhvillimin e qendrave Bajzë, Koplik, Laç si hub-e logjistike, për rolin kryesor, pozicionin kufitar që kanë si pika grumbullimi të produkteve bujqësore dhe stacione me rëndësi për njerëz dhe mallra.
- Përmirësimin e kushteve dhe fuqizimin e kapacitetit akomodues të portit të Shëngjinit si nyje shumë e rëndësishme për polin ekonomik Shkodër – Lezhë
- Integrimin dhe funksionimin me kapacitet të plotë sipas modaliteteve të stacioneve të rrjetit hekurudhor: Hani i Hotit, Bajzë, Koplik, Grilë, Milot si stacione mallrash; Shkodër, Lezhë si stacione qendrore, si dhe rigjallërimin e stacioneve për pasagjerë, Mjedë, Baqël, Laç, Gjorm, Mamurras.
- Itinerarin peizazhistik blu në këtë zonë, përgjatë qendrave: Ulqin - Velipojë - Shëngjin - Lezhë – Kune-Vain, të paraprirë nga projektet strategjike të MTI-së dhe MM-së.
- Ndërtimin e tubacionit të gazit IAP, i cili parashikohet të fillojë nga Fieri (ku kryqëzohet me TAP), të përshkojë këtë rajon për në Malin e Zi në dy degëzime, mbi dhe nën liqenin e Shkodrës. Përtej Malit të Zi, degëzimi IAP-it do të mundësojë lidhjen me Bosnjë - Hercegovinën dhe Kroacinë. Gazsjellësi Joniano-Adriatik është një zgjatim i projektit TAP drejt vendeve të rajonit. Nga studimi i fizibilitetit<sup>1</sup>, ky gazsjellës ka një gjatësi 510.8 km dhe segmenti që shtrihet në territorin e vendit tonë është 167.7km.
- IAP-KOSOVË. IAP degëzohet në rajonin Shkodër-Lezhë, për të furnizuar Kosovën nëpërmjet Kukësit duke realizuar Unazën Perëndimore të Ballkanit, Western Balkan Rings (WBR)

---

<sup>1</sup> FS and ESIA for the Ionian – Adriatic Pipeline (IAP), Feasibility Study Report - January 2014 (EuropeAid/128073/C/SER/MULTI, Sub Project: WB5-REG-ENE-03)



Fig. 3 PPK – Skema e rrjetit të gazsjellësve në Ballkan

- Në përputhje me OST-në, ndërtimin e nënstacioneve të reja në Koman dhe Lezhë. Në këtë të fundit janë parashikuar të kalojnë edhe linjat 400 dhe 220kV që do të lidhin Shqipërinë me Kosovën dhe me Malin e Zi.
- Ndërtimin e parkut energjetik, i cili do të përbëhet nga dy parqe eolike dhe një termocentral biomasë me kapacitet vjetor prodhimi përkatësisht 1.1 Twh dhe 750 Gwh.
- Vlerësimin e potencialit natyror në aspektin e diversifikimit të energjisë alternative, duke synuar që rrezatimi prej 2700 orë/vit të shfrytëzohet në ndërtimin e parqeve fotovoltaike.

### 1.2.2 Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin

Bashkia Vau Dejës, nuk ka vijë bregdetare, megjithatë ajo preket në mënyrë indirekte nga PINS për Bregdetin. Përmes territorit të bashkisë, aksesohet lehtësisht bregdeti i Velipolës. Në këtë bregdet, çon edhe Itinerari turistik vozitës lumor - liqenor: Vau-Dejës - Liqeni i Shkodrës - Pulaj - Ishulli i Bojanës, i parashikuar në PPK.

Në planin e integruar ndër sektorial të Bregdetit i gjithë bregdeti verior shqiptar ndërmjet Kepit të Rodonit dhe kufirit me Malin e zi, konsiderohet si i denjë për t'u ruajtur dhe i destinuar për zhvillimin e turizmit mjedisor.

Zona e mbrojtur bregdetare e Velipojës tregohet si një resurs natyror i cili mund të lidhet me zonën malore të parkut të Valbonës nëpërmjet një marrëdhënieje logjike dhe funksionale me zonën malore të Alpeve, sipas një korridorit lumor kryesisht i specializuar si itinerar për ekskursion natyror.

Pra, ideja strategjike e Planit Kombëtar të Bregdetit është ajo e integritit të resursit natyror të bregdetit me resursin natyror malor, me qëllim krijimin e një itinerar të integruar dhe sinergjik për shfrytëzimin e organizuar të resurseve natyrore dhe mjedisore.

Pjesa më veriore e territorit të bashkisë së re të Vau-Dejës, për më tepër është pjesë e kontekstit territorial të Alpeve Shqiptare, dhe prandaj është subjekti i parashikimeve të Planit Kombëtar të Turizmit për rajonin e Alpeve Shqiptare. Ky instrument i rëndësishëm, i cili është akoma në faze hartimi, trajton temën e rëndësishme të mbrojtjes dhe të zhvillimit të një konteksti të tillë edhe për shkak të programeve të përforcimit të infrastrukturës së Veriut të vendit, që duhen zhvilluar duke respektuar vlerat e jashtëzakonshme mjedisore dhe peizazhistike të një rajoni unik.

Një marrëdhënie e tillë, i jep territorit të Vau-Dejës jo vetëm rolin e një hapësire tranzit për trafikun turistik drejt rajonit të Alpeve (Porta jugore), por edhe mundësinë për tu ofruar turistëve qëndrim dhe shfrytëzim të resurseve të shumta të territorit.

Parimet kryesore të PINS për Bregdetin janë:

- Bregdeti si binom det-tokë aset i rëndësishëm kombëtar dhe pjesë e integruar e rrjetit mesdhetar.
- Hapësirë e mirë menaxhuar ku harmonizohen nevojat për zhvillim ekonomik dhe nevojat lokale me domosdoshmërinë e mbrojtjes së aseteve kulturore, natyrore dhe historike.

### ***Integrimi në Hapësirën mesdhetare***

Deti Mesdhe, paraqet një potencial të lartë të zhvillimit ekonomik, pasi rreth 51% e turizmit botëror zhvillohet në këtë hapësirë. Qëllimi primar i këtij plani është integrimi real i vendit tonë në hapësirën mesdhetare, përmes propozimeve të reja në infrastrukturën lidhëse, bashkëpunim ndër-rajonal për zhvillim të mëtejshëm ekonomik dhe programeve të ndryshme ndërkombëtare (për vendet në proces integrimi në BE).

Kjo do të arrihet duke ofruar një zhvillim të kontrolluar në zonën bregdetare, zhvillim i cili mundëson ruajtjen e aseteve natyrore, kulturore dhe sociale dhe gjeneron ekonomi, zhvillim i cili bazohet në traditat, kulturën dhe produktin vendas.

Projekti ndërkombëtar i korridorit blu, i cili ka si qëllim ndërlidhjen e gjithë hapësirës Mesdhetare, është një projekt strategjik i rëndësishëm, i cili rrit mundësinë e vendit tonë për





një karakter peshkimi dhe turistik, ky port, është një nga portet kryesore të rrjetit infrastrukturor portual të vendit tonë.




Fig. 5 Fasha A – Det dhe Diell

Hapësirë bregdetare, me gjerësi 2-10 km, është zhvilluar më tepër në sektorin e turizmit det-diell, si pasojë e presionit dhe potenciali më i lartë i zhvillimit të ekonomisë së turizmit.

## 2. Fasha B

Kjo është fasha Bujqësore e hapësirës bregdetare. Fasha B është **hapësira e tokës** e cila vjen menjëherë pas fashës A, në brendësi të territorit. Ajo përfaqësohet nga ultësira perëndimore, si zonë e ndërmjetme, mes fashës së parë të bregdetit dhe vargut të lartë malor e shkëmbor, e cila varion nga 5-25 km gjerësi dhe përfshin tokën bujqësore dhe kodrat e ulëta me tarracat e punuara në vreshtari, pemë frutore dhe ullishte, dhe akset e transportit rrugor kryesor kombëtar Veri-Jug.

Për zonën tonë kjo fashë përfaqësohet nga një prej fushave më të mëdha dhe pjellore të Shqipërisë si Fusha e Zadrimës dhe prek kryesisht njësitë administrative Bushat, Hajmel dhe pjesërisht atë Vau-Dejës.

Ky brez ka një pasuri ujore shumë të lartë e cila kontribuon në rritjen dhe zhvillimin e tokës bujqësore. Uji është faktori kryesor lidhës midis zonës së ndërmjetme dhe rripit bregdetar. Cilësia dhe sasia e tij është më rëndësi thelbësore për ruajtjen e qëndrueshmërisë së rripit bregdetar.




Fig. 6 Fasha B – Bujqësia

### 3. Fasha C

Kjo është fasha e pasurisë historike e kulturore të hapësirës bregdetare. Fasha C është hapësirë territoriale e cila nis që nga bregdeti e vazhdon deri më në brendësi të territorit duke përfshirë edhe qytete me vlera jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare që gëzojnë statusin dhe mbrohen nga UNESCO.




Fig. 7 Fasha C – Histori dhe Kulturë

Kjo fashë përfaqësohet nga vlerat e trashëgimisë kulturore që shtrihen në të gjithë territorin bregdetar, fushor dhe malor, dhe që ka ndikim me vlerat që ajo mbart, në të gjithë territorin bregdetar të Shqipërisë.

Territori i fashës C, mbivendoset me dy fashat e para A dhe B, dhe depërton më thellë në brendësi të territorit, duke përfshirë të gjitha potencialet me vlerë dhe me ndikim në zhvillimin e turizmit.

Thellësia e kësaj fashe në territor varion nga 10-40 km distancë nga vija bregdetare.

Numërohen rreth 1000 monumente kulture dhe historike vetëm në këtë pjesë të territorit të Shqipërisë. Në zonën tonë më të rëndësishmet janë seria e fortifikimeve të fashës Vig – Sapë – Danjë – Sardë – Dalmacë (Koman).

#### 4. Fasha D




Fig. 8 Fasha D – Fasha detare

Kjo fashë përfaqësohet nga hapësira detare, nga të gjitha aktivitetet ekonomike e rekreative që ndodhin në të dhe nga potencialet për zhvillim të saj, si:

- zhvillimi i akuakulturës,
- transporti detar
- turizmi detar
- ekstraktimi dhe përpunimi i kripës
- zhvillimi i industrisë së peshkimit

Bashkia Vau – Dejës nuk ka dalje të drejtpërdrejtë në vijën bregdetare, por ajo shërben si një korridor për të aksesuar bregdetin e Velipojës dhe është e lidhur drejtpërdrejtë me zhvillimin e kësaj zone.

### *Struktura e bregdetit*

PINS e ka ndarë bregdetin shqiptar në katër zona, duke u kujdesur të përzgjedhë së pari elementët përcaktues për të mundësuar një ndarje të natyrshme e organike. Faktorët e marrë në konsideratë për të realizuar këtë ndarje, duke nënvizuar pikat më të forta të secilit territor, janë:

- morfologjia territoriale
- forma dhe tipologjia e vlerave të mjedisit, dhe peizazhit natyror
- karakteri urban i zhvilluar (tipologjia dhe morfologjia urbane)
- prezenca e monumenteve të trashëgimisë kulturore

Zona e bregdetare e Velipojës, bën pjesë në **Zonën e ekoturizmit**, që shtrihet nga Grykëderdhja e Bunës deri në Hamallaj (Durrës).

Vlerat, karakteri dhe sektorët e zhvilluar historikisht në këtë territor, që evidentohen si dominuese, më tepër se të tjerat, janë: vlerat e shumta mjedisore, me ekosisteme flore dhe faune shumë të pasura (katër nen-zonat e mbrojtura mjedisore); aktivitetet ekonomike të zhvilluara lidhen me sektorin e bujqësisë, peshkimit dhe blegtorisë.

Turizmi në këtë zonë është i alternuar, ditor në plazhet me gjatësi të shkurtër edhe për të mbrojtur dhe ruajtur vlerat e zonave natyrore dhe mjedisore me vlerë, dhe sezonal, në plazhet me gjatësi më të madhe.

Karakteri i zhvillimit të kësaj zone është ekoturizmi. Kjo nuk përjashton zhvillimin e tipologjive të tjera të turizmit, dhe aktiviteteve të tjera që janë të qëndrueshme dhe në respekt të mjedisit zonave lagunore; kontributi i të cilave do të sillte një zhvillim ekonomik vjetor të qëndrueshëm nga turizmi i kombinuar.

### 1.2.3 Planet Vendore

Siç ka ndodhur me shumë bashki të vendit, para reformës së fundit administrative, edhe grupi i bashkive dhe komunave të vjetra, sot të bashkuara në bashkinë e re të Vau-Dejës, kanë qenë objekt planesh, shpesh të financuara nga agjenci zhvillimi kombëtare ose donatorë të huaj. Kanë qenë thujtë gjithmonë instrumente me karakter strategjik, që veç anëve të tjera pozitive, u kanë mësuar banorëve dhe gjithë grupeve lokale të interesit praktikën e planifikimit, shpeshherë edhe nëpërmjet procedurave pak a shumë gjithëpërfshirëse.

Kjo vihet re nga analiza e Planeve me interes lokal, e bërë në këtë studim, të cilat janë klasifikuar në “Kuadrin përmbledhës të instrumenteve të planifikimit me interes për



studimin”, të paraqitur në fletët në vijim, i cili nxjerr në pah, bashkë me planet me interes kombëtar dhe rajonal, statusin juridik, datat e hartimit dhe kushtet e vlefshmërisë (nëse bëhet fjalë për plane ekzistues, apo për plane në faze hartimi) dhe lidhjen e tyre me 6 njësitë administrative (Vau-Dejës, Bushat, Hajmel, Vig-Mnelë, Shllak, Temal).

Bëhet fjalë, përsëri, për një kuadër mjaft të pasur dhe të artikuluar, që ka fituar një zhvillim të dukshëm sidomos për sa i përket njësive administrative me zhvillim më të madh urban – si Bushati dhe Vau-Dejës – ku instrumentet urbanistike arrijnë deri në detaje të zonimit dhe të klasifikimit e standardizimit të nën njësive strukturore, ndërsa zonat më pak të zhvilluara i janë nënshtruar Planeve me natyrë më shumë strategjike – është rasti p.sh. i Planit Strategjik të zhvillimit Vig-Mnelë, 2010 dhe të Planit Strategjik të Zhvillimit Hajmel. Në bazë të të dhënave të mbledhura deri tani, vetëm njësitë e Shllakut dhe të Temalit kanë mungesë të instrumenteve të tilla, ndërkohë duhen përmendur Plane të tjera me natyrë strategjike, që përfshijnë disa njësi administrative, si p.sh. Plani Strategjik i Zhvillimit të Zadrimës i vitit 2012, i cili prek njësitë Bushat, Blinisht, Dajç, Hajmel dhe Vau-Dejës. Ky Plan ka pasur si synim të kontribuonte në promovimin dhe përhapjen e praktikave të mira në fushën e decentralizimit, menaxhimit ambiental dhe qeverisjes së zhvillimit lokal.

Vlen për tu përmendur edhe projekti STAR 2016 Plani Operacional për Zhvillimi Lokal (POZHL), realizuar falë Grant Thornton, që ka pasur si synim mbështetjen e riorganizimit të ri administrativ nxitur nga reforma, për secilën nga bashkitë dhe komunat e mëparshme.

Trashëgimia e këtyre planeve, objekt i konsideratave më të detajuara në pjesën e tretë të këtij studimi, përfaqësohet nga shumë analiza interesante – edhe pse në disa raste të kthyera në rutine, në trajtën e analizës SWOT jo shumë të thelluar – dhe mbi të gjitha nga një listë e gjerë projektesh, të cilat shpeshherë janë vetëm të shpallura, por që shprehin qëllimet dhe interesat rreth mundësive të reja të investimit të ofruara si për sektorët publike ashtu edhe për ata private, dhe në veçanti burimit ekonomik – financiar akoma të pa shprehur të “diasporës” shqiptare, përfshirja e së cilës në perspektivat e investimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë – dhe mbi të gjitha të mirëqenies së shoqërisë lokale, përbën ndoshta sfidën më interesante edhe të këtij plani të ri që po hartohet.

E ndryshme është në fakt konsiderata lidhur me efikasitetin që këto plane kanë pasur deri tani në drejtimin e zhvillimit, si atij urban ashtu edhe të aktiviteteve ekonomike, në vitet e turbullta të tranzicionit drejt ekonomisë së tregut, që vazhdon edhe në dekadat e fundit. Format, përmasat komplekse dhe shpërndarja e çrregullt e vendbanimeve, shpeshherë me karakter informal, që kanë karakterizuar procesin e ndërtimit në territorin lokal, sidomos në zonat fushore (Bushat, Vau-Dejës, Hajmel) të cilat ndodhen më pranë bashkive kufitare të Lezhës dhe Shkodrës – qendrat rajonale më të rëndësishme të rajonit verior – tregojnë mungesën e efikasitetit të mjeteve të planifikimit lokal në dhënien e një drejtimi të zhvillimeve urbane dhe prodhuese.

Fakti që ky zhvillim nuk ka ndodhur në format e pritshme, falë pranisë së resurseve lokale – tokë bujqësore, peizazh - është e mundur të jetë rezultat i mungesës së infrastrukturës dhe të tërheqësve të vërtetë të zhvillimit, sëbashku me fenomenin e braktisjes së këtyre territoreve nga ana e popullsisë vendase, më tepër se sa rezultate i politikave dhe normave të mbrojtjes dhe të kontrollit të zhvillimit urban në ato pjesë të territorit.

#### 1.2.4 Drejtimet e zhvillimit sipas pesë sistemeve

Të dhënat dhe objektivat kryesore për zhvillimin e zonës sipas pesë sistemeve janë një përmbledhje e orientimeve të përbashkëta që dalin nga analizimi i PPK-së dhe Planeve ndërsektoriale që ndikojnë në zonat e përfshira në territorin e bashkisë.

##### 1.2.4.1 Sistemi Urban

Sistemi urban formohet nga bashkimi i territoreve urbane dhe kufizohet nga vija e gjelbër. “Territori urban” është hapësira gjeografike e vazhdueshme, e ndërtuar nga aktiviteti njerëzor.

**Objektivi kryesor:** Rritja inteligjente

**Politika:** Zhvillimi policentrik, densifikimi, gjithë përfshirja

Për të zbutur pabarazinë e krijuar, Sistemi Urban sipas planit kombëtar propozon:

- Hierarkizimin e qendrave
- Profilizimin e tyre në akomodimin e sektorëve ekonomikë të përshtatshëm duke shfrytëzuar potencialet ekzistuese.
- Rajonizimin, ose bazat për zhvillim rajonal i shprehur në bashkimin funksional të qendrave urbane primare dhe të specializuara.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar, në varësi të statusit aktual dhe të propozuar të qendrave urbane, me qëllim sigurimin e zhvillimit të territorit në përputhje me Vizionin e planit, propozon ndërhyrje konsoliduese, përforcuese, rigjeneruese, kooperuese dhe fuqizuese për qendrat urbane. Plani kombëtar për sistemin urban propozon:

- Zhvillim hapësinor policentrik dhe një marrëdhënie të re urbane - rurale;
- Kontroll i ekspansionit fizik të qyteteve dhe zonave të urbanizuara, duke promovuar densifikimin në vend të shpërhapjes urbane;
- Akses më të mirë në një infrastrukturë multimodale, e cila është jo vetëm më e efektshme, por edhe miqësore ndaj mjedisit;
- Funksione mikse dhe komplementare;
- Përdorim dhe menaxhim inteligjent i ekosistemit urban në veçanti i ujit, energjisë dhe mbetjeve;

- Konservim dhe zhvillim të pasurive natyrore dhe të trashëgimisë historike kulturore, në kuptim të përmirësimit dhe të aktivizimit të këtyre aseteve në jetën urbane.

Politika që udhëheq strukturën e propozuar të sistemit urban është krijimi dhe forcimi i qyteteve dinamikë, tërheqës dhe konkurrues në rajone të urbanizuara.

Qyteti i Vaut të Dejës përcaktohet në PPK si qendër urbane terciare. Këto qendra përmbajnë funksione dhe shërbime bazë si p.sh.:

- Funksionet ekonomike dhe të vendbanimeve,
- Funksionet e tregtisë me pakice,
- Funksionet kulturore dhe të rekreacionit,
- Funksionet administrative,
- Funksionet arsimore shkolla të mesme, shkolla profesionale,
- Funksionet shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale.

Gjithë qendrat e tjera urbane të bashkisë bëjnë pjesë në kategorinë Lokalitete.

Lokalitete janë konsideruar qendra të vogla të banuara me karakter rural. Në përgjithësi lokalitetet janë fshatra, të cilat janë njësi më e vogël e organizimit territorial.

#### 1.2.4.2 Sistemi natyror

Sistemi natyror (N) përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekura të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë të përdorimit “natyrë”.

**Objektivi kryesor:** Zhvillimi i qëndrueshëm i sistemit natyror.

**Politika:** Rritje e zonave të mbrojtura natyrore, promovimi dhe aksesimi i tyre.

Objektivi kryesor i PPV synohet të arrihet nëpërmjet politikave të mëposhtme:

- Rritja e përgjegjësisë kombëtare e ndërkombëtare për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, duke kombinuar konceptet e qëndrueshmërisë dhe administrimit të mirë;
- Mbrojtja dhe rritja e zonave të mbrojtura natyrore; krijimi i një sistemi të qëndrueshëm e komunikativ mjedisor;
- Rritja e rolit të mjedisit në zhvillimin ekonomik të vendit; integrimi i sistemit natyror në vlerën ekonomike të sektorëve të zhvillimit;
- Rritja e rolit të mjedisit në cilësinë e jetës urbane përmes promovimit dhe krijimit të aksesit të përshtatshëm ndaj zonave natyrore.

Targeti për 2030 i PPV-së do të synojë shtimin e sipërfaqes së zonave të mbrojtura 20 % për tokën dhe 12-15 % të sipërfaqes ujore. Ruajtja dhe shtimi i zonave të mbrojtura natyrore do të bëhet nëpërmjet:

- Vendosjes së prioritetit të përdorimit të zonave të lira natyrore, me përparësi mjedisin.



- Krijimi dhe konsolidimi i korridoreve lidhëse natyrore përgjatë luginave lumore, të cilët bëjnë njëkohësisht lidhjen e qëndrueshme të sistemit të zonave të mbrojtura, por edhe ruajtjen e sistemit ujor.
- Zonat me rrezikshmëri natyrore ndaj njeriut si rrjedhim i erozionit, nivelit të lartë sizmik, prezencës së materialeve të dëmshme për shëndetin, etj.
- Zonat e degraduara prej aktiviteti njerëzor, si punime minerare, depozitim mbeturinash, shfrytëzim i pa kriter i burimeve natyrore, etj. Të vendosen objektiva kohorë për rikthimin e këtyre zonave në gjendjen e mëparshme.

Udhëzimet për territoret sipas karakteristikave urbane jepen në vijim.

Në lokalitete (kooperim dhe përforcim):

- Zhvillimi urban duhet inkurajuar brenda zonave të urbanizuara që shfrytëzon infrastrukturën ekzistuese të ndërtuar;
- Toka me karakteristika të mira pjellore, por që nuk mund të përdoren më për bujqësi duhet të pyllëzohen aty ku është e mundur. Kjo do të rriste mundësitë ekonomike të zonës për shfrytëzim të lëndës drusore ose për përmirësim të peizazhit natyror dhe rritjen e atraksioneve turistike;
- Në tokat me karakteristika jo të mira bujqësore inkurajohet përdorimi i tyre për parqe fotovoltaike apo eolike sidomos për zonat pranë stacioneve dhe rrjetit ekzistues elektrik;
- Në tokat me shfrytëzim intensiv të bujqësisë rekomandohet ripërdorimi i mbetjeve bujqësore për gjenerimin e energjisë elektrike. Kjo do të mundësonte zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe mbrojtjen e cilësisë së rrjedhave ujore nga shpërhapja e mbetjeve bujqësore;
- Promovimi i rrjedhave ujore për sportet dhe aktivitetet ujore.

Në qendrat urbane terciare (konsolidim dhe fuqizim):

- Parandalimi i shpërhapjes urbane;
- Ndalimi ku është e mundur dhe reduktimi i humbjes së tokës bujqësore dhe tokës së lire natyrore për shkak të përdorimit urban;
- Mbrojtja e karakteristikave të peizazhit rural dhe minimizimi i fragmentimit të tij, duke ruajtur sa më qartë diferencat karakteristike midis peizazhit urban dhe atij rural;
- Krijimi i infrastrukturës së gjelbër për qytetet, që do t'i mundësojnë banoreve akses në zonat natyrore dhe në aktivitetet rekreative që do të zhvillohen në to;
- Ruajtja dhe aty ku është e mundur shtimi i zonave të mbrojtura mjedisore dhe biodiversitetit në to;
- Mbrojtja e objekteve dhe strukturave ndërtimore me vlera karakteristike të peizazhit të traditës historike e kulturore.

Në qendrat urbane terciare (rigjenerim):

- Mjedisi si produkt turistik që tërheq vizitorët nga cilësia e peizazhit natyror, historiko - kulturor dhe biodiversitetit, si edhe nga një gamë e gjerë mundësish për zhvillimin e aktiviteteve natyrore;
- Tërheqja e sipërmarrjeve dhe njerëzve që karakterizohen nga aftësi dhe një spektër i gjerë ekspertize teknike dhe intelektuale, për të cilët jetesa në qytete të vogla ku garantohet cilësia mjedisore, i mundëson atyre cilësinë e jetës që ata kërkojnë;
- Zhvillimi i avancuar i infrastrukturës së komunikimit, e cila mund të sigurojë zgjerimin e shkallës së aktiviteteve ekonomike si dhe të sipërmarrjeve të vendosura në një vend të caktuar.

Përqasja e PPK për këtë sistem shprehet nëpërmjet dy koncepteve: Promovim dhe Akses. Në këtë kuadër disa nga propozimet janë:

- Rritje të zonave natyrore nëpërmjet shtimit të zonave të mbrojtura dhe korridoreve lidhëse natyrore përgjatë luginave të lumenjve;
- Shtimi i tri parqeve kombëtare në rrjetin kombëtar të zonave të mbrojtura:
  - Parku i Bunës
  - Parku i Alpeve
  - Parku i Vjosës

Gjithashtu, propozohet që në rrjetin e zonave të mbrojtura të shtohet edhe rrjeti Emerald.

- Krijimi i hapësirave rekreative dhe atraksioneve natyrore përgjatë luginave të lumenjve;
- Futja e rrjetit kombëtar të biçikletave, i cili akseson dhe përshkon zonat natyrore dhe ato të trashëgimisë historike e kulturore;
- Projekte ripyllëzimi dhe rigjenerimi në zonat e degraduara nga dukuri natyrore si erozioni dhe përmytjet, por edhe nga aktivitetit njerëzor.

#### 1.2.4.3 Sistemi bujqësor

Sistemi bujqësor (B) përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj. Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë të përdorimit të tokës “bujqësinë”.

**Objektivi kryesor:** Efiçencë për një sektor bujqësor konkurrues

**Politika:** Ruajtje, konsolidim, modernizim.

Politika të tjera lidhen me:

Vendosja e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim - grumbullim - përpunim - tregtim, me qëllim rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik.

Ulja e kostos dhe rritja e cilësisë nëpërmjet investimeve në:

- teknologjinë e prodhimit për modernizimin e saj;
- investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, kanale vaditëse – kulluese, etj.

Integrim dhe bashkëpunim me sektorët e tjerë të ekonomisë:

- Bujqësi - turizëm, ku veçantia e sektorit turistik shqiptar identifikohet edhe nga produktet bujqësore karakteristike në shije e cilësi.
- Bujqësi - transport, ku infrastruktura e transportit i shërben rritjes së efikasitetit të rrjetit bujqësor në grumbullimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore.
- Bujqësi - energji, ku energjia e përdorur në përpunimin e produkteve bujqësore shkon drejt përdorimit të burimeve të rinovueshme.

Krijimi i qendrave/poleve bujqësore dhe profilizimi i këtyre të fundit bazuar në traditën e kultivimit të kulturave vendore.

Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike shqiptarë.

- Bimë Mjekësore
- Pemë frutore arrore
- Ullinj dhe Vreshta
- Perime karakteristike të vendit
- Produkteve bujqësore të përpunuara

Plani i Përgjithshëm Vendor do të bazojë ndarjen e territorit të Sistemit bujqësor sipas këtyre objektivave:

- Ruajtje maksimale e fondit të tokës bujqësore, me anë të politikave të densifikimit të zhvillimit urban. “Asnjë ndërtim i ri në tokë bujqësore që nuk i shërben Sistemit Bujqësor”.
- Vendosja e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim – grumbullim – përpunim - eksportim, me qëllim rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik.
- Krijimi i *qendrave të specializuara* bujqësore dhe profilizimi i tyre sipas karakteristikave të prodhimit lokal.
- Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike të zonës.

#### 1.2.4.4 Sistemi ujq

Sistemi ujq (U) është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujqore, që përmban të gjithë trupat ujqorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Sistemi ujq formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës "ujë".

Rekomandimet e PPK për këtë sistem fokusohen në:

- Shfrytëzim racional i ujërave duke ruajtur balancën e abstragim/rimbushje të akuiferëve;
- Kontrolli i aktiviteteve të paligjshme;
- Investime në rritjen e kapaciteteve dhe njohurive mbi burimet ujqore dhe në veçanti të shtresave gjeologjike dhe kufijve të akuiferëve;
- Shfrytëzim i qëndrueshëm i ujërave nëntokësore, duke përfshire këtu edhe shpimet e pakontrolluara;
- Ruajtja e ujëmbledhësve nga precipitime të shirave për përdorim bujqësor.
- Eliminimi i ndotjeve të ujit nga burime të ndryshme.

Plani i Përgjithshëm Vendor për Sistemin Ujq orienton drejt këtyre objektivave:

- Prioritet maksimal mbrojtjes së burime hidroenergjetike të zonës.
- Përcaktimin e vijës blu, të mbrojtjes së sipërfaqeve hidrike dhe fashat mbrojtëse të kërkuar nga ligji.
- Evidentimi i zonave të rrezikshme për njeriun si rezultat i përmbytjeve, ose që janë në rrëgjim kënetor
- Përcaktimi i zonave të përshtatshme për zhvillim turistik ujqor
- Përcaktimi i zonave me prioritet zhvillimin e peshkimit dhe infrastrukturës së nevojshme.

Çdo zhvillim në brigjet ujqore, si dhe kufijtë e zonave mbrojtëse përkatëse përcaktohen nga legjislacioni i posaçëm. Zonat e mbrojtjes përbëhen nga:

- Zonat higjeno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujqore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;
- Një zonë e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës do të jetë e ndaluar të kryhet çdo lloj ndërtimi dhe shkarkimi, përveçse ndërtimeve për mbrojtjen e trupit ujqor;
- Një zonë e mbrojtjes së largët, brenda së cilës ndërtimet do të jenë objekt lejeje administrative para marrjes së lejes së ndërtimit.

Politikat primare të PPK për sistemin ujq janë:

Politikat e densifikimit të zhvillimit urban dhe korridoret natyrore përgjatë luginave të lumenjve.

Në mbrojtje të Sistemit Ujor, PPK vendos:

**VIJËN BLU** e cila ka për qëllim:

- Për rrjedhat lumore, rigjenerimi i korridoreve natyrore që shoqërojnë rrjedhën e tyre.
- Njohjen dhe mbrojtjen e vlerave të peizazhit natyror të territorit që shtrihet nga vija bregdetare deri në kreshtën e brezit të pare kodrinor malor.
- Të mbrojtë resurset ujore nga përdorimi i papërshtatshëm si

*Shfrytëzim intensiv i inerteve të lumit,*

*Vend-depozitime të mbetjeve urbane*

*Aktivitet bujqësor e industrial i konsiderueshëm.*

### ***Korridoret e gjelbra***

Integrimi i luginave të lumenjve është menduar të realizohet nëpërmjet burimeve të tjera natyrore, në mënyrë që të kryhet vlerësimi i lumenjve me pamje të mirë peizazhistike, duke i cilësuar ato si korridore të gjelbra që mundësojnë lidhjen e vendeve të ndryshme me njëri-tjetrin; lidhjen e vlerave natyrore, kulturore, liqenet, monumente historike, vendbanime me vlera arkitektonike, fshatra historikë, lagunat, plazhet, etj., duke filluar nga vija bregdetare deri në pjesën e brendshme malore të territorit.

Pra luginat e lumenjve, do të shërbejnë si:

- Korridoret e gjelbër do të kenë funksionin e zonave bllokuese për kufizimin e shtrirjes urbane dhe gjithashtu të krijojnë mundësinë për përdorime rekreative të hapësirave publike.
- Këto “kanale natyrore”, do të përdoren për lëvizjen e turistëve nga një zonë e mbrojtur, në tjetrën.
- Si zona të përshtatshme për ecje, çiklizëm apo sport.

PPV duhet të përcaktojë gjithashtu edhe zonat me rreziqe mjedisore, për këto territore; si rrëshqitjet, erozioni, zonat e rrezikuara nga përmytjet në vijën bregdetare. Gjithashtu, ato duhet të përcaktojë parametrat e ndërtimeve të reja, në afërsi të këtyre korridoreve, për rastet që aty pranë mund të ketë lokalitete të zhvilluara, në mënyrë që të parandalohen dëmet që këto ndërtime mund të shkaktojnë.

#### 1.2.4.5 Sistemi Infrastrukturor

Sistemi infrastrukturor (IN) përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar, nivel qarku dhe vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “infrastrukturë”.

**Objektivi kryesor:** Integrimi hapësinor, rritja e aksesueshmërisë së vendit dhe shpërndarje e balancuar të flukseve.

**Politika:** Krijimi dhe konsolidimi i një Sistemi të integruar multimodal mbarë kombëtar, rritje dhe konsolidim i pikave të aksesit dhe të lidhjes së territorit.

Me formulimin e kërkesave të aksesueshmërisë për qendrat kryesore dhe sekondare duhet të garantohet roli qendror i tyre dhe të sigurohet cilësia e qendrave prioritare si pika spirancë në hapësirën dhe mobilitetin e njerëzve për sa i përket ofrimit të shërbimeve publike. Më tej, hierarkizimi i rolit të këtyre qendrave, kërkon vendosjen e prioriteteve lidhur me sigurimin, zgjerimin, dhe sipas rastit ngritjen e rrjeteve dhe korridoreve të reja infrastrukturore dhe mirëfunksionimin e tyre.

Politikat e propozuara lidhen me organizimin e territorit në sistemin e hierarkizimit të qendrave urbane dhe zhvillimi i korridoreve të integruara të flukseve të infrastrukturës.

Për transportin objektivi kryesor është zhvillimi i tipit multimodale dhe miqësor ndaj ambientit.

Objektivat e tjera të PPV-së së në lidhje me sistemin infrastrukturor janë:

- Parashikimi i rrjetit të transportit që mundëson lidhjen e shpejtë të qendrave urbane.
- Parashikimi i rrjetit të transportit që mundëson lidhjen e shpejtë të qendrave prioritare, si qendra që ofrojnë shërbime publike të specializuara e të avancuara.
- Promovimi i transportit publik si dhe transportit alternativ nëpërmjet infrastrukturës së butë, rrugë për biçikleta dhe këmbësorë.
- Rinovimi i hekurudhave ekzistuese.
- Klasifikimi i rrjetit rrugor ekzistues dhe të parashikuar në:
  - rrjet të kategorisë I
  - rrjet të kategorisë II
  - rrjet të kategorisë III
- Përcaktimi i “Vijës së kuqe” ose vijës së ndërtimit të rrugës për çdo tip rrjeti dhe korridori të përfshirë në Sistem. Vija e kuqe është kufiri i lejuar për vendosjen e një ndërtimi në anët e trupit të rrugës që i referohet ose vija kufizuese e të gjithë brezave mbrojtës, si p.sh., brezat mbrojtës të përcaktuar nga Kodi Rrugor, të zonave të mbrojtura nga legjislacioni i mjedisit, kulturës, energjisë etj., si edhe breza mbrojtës të përcaktuar nga dokumentet e planifikimit.

### ***Transporti ujor***

Në bregdetin e Republikës së Shqipërisë ndodhen dhe gjashtë porte detare, katër prej të cilave shërbejnë për transportin e pasagjerëve dhe të mallrave dhe administrohen nga shteti ndërsa dy portet tjera janë dhënë me koncesion për transportin e hidrokarbureve dhe konkretisht;

Porti i Shëngjinit është Porti detar më verior i Republikës së Shqipërisë dhe më i rëndësishmi për bashkinë Vau-Dejës. Përveç përpunimit të mallrave dhe transportit të udhëtarëve ky port shërben edhe për anijet e peshkimit.

Gjithashtu, territori i bashkisë përshkohet nga një rrjet ujor i lundrueshëm që mund të shërbejë në zhvillimin e këtij transporti dhe në ndërlidhje më të fortë të qendrave të banuara që ndodhen pranë tij. Ky rrjet mund të jetë promotor i zhvillimit turistik dhe si i tillë përbën një nga asetet kryesore të territorit.

### ***Turizmi***

Nga vlerësimi i të gjitha tipologjive të turizmit, në planin e integruar ndërsektorial të bregdetit, prezantohen 6 grup-ndarjeje, të cilat janë konsideruar si më të rëndësishmet për zonën e bregdetit të Shqipërisë, për nga pesha e lartë që ato zënë dhe kontribuojnë në PBB-së aktuale të Shqipërisë dhe të bregdetit, dhe për perspektiven e rritjes që ato paraqesin për të ardhmen, 2030.




Fig. 9 Kategorizimi i turizmit sipas PINSB



- Turizmi bregdetar, përfshirë diellin dhe plazhin, lundrimin, zhytjet për eksplorimin e detit në thellësi, edukimi mbi lundrimin, florën-faunën, sporte detare, peshkim, etj.
- Turizmi kulturor duke shfrytëzuar potencialet e mëdha të historisë dhe kulturës së pasur shqiptare në të gjithë territorin e saj.
- Turizmi natyror/ekoturizëm, dhe turizmin rural si produkt i vogël turistik por që po zhvillohet me shpejtësi; përfshirë atraksionet turistike natyrore, si: malet, parqet kombëtare, peizazhet tërheqëse, florën dhe faunën unike të ekosistemeve të ndryshme, liqenet lumenjtë dhe fshatrat tipikë me jetë autentike rurale, produkte agro biodiversiteti që ofrohen dhe promovohen përmes turizmit.
- Agroturizëm, i cili bazohet jo vetëm tek produktet lokale biologjike të pasura me vlera të larta ushqyese, që i ofrohen turistit kombëtar dhe atij ndërkombëtar lidhur me sektorët e bujqësisë e blegtorisë, por edhe tek produktet e përpunuara për t'i transformuar ato në edhe në variete më të pasura, tipike të kulinarisë tradicionale shqiptare.
- Turizmi malor, si pjesë përbërëse e rëndësishme e turizmit natyror-rural, rrit ofertën turistike të Shqipërisë në nivele më të larta, duke konsideruar faktin se pjesa më e madhe e territorit të Shqipërisë është territor malor. Ky lloj turizmi nuk është i aksesueshëm vetëm në stinë dimërore, për ecje, ngjitje në mal kur bie dëborë, apo dhe për sportet si ski, ngjitje, ecje sportive, etj., por edhe gjatë sezoneve të tjera, si; pranverë, vjeshtë, dhe verë për të praktikuar ecjen sportive, shëtitje me biçikleta, kamping në mal, hipizëm, alpinizëm, etj.
- Turizmi i sporteve të ndryshme. Territori i Shqipërisë, me karakterin e tij shumë të alternuar për nga relievi dhe pasuritë natyrore, ofron mundësinë e zhvillimit të të gjitha llojeve të sporteve, të cilat nisin nga ato të një niveli të lehtë për tu aplikuar (noti, lundrimi, në det, lumenj, liqene, ecje, çiklizëm, hipizëm, golf, tenis, etj.) e deri tek aplikimi i sporteve ekstreme, për nga vështirësia e tyre (hedhje me parashutë, gara me makina nëpër terrene të vështirë, zhytje, ski, snowboard, alpinizëm, etj.).

Në territorin e bashkive Vau-Dejës gjejnë vend pothuajse të gjitha tipologjitë e turizmit të përcaktuara më sipër, përveç turizmit bregdetar, i cili është lehtësisht i aksesueshëm në plazhin e Velipojës, mjaft pranë territorit të bashkisë. PPV, në përshtatje me territorin dhe në përputhje me mundësitë e zhvillimit të tipologjive të ndryshme të turizmit, do bëjë propozime konkrete për fuqizimin e atyre lokalitete ku aktualisht ka aktivitet turistik dhe promovimin e zonave apo qendrave të tjera të cilat mbartin potencial turistik por për arsye të ndryshme nuk janë të vizitueshme aktualisht.

Në vijim të këtij dokumenti, në kapitullin që ka lidhje me Veprimet Strategjike dhe Projektet e Zhvillimit një fokus i veçantë i është dhënë dhe turizmit. Përveç promovimit të aseteve turistike që aktualisht gjenden në këtë territor konstatohet e domosdoshme rritja e aksesit të tyre përmes infrastrukturës rrugore dhe ujore me impakt të ulët mjedisor. Si përfundim mund të themi që të gjitha propozimet strategjike kanë lidhje, direkte ose indirekte, me zhvillimin e tipologjive të ndryshme të turizmit në këtë zonë.

## 1.3 VIZIONI I PERSPEKTIVËS

### 1.3.1 Zhvillimi i ekonomisë

Bashkia Vau-Dejës paraqet një potencial të dukshëm për zhvillim ekonomik që mund të arrihet nëpërmjet zhvillimit të resurseve të saj thelbësore: bujqësisë dhe turizmit. Bujqësia gëzon një kategori tokash shumë pjellore dhe pjesërisht tashmë të vlerësuara për produkte me vlerë të lartë të shtuar. Turizmi mund të mbështetet në resursin e jashtëzakonshëm të lumit Drin me liqenet e tij dhe burime të tjera arkeologjike – kulturore. Shfrytëzimi me efikasitet i këtyre burimeve dhe shkalla e zhvillimit të bashkisë janë të lidhura dukshëm me normën e rritjes së të gjithë vendit. Në veçanti, siç diskutohet më poshtë, zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe turizmit të bashkisë dhe vendit varen të dyja nga tejkalimi i problemeve strukturore që kanë të bëjnë me gjithë vendin.

Perspektivat për rritjen ekonomike të vendit, si ato të Bashkisë Vau-Dejës, janë shumë inkurajuese por, në të njëjtën kohë, të pasigurta. Shqipëria është klasifikuar si një vend në zhvillim me “të ardhura mesatare-të larta” sipas Bankës Botërore dhe mendohet gjerësisht se vendi ka potencial të konsiderueshëm për rritjen ekonomike dhe integrimin progresiv me ekonomitë e BE-së, duke përfshirë Italinë, që është partneri i tij më i madh tregtar.



Fig. 10 PBB i Shqipërisë për banor

Kushtet ekonomike të popullsisë ndryshojnë në varësi të zonave të banimit, me popullsi rurale të nënshtruar një gjendjeje varfërie të përhapur, situatë që ka krijuar një fluks migrimi nga zonat rurale në ato urbane. Norma e papunësisë së forcës zyrtare të punës, e cila është rreth 17% në vitet e fundit, nuk është më e keqe se ajo e disa vendeve të zhvilluara në BE, por ajo fsheh një nënpunësim të gjerë të burimeve njerëzore shqiptare. Ekonomia karakterizohet

edhe nga përhapja e aktivitetit “informal” që ka shpëtuar tërësisht nga kontrolli i qeverisë dhe tatimet.

Pikat e forta më kryesore të ekonomisë janë:

- i. Kostoja e ulët e punës,
- ii. Pasuria e lëndëve të para (sidomos minerale dhe resurset ujore),
- iii. Potenciali i prodhimit të energjisë hidroelektrike dhe me kosto të ulët të kësaj të fundit,
- iv. Vendndodhja strategjike gjeografike në qendër të Mesdheut,
- v. Tatimi i ulët i cili ka një diferencë të ndjeshme me ekonomitë fqinje të BE-së.

Këto elemente të përparësisë konkurruese kanë dhënë fryte falë reformave të paraqitura nga fund të viteve '90, të cilat prodhuan një rritje të qëndrueshme të PBB-së (GDP) (më i madhi ndër vendet e rajonit) deri në vitin 2008, viti i fillimit të krizës ndërkombëtare financiare dhe ekonomike ende në vazhdim, si tregojnë të dhënat e mëposhtme (burimi FMN):

*Tabela 1 Rritja e PBB në Shqipëri 2000-2014*

Viti:	2000	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
% e rritjes PBB-së:	6,66	5,43	5,9	7,53	3,35	3,71	2,55	1,42	1,11	2,17

Në vitet në vijim, rritja e PBB ka përjetuar një ngadalësim gradual deri në vitin 2014 pas së cilit pritet një rritje të moderuar, por e qëndrueshme, sipas parashikimeve të bëra nga Banka Botërore:

*Tabela 2 Parashikimi për rritjen e PBB në Shqipëri 2015-2021*

Viti:	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
% e rritjes PBB-së:	2.639	3.433	3.776	4.102	4.144	4.142	4.135

Duhet theksuar se këto parashikime, edhe pse pozitive, karakterizohen nga një shkallë e lartë pasigurie, si për shkak të pranisë së problemeve strukturore të ekonomisë ashtu edhe për shkak të gjendjes ekonomike ndërkombëtare të pafavorshme. Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, vendi ka bërë progres të konsiderueshëm në qasjen ndaj funksionimit të një ekonomie tregu moderne, por mbeten disa probleme të pazgjadhura që pengojnë zhvillimin ekonomik. Këto vështirësi ekzistojnë si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal. Lidhur me Bashkinë Vau-Dejës, vështirësitë më të rëndësishme në lidhje me rritjen ekonomike janë si më poshtë:

- i. Pasiguria e të drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore të dhënë pas përfundimit të regjimit komunist. Kjo pasiguri krijon konflikt të lartë gjyqësor në popullatë dhe rreziqe që pengojnë investimet private (sidomos të huaj);

- ii. Fragmentimi ekstrem i pronësisë së tokës bujqësore, me ferma bujqësore familjare dhe shpesh aktive në prodhimin për konsum vetjak;
- iii. Mungesa e infrastrukturës logjistike për ruajtjen dhe transportimin e mallrave, veçanërisht fruta dhe perime dhe bulmet;
- iv. Disponueshmëria e kufizuar e kredisë bankare;
- v. Mungesa e një menaxhimi të përshtatshëm të ciklit të mbeturinave dhe nivelet e larta të ndotjes, të cilat kufizojnë shfrytëzimin turistik të territorit dhe zhvillimin e një bujqësie biologjike me vlerë të shtuar;
- vi. Pamjaftueshmëria e rrjetit të kanaleve të ujitjes dhe kullimit të fushave dhe e sistemit të parandalimit të përmytjeve;
- vii. Mungesa e infrastrukturës tjetër themelore, e tillë si kanalizime dhe ujë i pijshëm, rrjeti rrugor, rrjeti hekurudhor etj.

Për këto arsye, perspektivat e zhvillimit të Bashkisë paraqiten potencialisht të rëndësishme por të pasigurta; për t'u realizuar, është e nevojshme që të përmbushet procesi i transformimit institucional dhe modernizimi strukturor në të cilën, aktualisht, i gjithë vendi duket i angazhuar.

### **Investimi në kategoritë bazë dhe infrastrukturë**

Ekziston një konsensus i gjerë se ekonomia shqiptare ka nevojë të madhe për një modernizim të thellë të infrastrukturës. Duke marrë parasysh infrastrukturën e dobët të vendit dhe të Bashkisë Vau-Dejës, është mjaft e arsyeshme që investimet që do të jenë në gjendje të kalojnë këto boshllëqe do të kenë një rendiment ekonomik në rritje, dmth. ato do të gjenerojnë më shumë fitime ekonomike, më shumë sesa në përpjesëtim me investimet e bëra, si në terma afatshkurtër ashtu dhe në ato afatgjatë. Në terma afatshkurtër, investimet themelore në infrastrukturë do të ketë një efekt pozitiv të dukshëm në nivelet e punësimit dhe të ardhurave në rajon. Sipas Armela Mançellari, në "Efektet makroekonomike të politikës fiskale në Shqipëri: një qasje SVAR, "Macroeconomic effects of fiscal policy in Albania: A Svar approach", Bank of Albania, Working Paper Series, "në Shqipëri shumëzuesi i GDP i shpenzimeve kapitale është 0.95 pas një tremujori", d.m.th. shumëzuesi afatshkurtër për investimet publike është afër njësisë: për çdo euro të shpenzuar në llogari kapitale, GDP e vendit rritet me 95 cent. Besohet se ky efekt shumëzues i shpenzimit publik ka madhësi të ngjashme edhe në nivel rajonal. Në terma teknikë, bëhet fjalë për shpenzimin publik të aftë për të gjeneruar një *rritje endogjene (endogenous growth)*, pra në gjendje për të filluar proceset e vërtetshme të rritjes që vetëushqehen.

Kjo PPV identifikon gjashtë Objektiva Strategjike, ndër të cilat tre të parat – 1. Pajisja me Shërbimet Bazë, 2. Lëvizja me Mënyra të Ndryshme dhe 3. Qendrat Urbane – të cilat shtjellohen në një seri investimesh publike që synojnë ngushtimin e deficitit në kategoritë bazë dhe infrastrukturës së territorit. Këto investime janë një kusht i domosdoshëm për të realizuar

potencialin e zhvillimit ekonomik të rajonit dhe janë të përfshira plotësisht në kategorinë e shpenzimit publik që mund të gjenerojnë rritjen endogjene.

### Bujqësia dhe blegtoria

Bujqësia dhe blegtoria përbëjnë burimin kryesor ekonomik të popullsisë. Vreshtaria dhe kultivimi i frutave janë të pranishme, së bashku me prodhime të tjera me vlere të lartë të shtuar, të tilla si kultivimi i bimëve në serra. Nga një total prej 9681 hektarë tokë arë, në kemi 497 hektarë pemë frutore, 336 hektarë ullishte dhe 256 hektarë vreshta. Pjelloria e tokës bën të mundur gjithashtu mbarështimin e kafshëve dhe shpendëve, i cili është aktiviteti kryesor ekonomik për popullsinë vendase, në sajë të shitjes së produkteve të kafshëve, të tilla si mish, qumësht dhe djathë (me Zadrimën e cila tashmë gëzon tregun e saj në nivel lokal dhe kombëtar), vezë dhe produkte të tjera.

*Tabela 3 Të dhëna për strukturën e tokës bujqësore sipas njërive administrative (Local Operational Development Plan Vau-Dejës, UNDP, 2016)*

Njësitë administrative	Tokë Bujqësore (ha)				Pyje (ha)	Livadhe Kullota (ha)	Të tjera
	Ara (ha)	Pemishte (ha)	Ullishte (ha)	Vreshta (ha)			
Vau-Dejës	926	46	90	40	6834	453	313
Bushat	5665	225	20	55	1381	519	2059
Hajmel	1851	15	128	70	763	56	168
Vig Mnelë	190	10	55	7	5256	660	136
Shllak	114	141	-	43	8027	99	1200
Temal	935	60	43	41	6204	355	29
<b>Total</b>	<b>9681</b>	<b>497</b>	<b>336</b>	<b>256</b>	<b>28465</b>	<b>2142</b>	<b>3905</b>

Potencialët e mëdha të sektorit bujqësor të bashkisë ndikohen nga një numër faktorësh:

- i) Pozicioni gjeografik dhe natyra e klimës lejon të zgjerohet vëllimi dhe gama e produkteve të ofruara në tregun evropian me çmime konkurruese;
- ii) Sasia e madhe e burimeve hidrike (ujore);
- iii) Moshë mesatare e re e fermerëve;
- iv) Rritja, aktuale dhe potenciale, e sektorit turistik të rajonit dhe gjithë vendit, integrimi i të cilit me bujqësinë dhe agroturizmin, me siguri mund të nxisë përhapjen e produkteve lokale dhe rajonale.

Pengesat në zhvillimin e prodhimit bujqësor të bashkisë Vau-Dejës janë të njëjta me ato që rëndojnë sektorin në nivel kombëtar, të diskutuar tashmë më sipër: fragmentimi i pronësisë së tokës, bizneset shumë të vogla, prodhimi i orientuar për vetë konsum dhe jo për treg,

mungesa e organizatave të prodhuesve (të tilla si konsorciume dhe zinxhirë të organizuar), mungesa e rrugëve të asfaltuara në zonat rurale, mungesa e strukturave të logjistikës, etj.

Për të inkurajuar zhvillimin e bujqësisë në bashkinë Vau-Dejës, janë të nevojshme kryesisht ndërhyrjet që synojnë të kapërcejnë problemin e fragmentimit të pronës bujqësore dhe të kompanive në këtë sektor. Përditësimi i hartave kadastrale dhe përcaktimi i të drejtave të pronësisë mbi tokën bujqësore janë ndërhyrje të nevojshme dhe që nuk duhen neglizhuar. Në terma afatgjatë, politikat e ndërmarra për të kapërcyer pasigurinë mbi të drejtat e pronësisë mbi tokat bujqësore do të japin fryte, duke mundësuar krijimin e një tregu të tokës bujqësore. Ekzistenca e këtij tregu, nga ana tjetër, do të mundësojë që kompanitë më efikase të rriten dhe të arrijnë një shkallë minimale të efektshme dhe do të lehtësojë investimet e operatorëve të huaj. Megjithatë, koha për këtë transformim strukturor, është e pasigurte dhe pa dyshim e gjatë. Ndërkohë, është e mundur të përmirësohet ndjeshëm efikasiteti i sektorit lokal të bujqësisë nëpërmjet linjave të mëposhtme të ndërhyrjes:

- i) Organizimi i logjistikës, duke krijuar në vend qendra për magazinimin, ngrirjen dhe shpërndarjen e produkteve bujqësore.
- ii) Krijimi i zonave të tregut.
- iii) Përmirësimi dhe zhvillimi i rrjetit të kanaleve të ujitjes dhe kullimit të fushore dhe i sistemit për parandalimin e përmytjeve.
- iv) Përditësimi i hartave kadastrale dhe përcaktimi i të drejtave të pronësisë mbi tokat bujqësore.
- v) Mbështetje për krijimin e produkteve të reja në sektorë tashmë të pranishëm në territori si: kultivimi i orizit, shegës, perimeve në serrë, vreshtaria, kultivimi i peshkut dhe bletaria.
- vi) Mbështetja për krijimin dhe veprimin e konsorciumeve mes fermerëve dhe të zinxhirëve të shkurtër agro-industrial, me qëllim për të realizuar në territor përpunimin e produkteve të qumështit dhe fruta perimeve.
- vii) Aktiviteti për trajnimin, informimin dhe koordinimin e prodhuesve bujqësorë nëpërmjet hapjes së një sporteli /zyre bashkiak.
- viii) Promovimi i aktiviteteve që synojnë arritjen e njohjes së produkteve ushqimore me certifikim Evropian (Tregues i Mbrojtur Gjeografik, Markë e Mbrojtur Origjine, etj.).

Këto politika janë artikuluar në "Programe" dhe "Projekte" të parashikuara në "Objektivin Strategjik" të peste të kësaj PPV-je: Bujqësia, blegtoaria dhe kultivimi i peshkut. Këto ndërhyrje, që synojnë krijimin e kushteve të nevojshme për transformimin e sistemit bujqësor vendor, duhet të kryhen paralelisht me zhvillimin turistik të liqenit në Park Lumor. Zhvillimi i turizmit dhe agroturizmit në këtë zonë, përveçse garanton një ndikim të dukshëm në nivelet e të ardhurave dhe punësimit në territor, do të zgjeronte përmasat e tregjeve të brendshme dhe të huaja për prodhimet ushqimore vendase me vlere të lartë të shtuar.

## **Sektori i turizmit**

Sektori i turizmit në Shqipëri ka shënuar një rritje progresive duke filluar nga fundi i viteve '90, që në vitet e fundit është bërë e jashtëzakonshme. Numri i turistëve të huaj u rrit nga 500.000 në vitin 2005 në 4.2 milionë në vitin 2015, me një shpenzim mesatar ditor për turist të vlerësuar rreth 80 euro. Në sajë të këtij zhvillimi eksponencial të xhiros së sektorit, turizmi tani kontribuon me më shumë se 10% të PBB-së, duke konsideruar edhe induktimin që gjeneron në tregti dhe në restorante. Vlerësohet se, në vitin 2013, sektori ka prodhuar një fluks të ardhurash nga turistët e huaj deri në 1,67 miliardë dollarë amerikanë.

Resurset peizazhiste, arkeologjike dhe kulturore të vendit janë një burim i jashtëzakonshëm, shfrytëzimi komercial i të cilave është padyshim i destinuar të rritet edhe në sajë të investimeve nga operatorët e huaj.

Sa për territorin e Vau-Dejës, bashkia ka në dispozicion një burim me potencial të madh ekonomik: Parkun Lumor të Drinit me liqenet e tij. Siç tregohet në objektivin e katërt strategjik të PPV-së, "Turizmi", parashikohet zhvillimi i këtij parku nëpërmjet krijimit të një korridorit për mbrojtjen e mjedisit në mes të zonave të mbrojtura të Valbonës dhe Bunës e Velipojës, në mënyrë që të arrihet një itinerar i integruar turistik nga Alpet për në det.

Në kuadër të këtij itinerari turistik, Parku Lumor luan një rol themelor, në sajë të lundrueshmërisë dhe bukurisë së jashtëzakonshme të tij. Aktualisht, ekzistojnë firma private që ofrojnë shërbime trageti dhe ekskursionit lumor në itinerarin Koman – Fierzë në periudhën Maj-Tetor. Prania e këtyre aktiviteteve tregon qëndrueshmëri ekonomike të ndërmarrjeve të angazhuara në ofrimin e shërbimeve të ngjashme në itinerarin lumor që shkon nga Vau-Dejës në Koman. Me fjalë të tjera, transporti lumor i makinave, udhëtarëve lokale dhe turistëve nga Vau-Dejës në Koman përbën një "projekt të nxehtë", d.m.th. një ndërhyrje që gjeneron kthime ekonomike të mjaftueshme për të justifikuar investimet private. Në mënyrë që kapitali privat të veprojë, është e nevojshme që ndihma publike të ndërhyjë duke krijuar kushtet strukturore. Në rastin konkret, do të jetë i nevojshëm dhe i mjaftueshëm realizimi i një moli në Vau-Dejës, që duhet lidhur me qytetin dhe duhet të jetë i pajisur me shërbimet e nevojshme dhe një mol në Koman. Ndër të tjera, këto vepra publike janë pothuajse një zgjedhje e natyrshme nëse kërkohet përmirësimi i lëvizshmërinë në këtë zonë, duke pasur parasysh lundrueshmërinë e lumit dhe gjendjen e keqe të rrugës që lidh Vau-Dejën me Komanin, si dhe për të lehtësuar zhvillimin e turizmit të korridorit Valbonë – Velipojë. Kjo e fundit do të jetë forcë shtytëse për zhvillimin e burimeve të tjera turistike që ka territori, ato kulturore dhe arkeologjike.

### 1.3.2 Zhvillimi dhe rigjenerimi i territorit

Sistemi territorial nga i cili është e përbërë bashkia e re Vau-Dejës për shkak të bashkimit administrativ të gjashtë njësisve të mëparshme Vau-Dejës, Bushat, Hajmel, Vig-Mnelë, Shllak, Temal, paraqet diversitet të dukshëm nga pikëpamja e profilit peizazhistik dhe territorial. Pa hyrë në arsyet që kanë çuar autoritetet vendimmarrëse për t'u orientuar drejt kësaj ndarjeje gjeografike, duhet të bëhen përpjekje për ta parë këtë vendim si një mundësi për të hartuar



një strategji të përgjithshme të të gjithë kompleksit të ri territorial, të orientuar në riorganizimin dhe rigjenerimin hapësinor, përpara se të trajtohet zhvillimi i vendbanimeve dhe funksioneve të reja. Një strategji që me siguri duhet adresuar drejt qëndrueshmërisë së lartë, në mënyrë që të kundërveprojë dhe të kthejë në pozitive shumë nga dinamikat territoriale që kanë çuar të gjithë territorin, në vitet e trazuara të tranzicionit drejt ekonomisë së tregut, në degradim të dukshëm të territorit dhe të mirëqenies së popullsisë lokale.

Në fakt, bëhet fjalë për një territor që, kur vërehet nga jugu në veri, nga kufiri me Bashkinë e Lezhës dhe Shkodrës, drejt njësive që i përkasin zonës së mbrojtur të Alpeve Shqiptare, duket kryesisht e karakterizuar nga tre lloje peizazhesh:

- A. zona fushore bujqësore, e karakterizuar nga sistemi i gjerë kullues afër rrjedhës kryesore ujore (lumi Drin), drejt bashkimit të saj me pellgjet ujore të rajonit të Shkodrës, ku zhvillimi i vendbanimeve ka qenë më i madh, shpesh duke dëmtuar tokat bujqësore me pjellori të lartë;
- B. territori ujqor, i përbërë nga lumi Drin, i zgjeruar nga ndërtimi i hidrocentraleve të mëdha duke filluar nga fundi i viteve '60 (diga e Vau-Dejës dhe e Komanit);
- C. zona gjerë dhe pothuajse e pabanuar malore, një prelud për zhvillimin e sistemeve malore më të larta të rajonit, objekte të mbrojtjes mjedisore (Parku Kombëtar i Alpeve).

Termi "Peizazh" është përdorur këtu në kuptimin e tij strategjik-planifikues – sipas përkufizimit të dhënë nga Konferenca Evropiane për Peizazhin, Firence, 2000 – si një njësi territori e karakterizuar nga kushte homogjene nën profilin: (i) e karakteristikave gjeografike dhe morfologjike–hapësinore; (ii) të vendbanimeve të njerëzve dhe të përdorimeve mbizotëruese të tokës; (iii) të perspektivës programatike dhe qeverisjes së transformimeve.

Ky klasifikim i peizazheve mbizotëruese, i realizuar vetëm për qëllimin strategjik të programit, nuk përfshin disa "përrjashtime" lokale, të cilat gjithashtu duhen marrë parasysh për të pasur një analizë më të plotë dhe që mund të jenë një prelud për një artikulum të mëtejshëm të rregullave të përgjithshme, të cilat duhen zhvilluar në pjesën e rregullores së planit të ri:

- Peizazhi i korridorit infrastrukturor që përbëhet nga rruga kombëtare dhe linja hekurudhore;
- Peizazhi i kodrave që ngrihen brenda zonës fushore, dhe në të cilin gjenden vendbanimet e ultësirës.
- Peizazhi i qendrave të mëdha urbane, Bushat dhe Vau-Dejës, që ende nuk ngrihen në rangun e realiteteve të mirëfillta urbane, por që tashmë paraqesin një përqendrim urban të rëndësishëm nëse krahasohen me përqendrimin e ulët të vendbanimeve në zonat e tjera, sidomos në zonat malore.

Linjat e zhvillimit dhe rigjenerimit territorial që paraqiten në këto shënime fillestare, duhet të marrin parasysh këto karakteristika specifike të peizazhit, së bashku me një lexim të morfologjisë së vendbanimeve që shfaqen gjithashtu fortësisht të karakterizuara në lidhje me kontekste të tilla.

Parimet themelore që duhet të orientojnë këtë strategji territoriale, duhet të përfshijnë:

**A. Aspektet e peizazhit të ultësirës bujqësore**

- p.1 Kontrolli i konsumit të tokës bujqësore
- p.2 Sigurimi i vendbanimeve nga rreziku hidrik dhe hidro-geologjik
- p.3 Pajisja me mjete dhe shërbime urbane bazë
- p.4 Përshtatja e infrastrukturave të lëvizjes dhe transportit

**B. Aspektet e peizazhit malor të brendshëm**

- p.5 Mbrojtja e mjedisit dhe peizazhit
- p.5 Mbështetja e vendbanimeve dhe aktiviteteve të "monitorimit" të zonës malore
- p.6 Hapje ndaj turizmit të qëndrueshëm duke respektuar cilësitë territoriale të peizazhit
- p.7 Zhvillimi i trashëgimisë ujore edhe për qëllime energjetike, në harmoni me vlerat mjedisore dhe të peizazhit të zonës

### 1.3.3 Vizioni i përbashkët udhëzues

#### 1. Metodologjia

Përkufizimi i vizionit të përbashkët udhëzues, vazhdon nëpërmjet një akti të parë përcaktues, që do t'i nënshtrohet një diskutimi publik, në kuadër të procedurave të pjesëmarrjes të përcaktuara nga legjislacioni në procesin e hartimit të Planit.

Ideja është që të organizohen një sërë takimesh publike sipas kategorive të palëve të interesuara, gjithsesi të hapura për pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve, ku ky përkufizim i parë i vizionit paraqitet dhe diskutohet, duke e lënë atë të hapur për kontribut nga të gjithë.

Është gjithashtu e mundshme, si një eksperiment, t'i kushtohet një takim i veçantë, shkollave të bashkisë, si atyre të mesme ashtu edhe atyre profesionale, për të zgjeruar pjesëmarrjen në Plan, si një eksperiment, të kësaj kategorie të veçantë të "qytetarët e rinj".

Vizioni përbëhet nga një përkufizim fillestar, nga një imazh sqarues dhe evokativ, nga një listë kriteresh udhëzuese dhe objektivash strategjike mbi të cilat është trajtuar strategjia e përgjithshme, e vënë në zbatim për realizimin e vetë Vizionit, të shtjelluar në programe dhe projekte. Këto projekte, në një fazë të mëvonshme të formimit të Planit, gjejnë përcaktim në kategori të ndryshme projektesh (projekte pilot, projekte strategjike, projekte bazë), për të

cilat Plani Strategjik përcakton përmbajtjen, qëllimin, subjektet e përfshira, kostot dhe burimet e nevojshme, kanalet e financimit, procedurat e zbatimit, efektet e pritshme.

## **2. Përkufizime**

Vlejnë përkufizimet e mëposhtme:

### ***Kritere të përgjithshme të planit***

Në gjuhën shkencore, rregull, zakonisht i thjeshtë dhe shpesh mbi baza empirike për të gjykuar më lehtësisht nëse një trup përmbush ose jo kërkesa të caktuara, nëse një fenomen mundet ose jo të zhvillohet në një mënyrë të caktuar (Treccani). Në kuptimin e dhënë në këtë studim: grup parimesh të përgjithshme që përbëjnë sfondin e përcaktimit të objektivave të planit.

### ***Objektivat strategjike***

Përfaqësojnë vijat e përgjithshme tematike përgjatë të cilave shtjellohen synimet e Planit Strategjik.

### ***Programet***

Janë përfundimet që plani synon të arrijë nëpërmjet realizimit të projekteve të caktuara; duke pranuar kryesisht një përcaktim hapësinor ose tematik: janë lehtësisht të referueshëm në kontekste lokale apo në pjesë të tyre, të identifikueshme në terma territorialë dhe të përcaktueshëm në hartë, ose në fusha tematike karakteristike.

### ***Projektet***

Kanë të bëjnë me grupe aktivitesh ose aktivitete individuale që janë pasojë e ndjekjes së objektivave specifike (çfarë duhet të bëhet për ...); përkufizimi i tyre në terma të masës, kohës, subjekteve të përfshira dhe resurseve të nevojshme çon në përcaktimin e projekteve të Planit Strategjik. Një projekt i vetëm mund të parashikojë brenda tij veprime të ndryshme dhe të ketë si synim ndjekjen shumë objektivave. Në këtë rast, projekti merr rolin dhe thelbin e "projektit të integruar".

### ***Projektet Pilot***


Janë projektet e Planit të cilëve u është besuar nisja e strategjisë së përgjithshme të planit. Për nga natyra e tyre, ato nuk përbëjnë investime shumë të mëdha dhe gjejnë zbatim në fillim të procesit të zbatimit të Planit.

### ***Projektet strategjike***

Janë projektet me rëndësinë dhe angazhimin më të madh; identifikimi i tyre kërkon një vlerësim të kujdesshëm të koherencës, të proceseve që janë në vazhdim, të vlerësimit paraprak të efekteve dhe rezultateve të pritshme; zbatimi i tyre kërkon verifikimin e kushteve të fizibilitetit administrativ, urbanistik, financiar dhe ekonomik dhe të qëndrueshmërisë ekologjike-mjedisore dhe socio-ekonomike.

### ***Projektet bazë apo të sistemit***

Përbëjnë kushtet paraprake për zhvillim të qëndrueshëm të kontekstit vendor, kanë të bëjnë me përmbushjen e kushteve bazë në lidhje me pajisjen me shërbime urbane, të infrastrukturave dhe rrjeteve. Projektet dhe veprat bazë, mund të gjejnë përcaktim dhe zbatim edhe në kuadër të projekteve strategjike, edhe nëpërmjet formave të partneritetit publik-privat dhe me sektorin e terciar.



*Fig. 11 Zhvillimi i territorit nga deti në Alpe*

### 3. Deklarata territoriale

#### ***Vau-Dejës, vendi i tokës së mirë dhe ujit miqësor***

Territori i Vau-Dejës është një territor i dedikuar për përdorim bujqësor të tokës, mbrojtjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve ujore, ruajtjen e peizazheve malore.

Vau-Dejës ruan tokën e saj, të pasur dhe pjellore, prodhuese e ushqimit dhe produkteve natyrore, dhe rrit rolin e saj si një portë hyrëse për në zonat malore të vendit. Në veçanti, ruan dhe kujdeset për peizazhet e saj malore, ku kultura e lashtë, prodhimi i qëndrueshëm, dhe njerëzit që i mbajnë gjallë këto vlera janë një ndihmese në ruajtjen e ekuilibrit të ndjeshëm natyror dhe artificial prodhuar nga tradita shekullore dhe përdorimi i përgjegjshëm i këtyre burimeve, duke krijuar pengesë dhe mbrojtje kundër rreziqeve të luginës, për një jetesë të mirë të një komuniteti të bashkuar dhe të përgjegjshëm.

### 4. Kriteret udhëzuese

Kriteret udhëzuese shtjellohen në kriteret udhëzuese për kontekstet urbane dhe për kontekstet territoriale dhe në pjesën më të madhe dallohen nga detyrat që u jepen në përgjithësi Planeve të Përgjithshme Vendore, në rastin e Italisë, nga instrumentet e niveleve më të larta se niveli lokal dhe që i dedikohen planifikimit të peizazhit (si p.sh. Plani Rajonal Territorial i Peizazhit – PTPR). Këto kriteret janë gjithashtu në koherencë edhe me dispozitat për çështjet e peizazhit që vijnë nga Planet Kombëtare, të analizuara në paragrafët e mësipërm.

#### ***OBU (objektivat bazë të zonës urbane). Peizazhi fushor dhe zonat urbane kryesore***

OBU.1 Parandalimi i konsumit të tokës

OBU.2 Qëndrueshmëria mjedisore e ndërhyrjeve

OBU.3 Ruajtja e karakterit kompakt të vendbanimeve urbane dhe të qendrës urbane kryesore

OBU.4 Rikualifikimi i zonave prodhuese

OBU.5 Zbatimi i parimit të transferimit të së drejtës për zhvillim

OBU.6 Krijimi i zonave në shërbim të transferimit të së drejtës për zhvillim ose të kompensimit të mundshëm të të drejtave më të mëdha për ndërtim

OBU.7 Përfshirja e vendbanimeve të reja për strehim publik në strukturën urbane ekzistuese, që do të realizohet nëpërmjet kompensimit dhe transferimit të së drejtës për zhvillim në zonat e parashikuara për zgjerim

OBU.8 Rigjenerimi i zonave të konsoliduara apo vendbanimeve historike

OBU.9 Rimëkëmbja dhe zhvillimi edhe për përdorim rezidencial dhe turistik të fshatrave të vjetër malorë dhe kodrinorë si dhe rikuperim i ndërtesave historike (kulla)

OBU.10 Mbrojtja, zhvillimi dhe aksesimi i plotë i të mirave të përbashkëta territoriale dhe urbane, i trashëgimisë historike, kulturore, peizazhistike dhe mjedisore;

OBU.11 Rimëkëmbja dhe krijimi i qendrave të reja dhe të mirave të përbashkëta urbane, siç janë hapësirat e gjelbra dhe shërbimet, nëpërmjet mënyrave të reja menaxhuese;

OBU.12 Kundërshtimi i përjashtimit social të banorëve me të ardhura të ulëta

OBU.13 Zhvillimi i rrjeteve ekologjike urbane të integruara me rrjetet e lëvizshmërisë së ngadaltë dhe të turizmit të qëndrueshëm

OBU.14 Mbështetja dhe zhvillimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe kursimit energjetik

OBU.15 Rimëkëmbja dhe rikualifikimi peizazhistik i itinerareve dhe rrugëve të aksesit për në qendrat urbane dhe komplekset e prodhimit industrial, bujqësor dhe të energjisë

***OBM (objektivat bazë të zonës malore). Peizazhet Malore***

OBM.1 Ruajtja dhe zhvillimi i strukturës gjeo-morfologjike natyrore

OBM.2 Mbrojtja dhe zhvillimi i peizazheve malore bujqësore, pyjore dhe kullotave

OBM.3 Ruajtja e strukturës perceptuese dhe e vlerave origjinale të dukshmërisë së peizazheve lokale

OBM.4 Zhvillimi i infrastrukturave të lëvizshmërisë së butë për soditjen e peizazheve

OBM.5 Mbështetja e formave të shpërhapura të banesave malore, vendbanimet në mbrojtje të peizazhit

OBM.6 Zbutja e rrezikut nga shkaqe mjedisore dhe artificiale

OBM.7 Aktivizimi i politikave të zhvillimit të sektorit bujqësor

**5. Objektivat strategjike**

Strategjia e Planit mbështetet në gjashtë objektivat strategjike të mëposhtme:

**OB.1.** Ofrimi i shërbimeve bazë

**OB.2.** Lëvizja me mënyra të ndryshme

**OB.3.** Qendrat urbane

**OB.4.** Turizmi

**OB.5.** Bujqësia, blegtoria dhe kultivimi i peshkut

**OB.6.** Energjia

Objektiva të tilla gjejnë shtjellim dhe përkufizim në përbërjen e Vizionit Strategjik Operativ të përmendur në paragrafët e mëposhtëm.

## 2 STRATEGJIA TERRITORIALE

### 2.1 IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE, POTENCIALEVE DHE PENGESAVE

#### 2.1.1 Analiza SWOT për secilin nga pesë sistemet territoriale (N, U, B, UB, IN)




Fig. 12 Njësitë administrative dhe shtrirja në territor

##### 2.1.1.1 Metodologjia e përdorur

Analiza SWOT, siç dihet, përbën një metodologji të përdorur gjerësisht, me qëllim evidentimin në mënyrë të shpejte dhe efikase të atyre faktorëve, të brendshëm të sistemit (pikat e forta dhe të dobëta) ose të jashtëm (mundësitë dhe rreziqet) të cilët luajnë, ose mund të luajnë, një rol vendimtar në strategjitë e Planit, nëse interpretohen dhe vlerësohen në mënyrën e duhur.

Përdorimi i një metodologjie kaq të afirmuar dhe të praktikuar nga një sërë studimesh, mbart me vete edhe rreziqe, i pari ndër të cilët është bërja e analizës në forme rituale ose teorike, ose si një përmbledhje e thjeshte e analizave të mëparshme që janë të tejkaluara dhe që janë treguar joefikase.





Fig. 13 Parimi i analizës SWOT

Për të evituar këtë, dhe për t'i dhënë analizës rolin e saj vlerësues të faktorëve që bashkëveprojnë në ndërtimin e objektivave dhe strategjive të planit, përveç studimit dhe mbledhjes së studimeve ekzistuese, është kërkuar të paraprihet me realizimi i analizës së detajuar për secilin sistem territorial. që në këtë fazë dalin në pah gjurmë të cilat sugjerojnë mundësi projektsh, duke i paraprirë përputhjes së elementeve SWOT dhe objektivave të planit për përcaktimin e projekteve e cila do të trajtohet dhe argumentohet në paragrafët e mëposhtëm.

Me poshtë është bërë përcaktimi i pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe rreziqeve për secilin nga sistemet, duke iu referuar edhe aktoreve të interesuar (stakeholder, subjekte publike, sektori i tretë) dhe, në disa raste, rolit që secila nga pikat luan në perspektivat e zhvillimit dhe rigjenerimit territorial të zonës së studiuar.

Një trajtim i përgjithshëm i elementeve SWOT për të gjithë territorin e bashkisë Vau-Dejës është bërë në fillim të këtij paragrafi.

#### 2.1.1.2 Analiza e përgjithshme

##### **Pikat e forta**

- Pozicion gjeografik i favorshëm, në brendësi të një territori që përfshin zona malore, kodrinore dhe fushore, të pasur me burime hidrike, në afërsi me detin dhe me një klimë të këndshme
- Territori karakterizohet nga toka mjaft pjellore, peizazhe tërheqëse dhe sipërfaqe të lundrueshme

- Identitet i fortë historik dhe kulturor, lidhur me vendbanimet e vjetra por edhe me kulturën dhe traditën e sotme (kultura e Komanit, qyteti i Sardës, Danjës, Sapës, kultura dhe artizanati i Zadrimës etj.)
- Përfshirja e territorit të Vau-Dejës në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planit Sektorial të Alpeve
- Afërsi me qendrat e Polit të Zhvillimit Rajonal; Shkodrën dhe Lezhën
- Vau-Dejës është pjesë e portës perëndimore të Rajonit Malor Verior
- Përqindje e lartë e popullsisë me moshë të re, popullsi aktive
- Vetëdije e pushtetit vendor të rolit të tij me dëshirën për të kontrolluar zhvillimin e tokës në një bazë të qëndrueshme
- Prirje e komuniteteve lokale drejt veprimeve të solidaritetit dhe mbrojtjes së përbashkët ndaj rreziqeve

### **Pikat e dobëta**

- Nivel i konsiderueshëm i të papunëve dhe rritje e ulët ekonomike
- Nivel i të ardhurave mesatarisht të ulëta në popullsinë lokale
- Prezenca e zonave me periferialitet urban, varfëri dhe përjashtime sociale
- Nivel i lartë i informalitetit, qoftë në ekonomitë ashtu edhe në proceset urbane
- Nivel i ulët i resurseve publike lokale
- Niveli i ulët i ofertës së aftësive teknike dhe profesionale lokale, për shkak të zhvendosjes së fuqisë punëtore të kualifikuar dhe të kuadrove teknike dhe profesionale në qendrat e mëdha urbane (Shkodër, Lezhë, Tiranë)
- Mungesa e strategjive dhe instrumenteve të zhvillimit të bazuar në analiza dhe interpretime të sakta të gjendjes faktike
- Paqartësia e pengesave, ruajtjes dhe mbrojtjes së të mirave të përbashkëta urbane
- Prani e ulët e shoqatave në mbrojtje të pasurisë publike.
- Pasiguri mbi të drejtën e pronës
- Fragmentim i lartë i pronës së tokave bujqësore, me ndërmarrje të tipit familjar që prodhojnë kryesisht për vetëkonsum
- Mungese infrastrukturash për magazinimin dhe transportin e mallrave
- Nivel i ulët i kreditimit bankar, shpeshherë i paaksesueshëm nga ndërmarrjet e vogla dhe shumë të vogla
- Mungesë e menaxhimit të duhur të ciklit të mbetjeve urbane
- Mungesë e infrastrukturave të tjera në pjesë të mëdha të territorit, si rrjetet e kanalizimeve, uji i pijshëm, rrjeti rrugor, rrjeti hekurudhor (tashme pothuajse jashtë përdorimit) etj.

## Mundësitë

- Potencial i lartë ekonomik në bujqësi dhe industri të lehtë
- Zhvillimi i shërbimeve ndaj turizmit në raport me rritjen e kërkesës turistike brenda dhe jashtë vendit
- Çmim i ulët i truallit, i fuqisë punëtore dhe i faktorëve përbërës të ndërtimit
- Mundësia e përfitimit nga afërsia territoriale me qendrat e Polit të Zhvillimit Rajonal, Shkodrën dhe Lezhën, në bazë të lidhje së mirë ekzistuese infrastrukturore.
- Pozicion strategjik në raport me Parkun Kombëtar të Alpeve (Parashikuar nga PPK), që krijon mundësinë për përfshirje në ofertën turistike të rajonit të veriut.
- Rritja, faktike dhe potenciale, e sektorit turistik të vendit, integrimi i të cilit me bujqësinë dhe agro-turizmin mund të ndihmojë në shpërhapjen e produkteve lokale dhe rajonale.
- Prezenca në rritje e investitorëve të huaj , që mundëson krijimin e ekonomive të shkallës, tejkalimin e pengesave të mungesës së likuiditetit për financimin e prodhimit dhe përshtatjen e prodhimit bujqësor shqiptar me kërkesat e cilësisë dhe gjurmueshmërisë të kërkuara nga normativat evropiane.
- Mundësi përfitimi të drejtpërdrejtë ekonomik apo zhvillimor nga prania e katër Hidro Elektro Centraleve dhe landfillit të Bushatit në territorin e bashkisë.

## Rreziqet

- Varfëria, përjashtimi social dhe informaliteti në proceset prodhuese dhe urbane mund të shndërrohen në probleme sociale
- Braktisje në rritje e vendbanimeve rurale dhe malore të brendshëm dhe i zonave bujqësore me përdorim bujqësor dhe blegtoral
- Migrim drejt zonave urbane fushore dhe qendrave urbane rajonale e kombëtare
- Zaptim i tokave prodhuese bujqësore për përdorim rezidencial, edhe në mungesë të drejtës së pronësisë
- Paaftësi e sistemit territorial për të tërhequr projekte dhe investime në prodhim, për shkak të faktorëve të dobësive të shumta të territorit (mungesa e infrastrukturës dhe shërbimeve)
- Degradim territorial në rritje, si pasojë e paaftësisë së kontrollit të zhvillimit të territorit dhe në orientimin e zhvillimit dhe rinovimit urban
- Mungesa e koordinimit dhe marrëdhënieve efikase midis organeve të ndryshme të qeverisjes administrative (administratat lokale dhe rajonale)
- Mungesa e riorganizimit të “makines” administrative lokale në periudhën pas reformës administrative

### 2.1.1.3 Analiza SWOT - Sistemi Natyror

#### **Pikat e forta**

- prezenca e aseteve natyrore, si:
  - a. Peizazhi i mbrojtur Lumi Buna - Velipojë
  - b. Lugina e Drinit dhe liqenet e Vau-Dejës dhe Komanit
  - c. Monumentet natyrore
- Ndërthurja e territorit me Parkun Kombëtar të Alpeve (Propozuar nga PPK)
- Biodiversitet i lartë i pranishëm në territor, i shprehur nga pasuria e florës dhe e faunës e karakterizuar nga lloje të shumta endemike (që nuk gjenden në vende të tjera) dhe nga prezenca e specieve që motivojnë përcaktimin e zonave të mbrojtura ekologjike mjedisore

#### **Pikat e dobëta**

- Mungesa e mjeteve të kontrollit dhe pengimit të modifikimit dhe shkatërrimit të peizazhit natyral dhe resurseve ekologjike nga ana e administratave publike
- Ndërgjegjësim i ulët publik në masat dhe mjetet e kontrollit mjedisor
- Përhapja e vendbanimeve joformale dhe spontane në zonat e mbrojtura dhe me ndjeshmëri të lartë mjedisore, (shtretërit e lumenjve, rripat bregdetarë)
- Degradim progresiv i cilësisë mjedisore të përgjithshme, për shkak të mungesës së sistemeve të trajtimit, rimëkëmbjes, riciklimit dhe ripërdorimit të mbetjeve solide urbane
- Mungesë analoge e sistemeve të përshtatshme të trajtimit të mbetjeve solide urbane, sidomos në kontekstin bujqësor dhe përhapjen urbane

#### **Mundësitë**

- Mundësia e zhvillimit të turizmit natyror, ekskursionistik, sportiv, kulturor dhe arkeologjik, qoftë në zonat e brendshme ashtu edhe në zonat bregdetare
- Mundësi e turizmit dhe e aktiviteteve të kërkimit dhe eksperimentimit në fushën mjedisore dhe në zonat e mbrojtura
- Përmirësimi i përgjithshëm i ekuilibrave ekologjik dhe i faktorit të biodiversitetit për politika të përshtatshme të mbrojtjes dhe progresit ekologjik lokal
- Përmirësimi i përgjithshëm i cilësisë së jetesës në qendrat dhe në kontekstet urbane mbështetur në modelin e zhvillimit të qëndrueshëm duke krijuar një ambient të pastër e të shëndetshëm

## Rreziqet

- Rritja e shtrirjes urbane në dëm të zonave me interes dhe vlera mjedisore dhe peizazheve
- Humbja e resurseve ujore prej ndotjes së akuiferëve sipërfaqësorë dhe nëntokësorë
- Ulja e cilësisë së ajrit dhe mjedisit për shkak të shpyllëzimit progresiv të zonave malore, zonave liqenore, dhe të shtretërve të lumenjve.
- Rrezik i lartë zjarresh për shkak të mungesës së kontrollit, menaxhimit të aktiviteteve pyjore dhe blegtorale, mungesa e kundërvënies ndaj kriminalitetit
- Humbje progresive e biodiversitetit dhe balancave të ekosistemit, zvogëlimi i specieve të mbrojtura, për shkak të mungesës së rregullave, kontrolleve dhe programimeve të aktivitetit të gjuetisë
- Rrezik nga ndotja e mundshme që do të sillte keqmenaxhimi i landfillit të Bushatit

### 2.1.1.4 Analiza SWOT – Sistemi Ujor

#### Pikat e forta

- Prania e resurseve të pasura ujore si në nëntokën dhe në sipërfaqe
  - a. rrjedha uji gjithëvjeçare
  - b. basene ujore
  - c. ujëra nëntokësore
  - d. rrjeti i kanalizimeve artificiale për përdorim bujqësor
- Sipërfaqe të mëdha të lundrueshme

#### Pikat e dobëta

- Rrezik i lartë nga përmytjet në zonat urbane dhe bujqësore
- Mungesa e mirëmbajtjes së rrjetit të ujitjes dhe kullimit
- Shkarkimi i mbetjeve urbane në shtratin e rrjedhave të ujit natyrore dhe artificiale
- Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhat ujore sipërfaqësore
- Mungesa e furnizimit të drejtpërdrejtë me ujë të pijshëm në shumë fshatra dhe qendra të vogla urbane
- Kapacitet i ulët i furnizimit me ujë i të gjitha qendrave urbane
- Mungesa e të ardhurave të përshtatshme nga tarifimi i resurseve ujore

#### Mundësitë

- Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemeve ekzistuese të ujitjes për bujqësinë
- Vijimi i shfrytëzimit të potencialit hidroenergjetik ende të papërdorur

- Racionalizimi i përdorimit të resurseve ujore të pijshme, nëpërmjet masave dhe mjeteve të menaxhimit më të mirë të resurseve të tilla
- Fuqizimi i sistemeve të menaxhimit dhe të shpërndarjes së ujërave publike, të menduara si të mira të përbashkëta
- Rikualifikim dhe rigjenerim në aspektin ekologjik mjedisor të trupave kryesorë ujorë, në dobi të ekosistemeve lokale dhe të një zhvillimi të mundshëm të turizmit sportiv
- Përdorimi i lundrimit si atraksion kryesor në ofertën turistike lokale dhe rajonale
- Zhvillimi i peshkimit dhe kultivimit të peshkut si një sektor ekonomik i rëndësishëm

### **Rreziqet**

- Përkeqësimi i ekosistemeve lokale për shkak të ndotjes së trupave ujor natyralë dhe artificial
- Humbje progresive e pakthyeshme e resurseve ujore të pijshme, për shkak të ndotjeve industriale, bujqësore për shkak të pesticideve dhe plehrave kimike, mbetjet solide dhe të lëngshme urbane, pusët e ujërave të zeza të shpërndara gjerësisht në zonat bujqësore urbane
- Përmbytjet dhe aluvionet periodike, lidhur edhe me përshkallëzimin e fenomeneve meteorologjike, si pasojë e ndryshimeve klimaterike dhe të rritjes së temperaturave mesatare
- Rreziku i përmbytjeve periodike nga shkarkimi i rezervave të tepërta të hidrocentraleve
- Humbja e jetëve njerëzore, dëme ndaj njerëzve dhe materialeve, shkatërrimi i ekonomive, infrastrukturave dhe pasuri e patundshme si pasojë e fenomeneve të sipërpërmendur
- Modifikimi dhe humbja e cilësisë së peizazheve lumore dhe liqenore

#### **2.1.1.5 Analiza SWOT – Sistemi Bujqësor**

### **Pikat e forta**

- Prezenca e aktiviteteve të konsiderueshme bujqësore në territorin e Bashkisë
- Prezenca në Vau Dejës e Shkollës Profesionale Kombëtare “Ndre Mjeda”, ku ofrohen profilet: veterinari, teknologji agrourbushqimore, bujqësi dhe ekonomi bujqësore.
- Rezervat e mëdha ujore si dhe sistem bonifikues përgjithësisht i mirë zbatuar, me kanale kullues dhe ujitës dhe sipërfaqe të konsiderueshme të drenazuara me tuba qeramike;
- Fermerët trashëgojnë eksperiencë shumë pozitive në fushat e bujqësisë dhe blegtorisë;

- Terreni fushor dhe i sistemuar mirë përben një aset shumë të vlefshëm në mekanizimin e proceseve të punës , faktor baze për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë;
- Numri i madh i krerëve në gjedh dhe të imta si dhe sipërfaqet e mëdha të kultivuara me kultura bujqësore që rrisin pjellorinë e tokës (si jonxha dhe tërfili);
- Klima e favorshme dhe struktura e tokës, favorizojnë rritjen e kulturave të ndryshme bujqësore.

#### **Pikat e dobëta**

- Fragmentimi i lartë i pronave bujqësore, përmasa të vogla të prodhimit dhe të punësimit të ndërmarrjeve bujqësore lokale
- Gjendje problematike në lidhje me pronësinë e tokës
- Mungese organizimi e sektorit të prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve bujqësore
- Mungesa e kujdesit në mirëmbajtjen dhe investimet në rrjetin e kanaleve ujitës dhe kullues, pritave malore, veprave të artit, erozionit etj.
- Mungesa e qendrave të magazinimit të ushqimeve, ruajtjen dhe shpërndarjen e produkteve ushqimore në tregjet lokale dhe kombëtare
- Niveli përgjithësisht i ulët i teknologjisë dhe njohurive të sektorit si dhe nivel i ulët i arsimit dhe njohurive të fermerëve
- Mungesa e strukturave dhe eksperteve në stafin e Bashkisë (dhe Njësive Administrative) që mbulojnë zhvillimin e sektorit të bujqësisë
- Mungese e dokumentacionit për studimet agro-pedologjike dhe të bonitetit të kryera ndër vite dhe nevoja e përditësimit të tyre;
- Mungesa e subvencioneve shtetërore (procedura të tejzgjata dhe bllokuese) dhe mungesa e përvojës në evidentimin e produktit.
- Mungesa e kontroleve për cilësinë e inputeve bujqësore dhe çmimet e larta të këtyre inputeve
- Mungesa e kushteve për standardizimin dhe marketingun e prodhimit
- Interesat e larta në dhënien e kredive nga ana e institucioneve bankare

#### **Mundësitë**

- Mundësia e eksportit të produkteve bujqësore organike (bio) në tregjet lokale, në zonën rajonin Shkodër-Lezhë (ne bashkitë kufitare) dhe në perspektivë, në tregjet e Ballkanit dhe vendeve të Adriatikut
- Mundësia e rritjes së prodhimit në sera

- Mundësia e rinovimit dhe zhvillimit të llojeve të reja dhe të vjetra të bimëve cilësore, në lidhje me bujqësinë organike, në territoret kodrinore dhe të rrëzës së malit (sidomos në kultivimin e ullirit, vreshtave dhe pemëtarisë)
- Zhvillimi dhe rimëkëmbja e pylltarisë e bujqësisë në zonat rrëzë malit, në lugina e në zonat malore të brendshme, si dhe në fushën e bimëve aromatike dhe mjekësore
- Rimëkëmbja dhe zhvillimi i aktiviteteve blegtorale
- Kultivimi i peshkut në zonat liqenore
- Iniciativa për të stimuluar krijimin e fermave të përbashkëta duke organizuar fermerët e vegjël dhe të mesëm në forma të shoqatave kooperative;
- Trajnimi dhe mbështetja për formimin e kopshteve urbane të shpërndara në zonat me marginalizim të madh dhe varfërisë urbane;
- Zhvillimi i një sistemi të ofertave të hotelerisë cilësore, lidhur me vlerësimin e produkteve dhe traditave ushqimore lokale.
- Organizimi i Sektorit Teknik për Bujqësinë pjese e strukturës së Bashkisë.

### **Rreziqet**

- Rritja progresive e përdorimit të tokës bujqësore për banim, që sjell fragmentimin dhe dëmtimin e tokave bujqësore.
- Problemet e lidhura me sistemin e pronësisë. Në shume raste Z.V.R.P.P. Shkodër behet pengese për dhënie e dokumentacionit të pronësisë në kohë.
- Humbja e tokës bujqësore për shkak të përmytjeve të mundshme të përsëritura të lumenjve (pasojat ekonomike të rrezikut të pakontrolluar hidro-gjeologjik)
- Humbja e tokës dhe kulturës së specializuar bujqësore për shkak të braktisjes dhe degradimit mjedisor që rrjedh prej tij;
- Humbja e cilësisë dhe vlerës së peizazhit për shkaqet e braktisjes së kulturave të specifike (ullinj, vreshtat, pemëtoret).

#### **2.1.1.6 Analiza SWOT – Sistemi Urban**

### **Pikat e forta**

- Prania e zonave urbane me mundësi dendësimi të ndërtesave dhe të rritjes së faktorëve urbanë (urbanizim dhe shërbime)
- Prania e ndërtimeve të reja ose e ndërtesave me moshë mesatare, pa probleme serioze strukturore
- Zona urbane të karakterizuara nga funksione mikse, pa probleme të dukshme ndarjeje
- Kosto të ulëta ndërtimi
- Prania e veprave energjetike me rëndësi kombëtare



- Prania e zonave me interes historik dhe kulturor (Vigu, Sapa, Danja, Sarda, Komani)

### **Pikat e dobëta**

- Mungesa e hapësirave të gjelbra në zonat rezidenciale
- Mungesa e hapësirave të dedikuara lojërave të fëmijëve dhe kohës së lirë të të moshuarve
- Mungesa e ndërtesave publike me funksion specifik të lidhur me kulturën, artin dhe turizmin
- Degradimi i zonave urbane, urbanizim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar
- Prania e ndërtimeve informale dhe e ndërtesave edhe në zona bujqësore në mungesë totale të veprave të urbanizimit primare dhe sekondare
- Prania e problematikave të ndryshme të lidhura me strehimin, në veçanti lidhur me kërkesën e ndërtimit social
- Rritje urbane spontane përreth kornizës infrastrukturore dhe rurale. Zhvillimi është i tipit spontan, jo i planifikuar dhe është i karakterizuar së pari nga intensifikimi i të ndërtuarit në zonat qendrore dhe pranë rrugëve kryesore të qarkullimit
- Mungesa e hapësirave publike dhe cilësi e dobët e atyre ekzistuese.
- Mungesë e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave urbane
- Prania e ndërtimeve të reja ose me moshë mesatare, që nuk respektojnë normat ndërkombëtare të sigurtisë sizmike dhe të kursimit të energjisë
- Prania e një pjese të konsiderueshme të ndërtesave publike tashmë të ndërtuara, me cilësi të ulët të ndërtimit, me paqartësi pronësie, që nuk respektojnë standardet normale të ndërtimit dhe natyrisht standardet ndërkombëtare të mbrojtjes sizmike dhe të kursimit të energjisë, me aspak ose shumë pak vlerë ekonomike
- Mungesë e kujdesit për zonat me vlerë historike dhe me impakt të rëndësishëm në terma të peizazheve vizuale

### **Mundësitë**

- Rehabilitimi administrativ dhe urbanistik i ndërtesave informale në proces legalizimi
- Mundësi e zhvillimit të industrisë së lehtë dhe asaj bujqësore me anë të prodhimit cilësor
- Përmirësimi i sistemit të mobilitetit, nëpërmjet realizimit dhe riorganizimit të rrjetit automobilistik dhe integritit dhe rritjes së transportit ujor, hekurudhor, rrugëve pedonale dhe pistave çiklistike
- Zhvillimi i sektorit turistik në lidhje me natyrën, kulturën, sportin, itineraret eno-gastronomike (turizmi me bazë ushqimet lokale), lidhur me ofertat e reja pritëse (hotele, bed&breakfast, agro-turizmi, hostelet rinore, kampingjet) dhe me shërbimet

plotësuese të turizmit (zona sportive, golfi, qendrat e hipizmit, shtigjet e kalërimit, qendrat sportive të integruara, parqet për aventura, etj.)

- Mundësia e ndërtimit të ndërtesave publike (shërbime publike) në terrenet në pronësi të bashkisë, ose në formën e kompensimeve të të drejtës së pronësisë mbi prona private, sipas programeve të barazisë urbanistike
- Mundësia e realizimit të veprave të urbanizimit në formën e një konsorciumi për zbritjen e kostove të urbanizimit ose nëpërmjet operacioneve Project Financing (projekte të vetëfinancuara)

### **Rreziqet**

- Degradimi i përgjithshëm i gjendjes së banesave dhe i mjedisit urban
- Humbja e karakterit dhe e identitetit të qendrave historike
- Ndotje progresive dhe rritje e rrezikut mjedisor (në veçanti landfilli i Bushatit)
- Humbje progresive e jetës sociale në qendrat e vogla rezidenciale
- Braktisje dhe degradim progresiv, zvogëlim i dendësisë së popullsisë në zonat malore verilindore, si pasojë e pamundësisë së shtrirjes së shërbimeve
- Prirja për vazhdimësinë e fenomeneve të ndërtimit të paligjshëm, për shkak të mungesës së kontrollit dhe rregullave sanksionuese

#### **2.1.1.7 Analiza SWOT – Sistemi Infrastrukturor**

### **Pikat e forta**

- Pozicioni dhe afërsia me korridoret e mëdha kombëtare të trafikut dhe me nyjet kryesore të transportit (prania e rrugës ndërrbane (SH1) Tiranë-Hani i Hotit si pjesë e korridorit strategjik gjatësor, rrugës ndërrbane (SH5) Shkodër-Kukës e cila realizon lidhjen e pjesë Veri-Perëndimore me atë Veri-Lindore të Shqipërisë, si një nga akset e rëndësishme tërthore mbështetëse, linjës hekurudhore Durrës – Hani i Hotit dhe afërsia me Portin e Shëngjinit).
- Prania e disa tipeve të transportit, transporti rrugor, hekurudhor (11.82km hekurudhë të linjës Durrës – Hani i Hotit) dhe ai ujor i brendshëm (lundrimi përgjatë liqeneve artificiale në lumin e Drinit).
- Mbulim i plotë nga rrjeti elektrik i zonës kryesore urbane
- Prania e veprave energjetike me rëndësi kombëtare (HEC Ashta 1, Ashta 2, Vau i Dejës, Koman)

### **Pikat e dobëta**

- Infrastruktura rrugore lokale në gjendje jo të mirë deri në të keqe
- Pamjaftueshmëri në furnizimin me ujë dhe largimin/trajtimin e ujërave të zeza
- Mungesa e një sistemi racional të largimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane
- Mungesa e një rrjeti të transportit publik mes qendrave urbane
- Rrjet hekurudhor i amortizuar
- Mosrespektim i distancave të ndërtimeve të reja nga kufiri i rrugëve, veçanërisht përgjatë akseve kombëtare
- Rrezikshmëri e lartë dhe nivel i lartë aksidentesh në kryqëzimet dhe nyjet lidhëse (kryqëzimet në nivel) të rrjetit rrugor kryesor dhe dytësor

### **Mundësitë**

- Rivitalizimi i rrjetit hekurudhor në kuadër të lidhjes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (lidhje me Malin e Zi) dhe si bazë e riorganizimit të marrëdhënieve në shkallë rajonale dhe lokale
- Përmirësimi i infrastrukturës të mobilitetit duke transformuar Vau-Dejës në pikën kryesore të tërheqjes së flukseve të turizmit natyror, kulturor dhe mjedisor të rajonit Shkodër – Lezhë
- Zhvillimi i rrjetit të transportit ujor si infrastrukturë shërbimi urban dhe si rrjet i promovimit turistik.
- Zhvillimi i një rrjeti të lëvizshmërisë të ngadaltë, të integruar me realizimin e rrjetit ekologjik rajonal dhe kombëtar
- Mundësia e lidhjes së Vau-Dejës me bregdetin e Velipojës dhe atë të Shëngjinit.
- Zhvillimi i turneve tematike në mbështetje të turizmit kulturor dhe mjedisor dhe të lidhur me vlerësimin e resurseve bujqësore dhe ushqimore lokale
- Afërsia me aeroportin e Gjadrit si infrastrukturë me potencial turistik zhvillimi në të ardhmen

### **Rreziqet**

- Zhvillim urban përgjatë akseve infrastrukturore dhe lidhjeve të tyre, që sjell rreziqe reciproke për eficientësinë e brendshme, si të sektorit të sistemeve urbane, ashtu edhe të mobilitetit
- Degradim progresiv i rrjeteve ekzistuese për shkak të mungesës së resurseve të përshtatshme dhe nga nevoja në rritje për investime
- Mungesa e fondeve për mirëmbajtjen e duhur të rrjeteve dhe infrastrukturave
- Rreziqe të lidhura me realizimin e infrastrukturave të reja, pa ndërhyrjet e duhura të masave zbutëse (ndotja e burimeve natyrore, rritja e pakontrolluar urbane, impakt mbi peizazhin dhe mbi zonat natyrore)
- Rreziku potencial i ndotjes nga landfilli i Bushatit.

- Rreziqe të lidhura me përmytjet si pasojë e pamundësisë së kontrollit mbi prurjet në infrastrukturën e energjisë hidroelektrike si dhe për shkak të mungesës apo amortizimit të infrastrukturës mbrojtëse.

## 2.1.2 Analiza metabolike

### 2.1.2.1 Hyrje

Sipas përcaktimeve të VKM 671 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", analiza metabolike është pjesë e hartimit të strategjisë territoriale të PPV-së dhe një model për analizën dhe identifikimin e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Në një vështrim të përgjithshëm, qyteti shihet si një organizëm i gjallë që ka nevojë për energji dhe burime për të funksionuar dhe që nga funksionimi i tij prodhohen mbetjet. Modeli krijon mundësinë e studimit të ndërveprimit midis sistemeve natyrore dhe njerëzore në një rajon. Kjo analizë studion flukset në territorin urban. Analiza zhvillohet përmes identifikimit të hyrjeve dhe daljeve kryesore në sistemin urban. Metabolizmi mund të përcaktohet si tërësia funksionale e proceseve sociale, ekonomike dhe teknike që ndodhin në qytete, si pasojë e rritjes së tyre, prodhimit të energjisë si dhe asgjësimit të mbetjeve. Analiza i shërben VSM-së duke ndihmuar identifikimin e ndotjes së ujërave dhe ajrit, shpërdorimin e burimeve, humbjen dhe degradimin e tokës, energjinë e nevojshme që harxhohet, si dhe lidhjen që kanë qytetet me periferinë. Ky është në thelb një bilanc i ndikimit të qytetit në mjedis që përcakton masa përmirësuese apo neutralizuese të ndikimit negativ. Praktikisht, metabolizmi i një sistemi urban është një përmbledhje e numrit të hyrjeve dhe daljeve (input-output) dhe mënyrës së përdorimit të ujit, energjisë, ushqimit, mbetjeve etj. në të.

Hyrjet në sistemin urban (toka, uji, ajri, energjia, burimet e tjera) ndryshojnë pasi kalojnë në të, duke u transformuar në dalje (mbetje dhe shkarkime në ajër, ujë dhe tokë). Nëpërmjet analizës kryhet bilanci i burimeve natyrore të shfrytëzuara (hyrjet), mënyrës së përdorimit të tyre dhe ndotjeve e humbjeve që shkaktohen në sistemin urban (daljet). Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që mundësojnë funksionimin e territorit si një i tërë. Strategjia e mbështetur në analizën metabolike, mbështetet mbi parimet e qëndrueshmërisë dhe ka për qëllim përmirësimin e sistemit urban.

Metabolizmi konsiderohet si një proces dinamik fluksesh në një vend të dhënë, në një moment të dhënë, në një stad të dhënë të zhvillimit urban, dinamikë e cila shpjegohet me konceptin e vazhdimësisë ekologjike. Me "vazhdimësi ekologjike" kuptohen proceset e ndryshimeve në strukturën e specieve të një bashkësie ekologjike përgjatë kohës; ky proces varet nga kushtet klimatike, tokës dhe ndërhyrjet njerëzore.

Fluksi i energjisë dhe ujit do të kenë një analizë paraprake në shkallë rajoni e më pas në shkallë bashkie meqenëse këto burime menaxhohen në rang kombëtar dhe nuk gjenerohen tërësisht

në territorin e bashkisë. Sidomos burimet ujore, kalojnë në disa sisteme urbane (lumenjtë) duke mbartur me vete edhe ndotjen që shkaktohet nga këto sisteme.

Për matjen e flukseve është përzgjedhur metoda LCA (Life Cycle Assessment) e cila mundëson vlerësimin e ciklit të jetës së burimeve. Gjithashtu, LCA vlerëson ndikimet e mundshme mjedisore, që nga shkaku (fillimi) deri në eliminimin total të tyre.

### 2.1.2.2 Energjia dhe uji në rajon

Bashkia Vau-Dejës shtrihet në Rajonit Verior të vendit dhe në aspektin gjeografik dhe zhvillimor lidhet dhe kufizohet me bashkitë Shkodër, Tropojë, Fushë- Arrëz, Pukë, Lezhë, Krujë, Tiranë. Në bilancin e energjisë dhe burimeve për bashkinë Vau-Dejës na duhet të konsiderojmë një rajon më të gjerë që mundëson një vlerësim të plotë e të qartë të flukseve dhe ndërveprimit në shkallë territoriale. Në këtë kuadër, rajoni në analizën metabolike nënkupton bashkinë Vau-Dejës si dhe njësitë e tjera administrative dhe territoriale që bashkëveprojnë në mënyrë të ndërsjellë me këtë territor.




Fig. 14 Harta e flukseve në territorin e Bashkisë Vau-Dejës Tabela

## Energjia

Shqipëria ka një potencial të madh hidroenergjetik, prej të cilit është shfrytëzuar vetëm 35.4 % e tij. Në shkallë vendi, kapaciteti i fuqisë së instaluar është 1,466 MW dhe prodhimi mesatar i energjisë arrin në 5.283 GWh. Rezervat totale hidroenergjetike lejojnë instalimin e një rrjeti energjetik prej 4,500 MW dhe prodhimi vjetor i energjisë mund të arrijë deri në 16 TWh. Në mbarë vendin janë 107 kontrata koncesionare në proces me një kapacitet total prej 1,386 MW që do të mundësojnë rritjen e burimeve energjetike të rajonit. Energjia hidrike në rajon shfrytëzohet përmes HEC-eve kryesisht në lumin Drin dhe Mat.

### Hidrocentralet e mëdha

Numri i hidrocentraleve në funksionim është 7 hidrocentrale të mëdha dhe 38 të vogla.

Mbi lumin Drin ndodhen tre hidrocentrale në funksionim me një fuqi të instaluar në total prej 1,350 MW: në Vaun e Dejës, në Komani dhe Fierzë. Një kontratë koncesionare është nënshkruar për ndërtimin e një hidrocentrali tjetër në Ashtë, mbi lumin Drin, midis Qeverisë Shqiptare dhe kompanisë austriake "Österreichische Elektrizitätswirtschafts - Aktiengesellschaft", me një kapacitet të instaluar 48.2 MW.

*Tabela 4 Fuqia dhe kapaciteti i hidrocentraleve në vend*

Nr.	Hidrocentrali	Fuqia e instaluar (kW)	Kapaciteti prodhues vjetor (kWh)
1.	Ulëza (Mat)	25.000	120.000.000
2.	Shkopeti (Mat)	24.000	90.000.000
3.	Bistrica i (Sarandë)	22.500	100.000.000
4.	Vau i Dejës (Shkodër)	250.000	1.000.000.000
5.	Fierza (Tropojë)	500.000	1.800.000.000
6.	Komani (Shkodër)	600.000	2.000.000.000

### Hidrocentralet e vogla

Në shkallë vendi numërohen 70 hidrocentrale të vogla me kapacitete që renditen midis 20 dhe 9,200 kW. Vetëm 38 prej tyre janë funksionalë, ndërsa të tjerët janë jo operacionalë. Midis tyre, 32 hidrocentrale funksionojnë në bazë të kontratave koncesionare (kapacitet i instaluar 24.4 MW), 16 janë privatizuar dhe operojnë me një kapacitet të instaluar 2,047 MW dhe 22 janë pronë shtetërore me një kapacitet të instaluar 11 MW.

Qëllimi i ndërtimit të këtyre hidrocentraleve të vogla është furnizimi me energji i zonave të thella malore. Ato janë të tipit me derivacion dhe përdorin ujin e rrjedhave ujore në afërsi të tyre.

### Burimet alternative




Fig. 15 Ndarja në zona sipas shpejtësisë së erës dhe orëve vjetore

Burimet energjetike alternative janë shumë pak të shfrytëzuara. Energjia diellore apo ajo e erës nuk kanë gjetur ende përdorim të gjerë.

Energjia diellore në rajon është lehtësisht e shfrytëzueshme. Numri i orëve me diell në bashki arrin deri në (2300-2500 orë/vit) dhe mundëson rendiment mjaft të lartë në përdorimin e këtij burimi.

Shfrytëzimi i burimeve alternative të energjisë do të mund të nxisë modelet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të garantojë ruajtjen e mjedisit dhe ekosistemit.






Fig. 16 Energjia diellore në Shqipëri

## Uji

Rajoni është i pasur me ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Territori i rajonit përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Drini dhe Gjadri. Shfrytëzimi i lumenjve për prodhimin e energjisë është potenciali kryesor me impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e rajonit. Në zonën veriore të rajonit ndodhen edhe HEC-et kryesore të cilat furnizojnë me energji një pjesë të konsiderueshme të territorit të Shqipërisë (Ulëza, Shkopeti, Fierza, Komani, Vau-Dejës, si dhe Ashta 1 e 2).

Hidrografia e rajonit përbëhet prej ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore që gjenden në akuiferët kryesorë të zonës në studim. Rrjeti hidrografik i rajonit përbëhet prej disa lumenjve, ku ndër më kryesorët është Lumi Drin.

Drini është lumi më i gjatë i trojeve shqiptare me 160 kilometra gjatësi. Degët kryesore të Drinit janë lumi i Shalës, lumi Valbona që buron nga Alpet Shqiptare, Drini i Bardhë në Kosovë dhe Drini i Zi në Maqedoni. Në pjesën fundore Drini derdhet në lumin Kir, i cili buron nga Dukagjini, e pastaj bashkë derdhen në Bunë. Drini i madh është shumë i gjerë dhe sjell një sasi të madhe uji (330 – 340 m<sup>3</sup>/s), i dyti për nga kapaciteti pas Bunës, por ky i fundit, duke qenë i shkurtër, në mjaftë harta shënohet edhe si liqen. Pas Vaut të Dejës, krahu i gjatë shkon drejt jugut për nga Bushati, Maba, Gjadri, Lezha. Në jug të Lezhës hyn në një zonë moçalore e më tej derdhet në Adriatik.



Drini rrjedh në pjesën verior dhe është kthyer në një zinxhir liqenesh artificiale (i Fierzës, i Komanit dhe i Vaut të Dejës) që furnizojnë me ujë tre hidrocentralet e mëdha. Prurja mesatare vjetore e Drinit arrin  $352 \text{ m}^3/\text{sek}$ , kurse maksimalja e regjistruar është mbi  $5.100 \text{ m}^3/\text{sek}$ . Duke kaluar në fshatrat Sipas, Msi dhe Fierzë, e mandej, pasi mbërrin në krahinën e Dukagjinit, ai shkon drejt jugut, kalon nga Apripë e Gurit, Toplanë, Dushman, Koman, Vjerdhë, Mazrrek, Rragam, dhe Pale Lalej. Në Vaun e Dejës, hyn në ultësiat e Nënshkodrës dhe ndahet në dy krahë: një që derdhet në gjirin e Drinit në Adriatik në jug-perëndim të Lezhës, dhe tjetri që derdhet në lumin Kir e më tej në Bunë afër Kalasë së Shkodrës. Edhe pse është dega më e shkurtër prej 15 km, kjo ndarje që derdhet në Bunë quhet Drini i Madh, sepse bie më shumë ujë se krahu tjetër që derdhet drejtpërdrejt në det. Drini i Madh gjithashtu derdhet në det, por ka ndryshuar rrjedhën e vet pas një përmbytjeje të madhe në vitin 1858 duke ardhur drejt Shkodrës.

Lumi i Gjadrit është degë e majtë e Drinit, që shtrihet në perëndim të rrethit të Pukës e në verilindje të rrethit të Lezhës. Ka gjatësi 40.5 km, sipërfaqe  $199 \text{ km}^2$  dhe lartësi mesatare 422 m. Fillon nga shpatet veriperëndimore të Bjeshkëve të Tërbunit. Në pjesën e sipërme të rrjedhjes, ka formuar një luginë tipike me shpate shumë të pjerrëta e fund të ngushtë. Që nga Kalivaçi e deri në Hajmel, lugina merr pamjen e një pellgu. Gjadri, pasi mbledh ujërat e pjesës veriperëndimore të përroit të Dibrës dhe atij të Kakrit, kthen në veriperëndim dhe derdhet në Drin.

Akuiferi i Nënshkodrës ka një përhapje mjaft të gjerë në luginat dhe fushat e formuara nga lumenjtë Drini e Buna. Në jug ky akuifer kufizohet me fushën e Zadrimës, ndërsa në veri me akuiferin e Mbishkodrës. Ai shtrihet në gjithë pjesën e ulët fushore dhe është formuar me aktivitetin akumulativ të materialit të shkrifët aluvional të depozitimeve kuaternare të lumenjve Buna e Drin. Akuiferi përbëhet nga shtresa të fuqishme zhavorresh e zhuresh me veti të larta filtruese, të cilat grumbullojnë sasi të konsiderueshme rezervash të ujërave nëntokësore të freskëta. Zhavorret e zhuret ujëmbajtëse dominojnë në prerje dhe zënë 60-80 % të saj. Trashësitë e shtresave luhaten nga 5-10 deri 60 m e në zona të veçanta edhe më tepër. Mbulesa subrërore lëviz nga 2-3 m deri 25-30 m. Në zonën e Mjedës, Kaç-Naraçit e Stajkës, zhavorret dalin në sipërfaqe të tokës. Mbulesa subrërore subargjilore rritet nga veriu në jug dhe nga lindja drejt perëndimit, si dhe në drejtim të rrjedhjeve të lumenjve Buna e Drin. Ujërat nëntokësore të zhavorreve të këtyre luginave aluviale kanë lidhje të mira hidraulike, me ujërat sipërfaqësore të lumenjve Buna e Drin, prandaj janë të pasura dhe përmbajnë rezerva të konsiderueshme, gjë e cila është vërtetuar nga shpimet e kryera. Në pjesën lindore e veriore të këtij pellgu, ujërat nëntokësore janë pa presion, ndërsa në sektorët jugorë e perëndimorë, si rezultat i rritjes së mbulesës subrërore e subargjilore dhe si rezultat i pozicionit hipsometrik më të lartë të zonës së ushqimit, ato fitojnë presion dhe në disa zona shpimet kanë dhënë ujë me vetërrjedhje si në Trush të Poshtëm, Pistull, Paçram, Gocaj etj. Megjithatë nivelet e ujërave nëntokësore, në pjesën më të madhe të akuiferit janë nën sipërfaqen e tokës, por jo në thellësi të madhe si në zonën e Mbishkodrës.

Nivelet luhaten nga 1.0 m deri 3-3.5 m, rrallë shkojnë deri 5.0 m nën sipërfaqen e tokës. Luhartet e niveleve lidhen drejtpërsëdrejti me regjimin hidrogjeologjik të lumenjve Buna e Drini, çka vërteton edhe marrëdhëniet e mira hidraulike të tyre në ujërat nëntokësore. Ujëdhënia dhe ujëpërshkueshmëria e zhavorreve është shumë e lartë në përgjithësi, megjithatë ka edhe zona të kufizuara me vlera mesatare e të vogla. Koeficientët e filtrimit luhaten nga 30-50 m/ditë dhe prurjet specifike nga 5-10 lit/sek/m, në zonat e ekstremeve perëndimore, jugperëndimore e jugore të pellgut deri në 400- 700 m/ditë dhe 100-150 lit/sek/m respektivisht në pjesën më të madhe të tij e sidomos në sektorët më afër lumenjve Buna e Drini. Në shpimet e kryera në afërsi të Bahçallëkut në Dajç të Bregut të Bunës, Shirqe, në Trush të Poshtëm, Bërdicë, Melgush, Kosmaç, Stajkë, Mjedë, Qendër Bushat, etj. koeficientët e filtrimit luhaten nga 100-150 m/ditë deri 400 - 750 m/ditë, ndërsa prurjet specifike nga 40-60 lit/sek/m, deri 100-150 lit/sek/m, e në puse të veçantë edhe më tepër. Ushqimin kryesor ujërat nëntokësore e marrin nga lumenjtë Buna e Drin dhe pjesërisht nga reshjet atmosferike, në seksionet ku zhavorret dalin në sipërfaqe të tokës. Përsa i përket përbërjes fiziko kimike të ujërave të zonës Mbishkodrës, mund të themi se kemi të bëjmë me ujëra me veti fiziko-kimike të mira. Mineralizimi i përgjithshëm lëkundet nga 0.17 gr/l në 0.5 gr/l. Mbetjet e thata më të vogla takohen si në pjesën lindore të zonës, ashtu edhe atë perëndimore në afërsi të liqenit, ndërsa më të mëdhatë në pjesën qendrore në fshatin Omaraj. Fortësitë më të vogla takohen në afërsi të lumit Kiri dhe liqenit të Shkodrës, ndërsa më të mëdhatë në pjesën veri dhe veriperëndimore të zonës. Ujërat nëntokësore të këtij pellgu janë në përgjithësi të freskëta dhe veti të mira fiziko-kimike, temperaturë nga 12 -16°C, mineralizim të përgjithshëm nga 0.2 deri 0.5 gr/l. Në disa sektorë mineralizimi arrin deri 0.7 gr/lit vetëm në një zonë të Barbullushit kemi Mp mbi 1gr/l. Fortësia e përgjithshme lëviz nga 7 deri 20 gradë gjermane. Me mineralizim dhe fortësi më të vogël janë ujërat në pjesën lindore të pellgut dhe afër lumenjve Buna e Drin. Nga punimet e kryera deri tani, del qartë se zonat më me perspektivë dhe më të pasura me ujëra nëntokësore, janë ato të krahut të majtë të rrjedhjes së lumit Buna, duke filluar prej urës së Bahçallëkut dhe deri në Dajç të Bregut të Bunës, me një front prej 8-10 km dhe në të dy krahët e lumit Drin prej Shkodrës e deri në Mjedë, me front 18- 20 km ( për të dy krahët së bashku).

### 2.1.2.3 Analiza e bashkisë Vau-Dejës

Analiza e metabolizmit të territorit të Bashkisë Vau-Dejës merr në konsideratë disa faktorë kryesorë që ndikojnë në flukset e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve. Bashkia e Vau-Dejës ka një sipërfaqe prej 496 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 49 399 banorë. Flukset e analizuar në kuadër të analizës së metabolizmit janë energjia, uji, ushqimi dhe mbetjet. Analiza për secilën rrymë ndjek të njëjtën metodologji në parim, por për shkak të mungesës së informacioneve të caktuara, analiza pëson modifikime nga fluksi në fluks. Për të analizuar flukset janë vëzhguar hyrjet dhe daljet për secilin prej tyre, për të kuptuar problemet mjedisore dhe humbjet.

#### 2.1.2.4 Fluksi i energjisë

Fluksi i energjisë tregon raportet midis sasisë së energjisë së prodhuar dhe asaj të konsumuar në territorin e bashkisë Vau-Dejës. Këtu trajtohen edhe burimet potenciale që mund të shfrytëzohen duke balancuar burimet e mbishfrytëzuara.

Energjia hidrike e lumenjve brenda territorit të bashkisë Vau-Dejës shfrytëzohet në nivele të larta pasi edhe lumenjtë që kalojnë në këtë territor janë me prurje të konsiderueshme. Në territorin e bashkisë, mbi lumin Drin janë ndërtuar disa hidrocentrale: hidrocentrali i Vau-Dejës, i Komanit, si dhe Ashta 1 e 2. Hidrocentrale këto me një kapacitet që shkon deri në 600 MW në hidrocentralin e Komanit. Një sërë hidrocentralesh janë parashikuar të ndërtohen edhe mbi lumin Gjadër.

Një burim alternativ energjie që ka potencial për t'u përdorur në territorin e Vau-Dejës, është energjia diellore. Vau-Dejës ndodhet ndërmjet izolinjave 1300 – 1450 kWh/m<sup>2</sup> në vit. Shpërndarja e mesatares ditore për rrezatimin ditor në territorin e bashkisë Vau-Dejës varion nga 3.56-3.97 kWh/m<sup>2</sup>. Energjia diellore shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1 % dhe shfrytëzohet për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individuale me kolektorë diellorë. Energji tjetër potenciale në Vau-Dejë mund të jetë energjia e erës. Shpejtësia maksimale e erës në territorin e Bashkisë Vau-Dejës arrin nga 3 m/s deri në 3.5 m/s.

Energjia elektrike është një nga burimet primare të energjisë në Shqipëri. Për të llogaritur konsumin e energjisë për familje/vit jemi mbështetur mbi të dhënat INSTAT, Censusi 2011 (Grid). Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km<sup>2</sup> në të gjithë territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe duke marrë parasysh që konsumi total i energjisë në Shqipëri për vitin 2011, është 2,587,907 MWh, mund të llogarisim sa energji elektrike konsumon mesatarisht një familje në vit.

Për vitin 2011 sipas INSTAT numri mesatar i personave në një familje është përafërsisht 4 anëtarë. Numri total i Njësive Ekonomike Familjare është: 722,262 familje (CENSUS 2011). Konsumi mesatar i energjisë elektrike për familje në vit është: Konsumi i energjisë elektrike nga familjet (2,587,907)/nr. e familjeve (722,262) = Energjia elektrike që konsumon një familje për një vit (3.6 MWh). Për të gjeneruar energjinë e konsumuar për çdo km<sup>2</sup>, shumëzojmë numrin e familjeve në atë sipërfaqe me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë.

Bashkia Vau-Dejës:

$$(49,399 \text{ banor}/4)\text{familje} \times 3.6 \text{ MWh} = 44459.1 \text{ MWh në vit}$$

Tabela 5 Popullsia banuese në Shqipëri (INSTAT, 2011)

<b>Popullsia banuese gjithsej</b>	2,821,977
<b>Numri gjithsej i njësive ekonomike familjare</b>	722,262

Në hartën e mëposhtme paraqitet në mënyrë grafike konsumi i energjisë.




Fig. 17 Potenciali dhe konsumi i energjisë


Tabela 6 Njësitë ekonomike familjare në Shqipëri sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje në zonat urbane dhe rurale (INSTAT, 2011)

Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje	Zona urbane dhe rurale		
	Gjithsej	Urbane	Rurale
Gjithsej	722,262	409,309	312,953
Dru	414,982	148,567	266,415
Energji elektrike	111,020	98,226	12,794
Gaz	150,321	127,945	22,376
Panele diellore	305	224	81
Lloj tjetër energjie (panele diellore, qymyr, naftë, etj.)	2,679	1,901	778
Pa ngrohje	42,955	32,446	10,509

Një sasi e konsiderueshme e energjisë së konsumuar shkon për ngrohje. Sipas të dhënave të INSTAT, burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje në Bashkinë Vau-Dejës, nga njësi ekonomike familjare (NjEF), vazhdon të jetë energjia e përftuar nga drutë e zjarrit. Bazuar në tabelën më sipër: 57.46 % të NjEF përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, ndjekur nga gazi (20.81 %) dhe më pas nga energjia elektrike (15.37 %). Mënyrat e tjera të ngrohjes janë në përqindje shumë të vogla.

*Tabela 7 Bilanci i energjisë elektrike, në rang vendi (INSTAT, 2011)*

Emërtimi	Energjia (MWh)
Energji në dispozicion (Burimi)	7,532,055
Prodhimi neto vendas	4,057,089
Termocentrale	0
Hidrocentrale	4,057,089
Importi bruto (energji në marrje)	3,474,966
Eksporti bruto (energji në dhënie)	300,544
Humbje në rrjet	2,179,157
Familjet	2,587,907
Të tjera	2,443,667



*Fig. 18 Hidrocentralet në territorin e Shqipërisë*

#### 2.1.2.5 Fluksi i ujit

Fluksi i ujit tregon për bilancin e prodhimit të ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor në territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe sasinë e konsumuar të tij. Uji përdoret për qëllime teknologjike, për pirje, shpërndarje nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit dhe përdoret për banorët, bizneset, industrinë, institucionet etj.

Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në territorin e Bashkisë Vau-Dejës, në këtë rast) mund të nxjerrim sasinë totale të ujërave në territor (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të ujërave. Sasia e ujërave nëntokësore llogaritet nga burimet që shfrytëzohen në territor. Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 24.22 km<sup>2</sup> në të gjithë territorin e Bashkisë Vau-Dejës. Pjesë të rëndësishme në territorin e bashkisë, nga pikëpamja e ujërave sipërfaqësore, zënë kanalet ujëtare.

Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse ndodhen kryesisht në akuiferin e Nënshkodrës, i cili furnizohet nga lumenjtë Buna dhe Drin. Sasia e ujit që mund të shfrytëzohet nga burimet ujore është nga 900 - 1000 l/sek. Këto ujëra nëntokësore përdoren për pirje, për t'u shpërndarë në sistemin e ujësjellësit, për qëllime teknologjike etj.

Bashkia Vaut-Dejës, pavarësisht burimeve të shumta ujore, ende nuk garanton mbulim tërësor të territorit me këtë shërbim publik. 19 rrjete sistemi të ujësjellësve operojnë gjithsej në bashki, ku vetëm 9 operojnë në Bushat, që përfaqëson edhe njësinë administrative që paraqitet më mirë me furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës. Nga 19 rrjetet e ujësjellësit, 13 prej tyre janë me rrjete me ngritje mekanike, pra që kanë edhe sistemet përkatëse të pompimit (respektivisht 15 sisteme pompimi). 5 rrjete ujësjellësi janë me rrjedhje të lirë, çka do të thotë se janë sisteme me kosto të reduktuara të funksionimit. Vetëm 4 prej tyre, funksionojnë në njësinë administrative Shllak. Një pjesë e konsiderueshme e familjeve në fshatra sigurojnë ujin e pijshëm nëpërmjet burimeve natyrore (krua) si dhe nëpërmjet përdorimit të puseve. Problematik mbetet furnizimi me ujë higjenikisht të pastër për 24 orë të familjeve në zonën urbane të Vaut të Dejës. Kjo zonë ka një numër të madh të familjeve, që aktualisht nuk u sigurohet ujë i pijshëm nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit. Nga të dhënat e marra nga UK sh.a. Vau-Dejës, aktualisht sistemi i furnizimit dhe shpërndarjes së ujit në njësinë administrative Vau-Dejës ka në përbërjen e vet katër rezervuarë. Vepra e marrjes ndodhet brenda territorit të qytetit. Prurjet që merren nga pus-shpimi janë përkatësisht 45 l/sek (minimale) dhe 75 l/sek (maksimale). Furnizimi i linjës së jashtme kryhet nëpërmjet stacionit të pompimit në Vaun e Dejës, prurja e të cilit, në varësi të sezonit, varion nga 50 - 70 l/sek. Sasia ditore e ujit të prodhuar arrin deri në 2.066 m<sup>3</sup>. Për njësinë administrative Bushat, rrjeti i furnizimit me ujë për qytetin nuk ka pasur asnjë rehabilitim apo ndërhyrje që nga ndërtimi i



tij. Furnizimi i linjës së jashtme kryhet nëpërmjet stacionit të pompimit, prurja e të cilit është rreth 30 m<sup>3</sup>/h. Sasia ditore e ujit të prodhuar arrin në 300 - 360 m<sup>3</sup>/ditë. Për njësitë e tjera administrative mund të themi se furnizimi me ujë realizohet kryesisht nëpërmjet puseve private. Aktualisht mund të themi se rreth 50% e territorit të bashkisë Vau-Dejës ka mbulim nga rrjeti i furnizimit dhe shpërndarjes së ujit.




Fig. 19 Fluksi i ujit




Fig. 20 Konsumi i ujit

Për të llogaritur konsumin e ujit të pijshëm në nivel bashkie jemi mbështetur në të dhënat e UK sh.a. Vau-Dejës dhe në të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid) për popullsinë dhe numrin e banorëve për çdo km<sup>2</sup> në të gjithë territorin e Bashkisë Vau-Dejës. Konsumi mesatar i ujit të pijshëm për konsumatorët familjarë (banorë) është 100 litra/banorë/ditë. Burimet ujore që gjenden në bashki janë mjaft më të larta sesa shkalla e shfrytëzimit të tyre.

#### 2.1.2.6 Fluksi i ushqimit

Fluksi i ushqimit, analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Për sa i përket fluksit të ushqimit në Bashkinë Vau-Dejës do të analizojmë të dhënat bujqësore dhe blegtorale, që prodhohen në territor, pasi zënë një peshë kryesore në fluksin e ushqimit. Importet realizohen në nivel kombëtar dhe nuk ka shifra të sakta për thithjen e tyre në nivel vendor. Të dhënat për përthithjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale janë në nivel qarku. Në këtë rast, për të llogaritur fluksin e ushqimit mund të fokusohemi më tepër në të dhënat mbi produktet bujqësore dhe blegtorale si dhe infrastrukturën ndihmëse, siç janë pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të këtyre produkteve, sasinë e produkteve që shkon në treg dhe sasinë e produkteve që shkon për eksport.



Sipas të dhënave nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) në territorin e Vau-Dejës prodhohet një sasi e lartë e produkteve bujqësore dhe blegtorale, të cilat kanë ndikim në rang kombëtar e jo vetëm për territorin e kësaj bashkie.

Sipërfaqja totale e tokave bujqësore në Bashkinë Vau-Dejës është 11753.33 ha. Sipërfaqja e ultësirës së Zadrimës shquhet si një nder zonat më të përshtatshme dhe pjellore në mbjelljen dhe kultivimin e kulturave bujqësore.

Për të llogaritur fluksin e ushqimit janë përdorur të dhënat e INSTAT (prodhimet) dhe të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit dhe Administrimit të ujërave (sasia që shkon në treg dhe eksport). Fluksi i ushqimit është realizuar vetëm për disa kultura, pasi të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të kuptohen hyrjet dhe daljet. Siç mund të kuptojmë nga fluksi, hyrjet (prodhimet) janë më të larta sa daljet (treg dhe eksport) sepse një pjesë e këtyre produkteve shkojnë për konsum vetjak, një sasi e caktuar është humbje dhe një pjesë tjetër shkon për shitje në mënyrë informale.

*Tabela 8 Fermat në Bashkinë Vau-Dejës (QTTB dhe MBZHRAU, 2014)*

Njësitë administrative	Ferma gjithsej	Ferma Bujqësore		Ferma Blegtorale	
		Nr.	Ha	Nr.	Nr. Krerë
Vau-Dejës	2803	1823	1132	980	426
Bushat	8746	4996	6502	3750	3414
Hajmel	2137	1187	1848	950	832
Vig-Mnelë	1210	771	183	430	60
Shllak	1064	659	101	405	25
Temal	1121	821	116	300	18
Total	17081	10257	9882	6815	4775
Burimi: Fermat Bujqësore dhe Blegtorale në Shqipëri - Q.T.T.B. Vau-Dejës (botim i vitit 2014)					

Tabela 9 Fermat bujqësore dhe blegtorale në Bashkinë Vau-Dejës

Ferma bujqësore																	
Nr.	Njesia administrative	Ferma Bujqësore gjithsej		Ferma me bimë arash		Ferma me bimë foragjere		Ferma me perime në sera		Ferma me drejtim frutikuturë		Ferma me drejtim vreshta		Ferma me drejtim ullishte		Ferma me bimë aromatike mjeksore	
		Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha
1	Vau Dejës	1823	1132	1650	960.8	980	426	8	0.8	21	14.5	28	32.4	85	89	0	0
2	Bushat	4996	6504	4400	5886	3950	3414	190	46	25	12.5	19	12.8	22	15	1	0.8
3	Hajmel	1187	1848	1010	1584	950	832	2	0.2	16	15.5	52	66.1	104	105	0	0
4	Vig-Mnelë	771	183	500	119	430	60	0	0	4	8.9	0	0	54	42	0	0
5	Shllak	659	101	470	69	405	25	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	T emal	821	116	515	71	414	18	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>10257</b>	<b>9884</b>	<b>8545</b>	<b>8689.8</b>	<b>7129</b>	<b>4775</b>	<b>200</b>	<b>47</b>	<b>66</b>	<b>51.4</b>	<b>99</b>	<b>111.3</b>	<b>265</b>	<b>251</b>	<b>1</b>	<b>0.8</b>

Ferma blegtorale																	
Nr.	Njesia administrative	Ferma me gjedh		Ferma me të leshta		Ferma me të Dhirta		Ferma me Shpend		Ferma me Derra Majmërie		Ferma me Derra riprodhimi		Ferma me Njethundrakë		Ferma me bletë	
		Nr.fermave	Nr.Kerëve	Nr.fermave	Nr.Kerëve	Nr.fermave	Nr.Kerëve	Nr.fermave	Nr.Kerëve	Nr.fermave	Nr.Kerëve	Nr.fermave	Nr.Kerëve	Nr.fermave	Nr.Kerëve	Nr.fermave	Nr.Kerëve
1	Vau Dejës	980	2340	176	2020	58	2500	3	4000	1446	1800	35	150	54	60	29	530
2	Bushat	3750	5500	250	3800	60	750	43	7000	1706	7500	205	450	450	500	165	200
3	Hajmel	950	2015	40	1500	54	1300	2	220	1254	6130	100	294	25	30	14	450
4	Vig-Mnelë	430	450	30	1300	45	2100	0	0	731	1285	13	27	22	25	11	500
5	Shllak	405	450	100	1000	226	1600	0	0	268	300	10	10	35	35	29	350
6	T emal	300	290	150	100	170	1100	0	0	439	600	10	20	28	30	190	500
	<b>Totali</b>	<b>6815</b>	<b>11045</b>	<b>746</b>	<b>9720</b>	<b>613</b>	<b>9350</b>	<b>48</b>	<b>11220</b>	<b>5844</b>	<b>17615</b>	<b>373</b>	<b>951</b>	<b>614</b>	<b>680</b>	<b>438</b>	<b>2530</b>

Tabela 10 Prodhimi bujqësor dhe blegtoral në Bashkinë Vau-Dejës

Njësitë administrative	Grurë	Misër	Perime gjithsej	Patate	Fasule	Foragjere gjithsej	Fruta	Ullinj	Rrush
Vau-Dejës	531	2310	2086	396	44	13630	425	95	260
Bushat	1634	10624	22012	425	219	121183	1130	94	569
Hajmel	1264	2471	1109	473	28	24276	311	36	500
Vig-Mnelë	42	184	103	310	18	1800	109	15	67
Shllak	-	138	133	160	-	700	67	-	25
Temal	-	35	260	205	-	450	89	-	53
Total (në ton)	3471	15762	25703	1969	309	162039	2131	240	1474

Shënim: Të dhënat u morën nga bashkia Vau-Dejës, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtës së Konsumatorit




Fig. 21 Prodhimet bujqësore




Fig. 22 Fluksi i ushqimit

### 2.1.2.7 Fluksi i mbetjeve

Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ofrohet për territorin e qytetit (Bashkia Vau-Dejës). Në territorin e Vau-Dejës shërbimi ofrohet në nivel 70-80%.

Ndërkomunalja e Zadrimës lehtëson ofrimin e shërbimit për një pjesë të madhe të territorit të bashkisë Vau-Dejës. Mbetjet organike, bimore apo shtazore, kompostohen pranë shtëpive me qëllim ripërdorimin e tyre për pleh për kulturat bujqësore, ndërsa mbetjet inerte depozitohen në venddepozitime të caktuara. Një organizim i tillë ka ulur ndjeshëm kostot e depozitimit dhe transportimit të mbetjeve. Megjithatë, ende ky shërbim nuk ofrohet në të gjithë territorin, si në Temal e Shllak. Sfidë mbetet që një organizim i tillë të ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë, të paktën në qendrat urbane të dy njësive më të largëta.

Aktualisht, në territorin e bashkisë, në Bushat, gjendet edhe landfilli i grumbullimit të mbetjeve urbane, që ka një periudhë shërbimi për 20 vjet. Tashmë që bashkitë kanë territor më të gjerë dhe popullsi më të madhe, mund të krijohen premisat e duhura që ky landfill të përdoret në kapacitetin e tij të plotë.

Landfill-i i Bushatit ndodhet rreth 13 km në jug të qytetit të Shkodrës, rreth 2.5 km në lindje të fshatit Bushat dhe rreth 1.5 km në lindje të fshatit Shkpezë. Landfill-i është i vendosur në një terren kodrinor që ngrihet në pjesën qendrore të fushës së Zadrimës. Kodrat kanë orientim veri-perëndim dhe jug-lindje. Në landfill depozitohen mbetjet urbane të të gjitha llojeve. Nuk lejohen të depozitohen mbetjet spitalore, bateri dhe akumulatorë, vajra industriale dhe mbetje të tjera të përcaktuara si të rrezikshme nga legjislacioni mjedisor. Duke qenë se procesi i eliminimit të mbetjeve të ngurta urbane, në disa raste mund të ndikojë shëndetin publik, rezulton e domosdoshme vendosja e një sistemi korrekt kontrolli dhe parandalimi me karakter higjeno-sanitar lidhur me operacionet që zhvillohen në landfill. Në territorin e bashkisë janë evidentuar edhe një seri pikash të jashtë ligjshme ku depozitohen mbetje nga banorët.

Në Shqipëri, në vitet 2012-2015 është venë re ky raport import/eksport mbetjesh, sipas INSTAT:

*Tabela 11 Importi dhe eksporti i mbetjeve në Shqipëri*

Mbetjet	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
	Njësia ton			
<b>Importi</b>	4,192	207,690	333,553	60,194
<b>Eksporti</b>	99,683	34,744	53,798	33,413

Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve bashkiake në territorin e Bashkisë Vau-Dejës, jemi mbështetur në metodologjinë e INSTAT për të dhënat e popullsisë në çdo km<sup>2</sup>. Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.7 kg (qytete) dhe 0.4 kg (fshatra). Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara siç janë njësitë administrative Vau-Dejës dhe Bushat. Sasia e gjeneruar në këto dy zona që kanë dhe numrin më të madh të banorëve, arrin vlera 185 - 385 ton/ për km<sup>2</sup> në vit.

Në bashkinë Vau-Dejës trajtimi dhe riciklimi i mbetjeve është ende në hapat e parë.

Raporti i ARM-së mbi gjendjen e mjedisit tregon që zonat rurale nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anë të rrugëve të cilat pastrohen nga ujërat dhe në këtë mënyrë zhvendosen në një pjesë tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore.

Megjithatë, vitet e fundit, vihet re një rritje e numrit të firmave private të cilat operojnë në fushën e riciklimit, por mungojnë të dhënat e sakta në lidhje me sasinë e mbetjeve të ricikluara






Fig. 23 Fluksi i mbetjeve

### 2.1.2.8 Përfundime

Analiza e metabolizmit tregon se si funksionon territori i bashkisë në lidhje me disa nga flukset kryesore të burimeve të tij, nga prodhimi deri në konsumim.

Në territorin e Bashkisë Vau-Dejës energjia diellore është një potencial i pashfrytëzuar. Energjia diellore mund të përdoret kryesisht në mënyrë individuale nëpërmjet kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit dhe paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike por edhe nëpërmjet fermave diellore (centrale fotovoltaike). Në këtë mënyrë ulet sasia e energjisë që shpenzohet aktualisht për ngrohje dhe konsum, që përftohet kryesisht nga energjia elektrike dhe drutë e zjarrit duke ulur ndjeshëm impaktin ndaj mjedisit.

Shpejtësia mesatare e erës luhetet nga 3-3.5 m/s, çka tregon për potencialin e prodhimit të energjisë duke përdorur erën si burim. Nëse të gjitha potencialet që ka Bashkia Vau-Dejës për prodhimin e energjisë përdoren, siç janë energjitë e rinovueshme, sasia e energjisë do të mbulojë një pjesë të mirë të nevojave që ka ky territor për furnizim me energji. Gjithashtu, përdorimi i burimeve alternative mbron mjedisin dhe përdor burimet në mënyrë efikase.

Shërbimi i furnizimit me ujë duhet të shtrihet në të gjithë territorin nën administrimin e bashkisë. Ky shërbim ofrohet më tepër në zonën urbane të bashkisë dhe sistemi i shpërndarjes është konvencional (rrjet tubacionesh), por mund të përdoren edhe puse në zona të caktuara, në këtë mënyrë sigurohet edhe një mbulim më i mirë i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm.

Duke pasur parasysh potencialin që ka Bashkia Vau-Dejës për fluksin e ujit, duhet që shërbimi i furnizimit me ujë të ofrohet në të gjithë territorin, jo vetëm në qendrat kryesore.

Nga fluksi i ushqimit mund të kuptojmë që Bashkia Vau-Dejës është e specializuar në prodhimin e foragjerëve, misrit, grurit. Duke iu referuar edhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme për Vau-Dejën janë: foragjeret dhe drithërat. Kulturat blegtorale me prodhimin më të lartë janë mishi dhe nënproduktet qumështit.

Duhet që mbetjet të diferencohen patjetër që në burim ose në qendrën e përzgjedhjes të integruar brenda venddepozitimit; në këtë mënyrë do të ketë një nivel më të lartë riciklimi. Për këtë pushteti vendor duhet të përdorë stimuj që nxisin procesin e diferencimit të mbetjeve që në burim. Venddepozitimi që ndodhet në njësinë administrative Bushat duhet të mbahet nën kontroll të vazhdueshëm në mënyrë që ndikimi i tij në mjedis dhe tek banorët e zonës të jetë sa më i vogël. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve duhet të ofrohet në të gjithë territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe jo vetëm në disa qendra urbane.

Në përmbyllje, bashkia Vau-Dejës, shfrytëzon në nivele mjaft të ulëta burimet që ka. Këtu i referohemi kryesisht burimeve energjetike dhe hidrike që ofrojnë mundësi zhvillimi të mëtejshëm të sistemit urban dhe ekonomisë. Gjithashtu, prodhimi bujqësor i tejkalon nevojat për ushqim, duke garantuar bazën e zhvillimit të një territori që klasifikohet ndër më pjellorët në rang vendi. Në raport me mbetjet, duhet pasur kujdes që zhvillimi të jetë i balancuar dhe të mirëmenaxhohen kapacitetet e mbledhjes dhe përpunimit të mbetjeve urbane duke nxitur gjithmonë e më tepër riciklimin. Në të njëjtën kohë, duhet pasur kujdes në shmangien e shndërrimit të territorit në venddepozitim për qendrat e mëdha urbane (Shkodra e Lezha) nëse nuk është i mundur përpunimi i plotë i prurjeve nga to dhe nëse kjo nuk gjeneron të ardhura për bashkinë (që do të shkonin në mbrojtjen e mjedisit dhe në zhvillimin ekonomik).

### 2.1.3 Analiza e vlerësimeve demografike

Ky studim ka për qëllim ndërtimin e disa supozime rreth proceseve demografike dhe drejtimit që ka marrë në vitet e fundit zhvillimi urban në Bashkinë Vau-Dejës, të cilat mund të merren si referencë në strategjinë e zhvillimit dhe planifikimit rajonal.

Ky studim, limitohet nga mungesa e të dhënave të hollësishme, duke u mbështetur tek të

dhënat bazë të grumbulluara dhe të paraqitura në raportin e fazës së parë, të cilat janë të përmbledhura këtu dhe të komentuar në këndvështrimin e supozimeve dhe hipotezave interpretuese duke iu referuar proceseve më të përgjithshme që prekin vendin.

### 2.1.3.1 Të dhëna mbi popullsinë dhe lëvizjet natyrore e hapësinore

Bashkia Vau Dejës, e përbërë nga 6 njësi administrative që shtrihen në 468 km<sup>2</sup>, është një pjesë përbërëse e qarkut Shkodër. Sipas të dhënave të Censurit 2011, popullsia e bashkisë Vau-Dejës (duke përfshirë të gjitha njësitë administrative të saj) rezulton në 30 438 banorë, ndërsa sipas të dhënave të regjistrit të gjendjes civile të vitit 2015, rezultojnë 49 399 banorë. Mbi bazën e këtyre të dhënave llogaritet dendësia 65 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit, ndërsa sipas Regjistrit të gjendjes civile dendësia është 105.6 banorë/km<sup>2</sup>.

Njësitë administrative të Bushatit dhe Vau Dejës kanë numrin më të lartë të popullsisë rezidente për njësi. Vetëm në Bushat jeton 48% e popullsisë së bashkisë, ndërsa popullsia që jeton në Bushat dhe Vau Dejës përbën 73% të popullsisë totale të bashkisë. Katër njësitë e tjera administrative kanë numër shumë të vogël të popullsisë; popullsia totale e tyre përbën vetëm 27% të popullsisë së bashkisë.

*Tabela 12 Të dhënat e popullsisë*

Njësi Administrative	Bushat	Hajmel	Shllak	Temal	Vau-Dejës	Vig Mnelë	Total
Popullsia Census 2011	14 149	4 430	671	1 562	8 117	1 509	30 438
Popullsia Census 2011 në %	46.48	14.55	2.2	5.13	26.67	4.96	100
Dendësia e përafërt e popullsisë sipas censurit (banorë/km <sup>2</sup> )	140	118	11	14	90	21	65
Popullsia Gjendja Civile 2015	23 834	6 300	1 899	2 520	12 669	2 177	49 399
Popullsia Gjendja Civile 2015 në %	48.25	12.75	3.84	5.1	25.65	4.41	100
Dendësia e përafërt e popullsisë sipas gjendjes civile (banorë/km <sup>2</sup> )	240	200	26	26	128	30	105.6
Diferenca e popullsisë midis dy të dhënave	9 685	1 870	1 228	958	4 552	668	18 901

Arsyeja e paraqitjes së të dhënave të ndryshme nga INSTAT-i dhe Regjistri i gjendjes civile janë lëvizjet brenda vendit pas vitit '89, të cilat nuk shoqëroheshin gjithmonë me procedurat e regjistrimit në Regjistrin e gjendjes civile të zonës ku vendoseshin. Gjithashtu, edhe dukuria e emigracionit ndikon në mosparaqitjen e gjendjes reale të popullsisë.



*Tabela 13 Ndryshimi i popullsisë (INSTAT)*

Njësia Administrative	Bushat	Hajmel	Shllak	Temal	Vau-Dejës	Vig Mnelë
Popullsia Census 2011	14 149	4 430	671	1 562	8 117	1 509
Ndryshimi i popullsisë 1989 – 2011 në %	-38.2	-12.4	-78.3	-98.7	-84.9	-59.3
Ndryshimi i popullsisë 2001 – 2011 në %	-17.7	-18.2	-44.7	-8.3	-13.9	-52

Duke studiuar shifrat e lëvizjes së popullsisë në 3 censuset e fundit vihet re që popullsia ka pasur një rënie të vazhdueshme me tendencë ngadalësimi në vitet e fundit.

Rënia e popullsisë në periudhën 1989-2001 ka rezultuar mesatarisht rreth 13.2% në vit, me një lëvizje të përgjithshme prej -82% (rreth 17 000 banorë).

Rënia e popullsisë në periudhën 2001-2011 ka rezultuar mesatarisht rreth 2.23% në vit, me një lëvizje të përgjithshme prej -20% (rreth 7 600 banorë).

Referuar në të dhënat e INSTAT mbi qarkun Shkodër, vihet re një vijimësi e rënies së popullsisë në periudhën 2015-2016 me -1.37%

Bazuar në të njëjtat të dhëna mbi qarkun Shkodër, vihet re një vijimësi e rënies së popullsisë gjatë vitit të fundit (2016-2017) me -1.07%

Duke analizuar trendet e mësipërme vihet re se largimi nga territori i popullsisë është një fenomen në rënie të vazhduar, çka dëshmon konsolidimin në tërësi të bashkisë në kontekstin e zhvillimit të përgjithshëm. Pritshmëritë janë që edhe për disa vite rënia e popullsisë të vijojë e më pas të kemi stabilizim, ndoshta dhe rritje brenda një harku 15 vjeçar.

Bazuar në të dhënat e Regjistrimit Civil për periudhën 15 vjeçare (2000-2015) popullsia lokale është rritur me 6.7% (mesatarisht 0.43% në vit). Rritja më e madhe ka ndodhur përgjatë viteve 2005-2010, ndërsa gjatë viteve 2010-2015 reflektohet një rritje mesatare prej 0.07% në vit.

*Tabela 14 Popullsia 2000-2015 (Bashkia Vau-Dejës)*

Njësitë administrative	Viti 2000	Viti 2005	Viti 2010	Viti 2015	Diferenca 2000-2015	Shtesa e pop. 2000-2015 %
Bushat	21 425	22 332	23 454	23 834	2 409	11.24
Vig Mnelë	2 495	2 450	2 421	1 717	-778	-31.18
Temal	2 530	2 460	2 389	2 520	-10	-0.4
Shllak	1 783	1 553	1 767	1 899	116	6.51
Hajmel	6 050	6 227	6 541	6 760	700	11.6
Vau-Dejes	12 033	12 312	12 660	12 669	636	5.29
Total	46 316	47 334	49 232	49 399	3 083	6.66

Megjithëse këto të dhëna kundërshtojnë ato të INSTAT, fenomeni është i shpjegueshëm përmes dukurisë të emigrimit që ka vijuar të jetë intensiv ndërkohë që popullsia fiktive në regjistrin e gjendjes civile rritet.

Gjithsesi nëse i referohemi të dy trendëve njëherazi, shifrat e popullsisë janë drejt stabilizimit dhe në rast vijimësie të zhvillimit të territorit do të kemi një popullsi konstante me tendencë për rritje natyrore me ritme të ulëta.

Të kuptuarit e dinamikës së popullsisë mbetet tregues i rëndësishëm për zhvillimet në të tre nivelet, lokal, rajonal dhe kombëtar. Treguesit e lindshmërisë dhe vdekshmërisë përbëjnë faktorët bazë për të vlerësuar trendin e popullsisë. Për vendin tonë, migrimi i brendshëm dhe emigrimi, përbëjnë faktorë shumë të rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë për të kuptuar ndryshimet demografike ndër vite, që në fund të fundit përkthehen në transformime të forta hapësinore.

Migrimi i brendshëm ka ndodhur nga zonat periferike drejt qendrave urbane dhe zonave me akses kundrejt infrastrukturës. Frenimi i zhvendosjeve masive të popullsisë në rang vendi në fundin e viteve '90 solli edhe reduktimin e popullsisë së ardhur nga zonat e thella. Në përmbledhje mund të themi se Bashkia Vau-Dejës ka tendenca për reduktim të lehtë të numrit të popullsisë në vitet e ardhshme ndonëse ky reduktim është me ritmet më të ulëta në 27 vitet e fundit. Edhe për një periudhë disavjeçare, parashikohet të vazhdojnë lëvizjet e brendshme të popullsisë nga zonat e thella drejt qendrave ekonomike, atyre të shërbimeve dhe infrastrukturës.




Fig. 24 Koeficienti bruto i lindjeve (INSTAT, Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2016)

Për qarkun e Shkodrës, koeficienti bruto i lindjeve (raporti i lindjeve për 1000 banor të një territori, në një vit të dhënë) për vitin 2015, sikurse duket nga grafiku i mëposhtëm, është më i ulët sesa mesatarja kombëtare e lindjeve.

Nga analiza e të dhënave të INSTAT në 22 vite ('89-'11), del se popullsia është në rënie, mesatarisht me rreth 2.23 % në vit dhe kjo është një dukuri me perspektivë zvogëlimi. Shtesa natyrore e popullsisë deri në vitet 90' ka qenë e lartë falë politikave sociale dhe ritmeve të larta të lindshmërisë të shoqëruara nga ulja e vazhdueshme e treguesve të vdekshmërisë. Pas viteve '90 vihet re një ulje e ndjeshme e nivelit të lindjeve. Shkak kryesor është migracioni i theksuar për moshën 20-35 vjeçare, ndryshimi i mentalitetit dhe ndryshimi i nevojës për krahë pune në bujqësi.

Lëvizja hapësinore e popullsisë karakterizohet nga dy forma tradicionale të saj: migracioni i brendshëm dhe emigracioni jashtë kufijve të vendit. Kjo lëvizje e popullsisë dhe të gjitha hapat e zhvillimit ekonomik të zonës me ulje-ngritjet e saj, janë reflektuar dhe në punësimin e familjeve me grup-moshë aktive.

Gjithashtu mbas viteve 90' ka ndikuar dhe lëvizja e lirë e njerëzve për t'u punësuar në rrethinat më të zhvilluara brenda vendit, sidomos në qytetet e mëdha dhe në rajonin Tiranë-Durrës. Kjo u shoqërua me lëvizje të ndjeshme të popullsisë me prurje nga zonat e thella që u zhvendosën drejt Shkodrës dhe Lezhës. Lëvizje ka pasur edhe brenda territorit të bashkisë, ku banorët e zonave të thella janë spostuar kryesisht në Bushat, Hajmel, Vaun e Dejës dhe në territore me akses të lehtë në aksin kombëtar Tiranë – Shkodër. Ky fenomen ka qenë dhe vazhdon të jetë aktiv. Ka lëvizje të njerëzve nga fshatrat e thella, drejt fshatrave të cilat janë më pranë zonave me përparësi urbane dhe nga qendrat e vogla urbane, drejt qyteteve më të mëdha, që ofrojnë më shumë mundësi punësimi dhe jetë sociale.

Vau - Dejës, si gati gjithë Shqipëria, ka më shumë se 20 vjet që është përfshirë nga eksodi i orientuar drejt qyteteve, zonave fushore dhe jashtë kufirit të Shqipërisë. Kjo ka të bëjë sa me burimet e pakta natyrore (në disa njësi), apo me pamundësinë e shfrytëzimit të tyre si duhet, aq edhe me shkallën e ulët të zhvillimit ekonomik-shoqëror të disa territoreve. Banorët janë në kërkim të një jete më të mirë, veçanërisht për fëmijët e tyre, mundësive të rritjes së prodhimit bujqësor, mundësive më të mira për punësim e për shanse më të favorshme. Infrastruktura e sotme: rrugët, rrjeti elektrik dhe ai ujësjellës, shkolla, qendrat shëndetësore, qendrat kulturore dhe argëtuese, janë zhvilluar në mënyrë jo të njëtrajtshme në territorin e vendit, duke krijuar diferenca të ndjeshme dhe nevojën e natyrshme për migrim.

#### 2.1.3.2 Projeksioni i popullsisë

Analizat dhe vlerësimet në vijim, bazohen në faktorët e mëposhtëm:

- a. parashikimet e prirjes demografike sipas të dhënave të INSTAT;
- b. vlerësimi i kërkesave të mëparshme për banim ;

- c. shqyrtimi i ndërtimeve për banim, të realizuara vitet e fundit (2007-2015);
- d. kapaciteti i ngarkesës së territorit, duke nënkuptuar disponueshmërinë e tokës, ujit, kapaciteti i sistemeve aktuale urbane për të menaxhuar prodhimin e mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme nga vendbanimet aktuale të banimit dhe nga ato të parashikuara për të ardhmen;
- e. strategjia e përgjithshme e planit, që synon të rrisë dendësimin dhe forcimin e vendbanimeve ekzistuese, sidomos në qendrat kryesore urbane, dhe atyre me akses të mirë në infrastrukturë, duke ruajtur zonat, malore e bujqësore nga konsumi mëtejshëm i tokës.

Aktualisht lëvizjet e popullsisë nga zonat rurale apo të thella drejt qyteteve dhe zonave fushore e bregdetare, për Bashkinë Vau-Dejës, janë duke u stabilizuar dhe pjesa më e madhe e zonave të banuara po shkojnë drejt konsolidimit. Rol pozitiv në këtë aspekt luan dhe procesi i legalizimit të ndërtimeve informale në rang vendi.

Projeksioni i popullsisë u bë duke tentuar një vijë të mesme mes të dhënave të INSTAT-it dhe atyre nga regjistri civil i Bashkisë Vau-Dejës. Përtej vlerësimit të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migrimit ndërkombëtar, problemi i projeksioneve mbetet një detyrë e vështirë për parashikimet e të ardhmes.

Në hartimin e projeksioneve u analizua edhe tendenca e zhvillimit të territorit dhe lëvizjet demografike sidomos ato të 25 viteve të fundit. Nisur nga luhatjet e popullsisë sipas fazave të zhvillimit, mendohet se skenarët e pritshëm të ndryshimit të popullsisë janë në varësi të zhvillimit ekonomik të vendit në përgjithësi dhe bashkisë në veçanti.

- Në rastin e një zhvillimi apo rritjeje ekonomike, popullsia mbetet e njëjtë ose pëson një rritje të lehtë
- Në rastin e një regresioni ekonomik popullata ka prirjen të tkurret e të zhvendoset në qendra me aktivitet më të lartë ekonomik

Pavarësisht të dhënave kontradiktore për popullsinë, duke u nisur edhe nga elementë të tërthortë tregues (femrat në moshë fertile: 49.37%) dhe analiza të treguesve, si konkluzion mund të themi se në një skenar zhvillimi, rritja e popullsisë prej 0.15% në vit mendohet reale, e qëndrueshme dhe pjesë e një modeli të besueshëm, si rrjedhim, popullsia e Bashkisë Vau-Dejës, në vitet 2030 do të jetë mes 31,200 dhe 50 500 banorësh, me një mesatare të pranueshme prej 41,000 banorësh.

#### 2.1.4 Objektivat e përgjithshme për 5 sistemet territoriale (natyror, ujor, bujqësor, infrastrukturor, urban)

Analizat e pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe rreziqeve (SWOT) të kryera në faqet e mësipërme, së bashku me analizën metabolike dhe marrjen parasysh të kufizimeve dhe

kushteve të transformimeve ekzistuese ose që janë për t'u përcaktuar, çojnë në konceptimin e objektivave të përgjithshme specifike për secilin sistem territorial, të shoqëruara me imazhe dhe përshkrime që lokalizojnë, aq sa është e mundur, këto objektiva, dhe paraqesin, në terma të "vizionit" të sektorit, gjenden e pritur nga Plani për secilin prej tyre.

Skedat dhe hartat e paraqitura në faqet në vijim, qartësojnë kuptimin e përgjithshëm të kësaj metode, që është pikërisht ndërtimi i një liste, sa më gjithëpërfshirëse, të këtyre objektivave, pikërisht në lidhje me analizat e mëparshme. Çdo objektivi i përgjithshëm i sistemit është krijuar për të promovuar dhe për të fuqizuar pikat e forta tashmë ekzistuese, për të minimizuar apo reduktuar pikat e dobëta (faktorët e brendshëm të sistemit territorial), për të shfrytëzuar sa më mirë mundësitë dhe për të zbutur rreziqet e pranishme (faktorët e jashtëm të sistemit territorial).

Ky përpunim i Planit në komponentin e vet programues i paraprin përcaktimit të elementeve që përbëjnë vizionin strategjik të përcaktuar në paragrafin vijues, i cili e anashkalon dallimin sipas sistemeve "territoriale", për të konceptuar një strategji të përgjithshme të artikuluar sipas "objektivave/çështjeve" të përgjithshme (1. KATEGORITË BAZË 2. LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME 3. QENDRAT URBANE 4. TURIZMI 5. BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT, 6. ENERGJIA) dhe më pas sipas "programeve", të menduara si objektiva specifike, dhe projekte, dhe formon gjithashtu një bazë të mundshme krahasimi për përzgjedhjen e projekteve strategjike, prioritetin e tyre dhe vlerësimin të efikasitetit të parashikuar dhe faktik të tyre.

Duket të qartë se ajo çfarë e karakterizon, apo duhet të karakterizojë një "projekt strategjik" dhe prioritetin e tij, është natyra e tij e integruar, aftësia e tij, d.m.th. për t'iu referuar, për të gjetur motivimin e tij në disa "objektiva të përgjithshme" të sektorëve të veçantë territorialë. Një projekt i mirë strategjik është në fakt ai, si në rastin e projektit të Parkut Rajonal Lumor (shih faqet në vijim), që synon në të njëjtën kohë, të promovojë objektivat e përgjithshme si të sistemit ujor, edhe ato natyrore, infrastrukturore dhe gjithashtu të bujqësisë).

Në fazën e tretë të këtij studimi do të paraqiten mënyrat me të cilat objektivat e përgjithshme të sektorit vihen në kontakt me sistemin e vlerësimit të projekteve dhe veprimeve të tjera të promovuara ose të krijuara nga Plani.

Këtu parashtrohet se si kjo temë përbën një rast për rinovimin e instrumenteve urbanistikë, si në nivelin lokal ashtu edhe në nivelet e mësipërme. Vlerësimi i projekteve, që është gjithashtu dhe mbi të gjitha vlerësim i efektivitetit të projekteve, sjell si veprim fillestar, të paktën verifikimin e koherencës në lidhje me një sistem objektivash, të përgjithshëm dhe sektorialë, tashmë të përcaktuar në brendësi të Planit. Një vlerësim i tillë, siç tregojnë shembujt

ndërkombëtar me interes - për shembull platforma Open Coesione<sup>2</sup> e organizuar nga Departamenti për Kohezionin Territorial i Ministrisë Italiane të Ekonomisë dhe Financave: <http://www.opencoesione.gov.it> mund të përfitojnë më pas edhe nga sistemet komplekse të treguesve të mirëqenies së popullsisë, më shumë se sa nga treguesi i vjetër dhe joefikas PBB (GDP), mbi të cilin është aktiv kërkimi në shumë vende të zhvilluara.

Një përcaktim i mundshëm i këtyre treguesve të mirëqenies lokale mund të përbëjë një eksperimentim të mundshëm për Planin në fjalë, që duhet të zhvillohet në bashkëpunim me Universitetet shqiptare dhe ndërkombëtare. Sinjalizohet akoma, në lidhje me këtë, eksperiencia pranë institutit italian të statistikave (ISTAT), në lidhje, pikërisht, me BES<sup>3</sup> (tregues të mirëqenies së barabartë dhe të qëndrueshme), që përfshijnë bashkë me institutin e statistikave kombëtare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave edhe strukturat e saj të kërkimit.

për informacion: [https://it.wikipedia.org/wiki/Benessere\\_equo\\_e\\_sostenibile](https://it.wikipedia.org/wiki/Benessere_equo_e_sostenibile))

dhe <http://www.opencoesione.gov.it/dati-istat-di-contesto/>

#### 2.1.5 Strategjia territoriale për secilin nga pesë sistemet territoriale të Bashkisë Vau-Dejës (N, U, B, UB, IN)

Strategjia territoriale, është shtjelluar për secilin sistem territorial në listat e objektivave strategjike të sektorit, përcaktimi i të cilave bëhet edhe në bazë të rezultateve të analizës SWOT të secilit sistem.

Përmbledhja krahasuese e rezultateve të analizës SWOT, shoqëruar me listën e këtyre objektivave, sqaron këtë marrëdhënie dhe formon bazën për përcaktimin e projekteve që plotësojnë dhe japin rezultatin faktik të Planit Strategjik për Bashkinë Vau-Dejës.

---

<sup>2</sup> OpenCoesione është portali mbi realizimin e projekteve të financuara nga politikat e kohezionit në Itali. Janë të konsultueshme të dhëna mbi burimet e caktuara dhe shpenzimet, lokalizime, fushat tematike, subjekte programuese dhe aktivizuese, afati i realizimit dhe pagesat e projekteve të veçanta. Kështu, të gjithë mund të vlerësojnë se si shfrytëzohen burimet në lidhje me nevojat e territorit. Të dhënat e publikuara janë përditësuar në 31/10/2016 dhe i referohen 101.480 subjekteve.

<sup>3</sup> Mirëqenia e barabartë dhe e qëndrueshme (BES) është një tregues, i zhvilluar nga ISTAT dhe CNEL, për të vlerësuar progresin e një shoqërie jo vetëm nga ana ekonomike, siç bën p.sh. PBB, por edhe nga ana sociale dhe mjedisore dhe e shoqëruar me masa të pabarazisë dhe qëndrueshmërinë.



Në vijim paraqiten direktivat e përgjithshëm të zhvillimit për secilin nga pesë sistemet territoriale.

#### 2.1.5.1 Sistemi Natyror (N)

- Mbrojtja dhe zgjerimi i biodiversitetit të territorit.
- Lidhja e Parkut Kombëtar të Alpeve me Peizazhin e Mbrojtur Bunë-Velipojë, nëpërmjet luginës së Drinit duke krijuar një korridor të lundrueshëm, natyror e peizazhistik mal-det.
- Zbutja dhe ulja e ndikimit të vendbanimeve ekzistuese urbane brenda dhe përreth zonave natyrore të mbrojtura.
- Zvogëlimi progresiv dhe zhdukja e niveleve aktuale të ndotjes së lumenjve / liqeneve, në harkun kohor të dy dekadave.
- Rritja e zonave pyjore në zonat kodrinore e malore.
- Promovimi i turizmit natyror, lundrimit dhe të ekskursionit.
- Ndërtimi dhe menaxhimi i rrjetit ekologjik territorial, si një lidhje strukturore midis zonave me vlerë dhe pasuri të madhe të biodiversitetit.




Fig. 25 Harta e sistemit natyror



- Promovimi dhe përgatitja e instrumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të zonave me interes mjedisor.
- Zbutja dhe ulja e ndikimit të zonave dhe objekteve industriale dhe të minierave ekzistuese brenda dhe përfaqëson zonave urbane.
- Bashkimi dhe homogjenizimi i sistemeve të mbrojtjes mjedisore, që shpeshherë rezultojnë të mbivendosura dhe të vështira për tu kuptuar dhe zbatuar.

#### 2.1.5.2 Sistemi Ujor (U)

- Ruajtja dhe mbrojtja e burimeve dhe rezervave natyrore hidrologjike.
- Rigjenerimi i trupave ujorë kryesore, në të mirë të ekosistemeve lokale dhe të një zhvillimi të mundshëm të turizmit sportiv.
- Zhvillimi i lundrimit (transportit), të turizmit sportiv dhe peshkimit.
- Modernizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rrjeteve të shpërndarjes lokale.
- Ruajtja, modernizimi dhe rritja e kapacitetit prodhues të hidrocentraleve.
- Forcimi i sistemit të menaxhimit dhe shpërndarjes së ujit publik, i parë si një nga të mirat/resurset e përgjithshme.
- Krijimi i një Autoriteti Publik Menaxhimi të burimeve ujore, në njohjen e zonave homogjene territoriale, si një mjet kontrolli dhe menaxhimi të cilësisë.




Fig. 26 Harta e sistemit ujor

### 2.1.5.3 Sistemi Bujqësor (B)

- Promovimi dhe zhvillimi i modernizimit dhe inovacionit në sektorin e industrive vendase dhe në sektorin e integritit të zinxhirëve të strukturave të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit.
- Promovimi dhe zhvillimi i prodhimit cilësor në sektorin bujqësor, blegtoral dhe pyjor (produktet e Zadrimes).
- Përmirësimi i aftësive sipërmarrëse dhe profesionale të punëtorëve në sektorin e bujqësor dhe pyjor.
- Promovimi i metodave të kultivimit biologjik dhe të permakulturës.
- Konvertimi për përdorim bujqësor, i zonave të degraduara dhe të braktisura.
- Rinisja dhe mbështetja e aktivitetit blegtoral pyjor në zonat kodrinore, në lugina dhe zonat malore të brendshme, të kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore (çaj mali etj.), të eterovajorëve, të kultivimit të peshkut, si dhe të bletarisë.
- Rinisja dhe mbështetja e aktivitetit blegtoral, në zonat fushore e bujqësore blegtorale, në zonat kodrinore dhe ato malore.




Fig. 27 Harta e sistemit bujqësor

- Riorganizimi dhe zhvillimi i strukturave mbështetëse për aktivitetin bujqësor, të tilla si shoqëritë (konsorciumet) bujqësore për shërbim dhe trajnime, për fermat e vogla dhe të mesme.
- Rivendosja në punë e rrjetit të kanaleve të vaditjes e kullimit të tokave bujqësore, gjë e cila do shërbejë edhe si një masë mbrojtëse nga përmbytjet.
- Zhvillimi i ndërtimit të objekteve të logjistikës për mbledhjen, ruajtjen, ngrirjen dhe shpërndarjen e produkteve ushqimore vendore, mbi bazë të konsorciumit dhe/ose kooperativës.
- Promovimi i krijimit të qendrave të kërkimit dhe trajnimit në agrobiznes dhe edukimit në mirë ushqimin, madje edhe në shkolla dhe fushën e arsimit (shkolla profesionale Bushat).
- Promovimi i ngritjes e shpërndarjes territoriale të strukturave akomoduese (struktura agro-turizmi, B&B ekologjike, ferma didaktike, fshatra ekologjike) dhe të restoranteve cilësorë që valorizojnë produktet dhe traditat ushqimore vendase, si dhe peshkimin dhe kultivimin e peshkut.

#### 2.1.5.4 Sistemi Urban (UB)

- Nxitja e rikuperimit dhe rivitalizimit të qendrës historike të qytetit të Vau-Dejës si dhe qendrave të vogla urbane apo monumenteve historike, nëpërmjet përdorimit turistik.
- Fuqizimi i aktiviteteve akomoduese dhe shërbimeve plotësuese për turizmin kulturor, mjedisor, sportiv (aktiv), ujqor, në zonat urbane të Vau-Dejës, pranë fshatrave Nënshat, Vig, Koman, në zonën me interes natyror, peizazhistik dhe mjedisor të luginës së Drinit, si dhe në fshatrat e zonave të thella malore.
- Përshtatja sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kategorive të urbanizimit kryesor (rrjetet kryesore) në zonat urbane dhe në vendbanimet informale të legalizuara
- Përshtatja sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të pajisjes me shërbime urbane dytësore (arsim, struktura publike, gjelbërim dhe parkim) në zonat urbane kryesore
- Zhvillimi i shërbimeve të reja urbane në Vau-Dejës, Mjedë, Bushat, Rranxë, Barbullush, dhe Hajmel dhe lokalitetet e tjera të mëdha urbane (qendra formimi dhe aftësimi, biblioteka dhe mediateka lokale).
- Zhvillimi i sistemeve me lëvizje urbane alternative (pista biçikletash, rrjete pedonale) të integruara me sistemin e transportit publik automobilistik dhe hekurudhor
- Racionalizimi dhe zgjerimi i rrjetit të rrugëve automobilistike, të integruar me sistemin e parkimeve urbane dhe territoriale.



- Rimëkëmbja dhe ripërdorimi, si një korridor transporti me lëvizje të shpejtë, i linjës ekzistuese hekurudhore, në përputhje me rimëkëmbjen e saj si një infrastrukturë e rëndësishme kombëtare; rehabilitim ky, i parashikuar edhe në PPK.
- Nxitja e qasjes, përdorimit dhe shkëmbimit të resurseve urbane të përbashkëta (Urban Commons) për të gjithë qytetarët, me vëmendje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.
- Garantimi i qyteteve dhe të mirave të përbashkëta të aksesueshme, të sigurta dhe që arrijnë drejtpërdrejtë të fëmijët (Qyteti mik i fëmijëve).




Fig. 28 Harta e sistemit urban

### 2.1.5.5 Sistemi Infrastruktural (IN)

- Garantimi i efikasitetit dhe funksionimit të plotë të rrjetit infrastrukturor me karakter kombëtar (korridorit kombëtar) nëpërmjet ndarjes së trafikut lokal, realizimit të kryqëzimeve të rrafshëta dhe mbikalimeve të rrjeteve lokale, transformimi progresiv në autostradë.
- Zhvillimi i polit të lëvizjes plurimodale dhe ndërlidhjes Mjedë – Vau-Dejë (hekurudhë, rrugë automobilistike, lundrim, korsi biçikletash, shtigje këmbësore)
- Krijimi i një rrjeti transporti ujor publik dhe funksional

- Rimëkëmbja dhe zhvillimi i rrjetit hekurudhor kombëtar, për lidhje ndërkombëtare si dhe për përdorim urban dhe lokal.
- Rimëkëmbja dhe zhvillimi i stacioneve hekurudhore, si pikat aksesi dhe shërbimi të qendrave të banuara, dhe si pika të lidhjes me rrjetin e korridoreve të gjelbër, të cilët realizojnë ndërveprimin ndërmjet zonës bregdetare dhe asaj malore.
- Krijimi i një qendre logjistike strategjike, e lidhur me hekurudhën dhe korridorin infrastrukturor.
- Zhvillimi dhe konsolidimi i rrjetit të parkimit në nivel territorial, urban dhe lokal.
- Zhvillimi i një rrjeti rrugor me lëvizshmëri të ngadaltë, të lidhur me rizbulimin e vendeve dhe peizazheve me interes natyror, kulturor dhe arkeologjik, etno-antropologjik, agroushqimor cilësor (rrugët e vajit, verës, prodhimeve lokale)
- Zgjerimi dhe përmirësimi sistemeve aktuale operative dhe menaxhimi i ciklit të mbeturinave të ngurta urbane.
- Fuqizimi i rrjeteve urbane teknike, në veçanti rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve.
- Kontrolli dhe nxitja për kursimin e energjisë dhe për rikuperimin/ ripërdorimin/ riciklimin e mbetjeve të ngurta komunale dhe menaxhimin e pikave të grumbullimit.




Fig. 29 Harta e sistemit infrastrukturor



- Forcimi dhe zhvillimi i rrjeteve të telekomunikacionit dhe jo-materiale, si në nivel territorial (rrjetet satelitore), ashtu edhe në nivel urban (rrjeti wireless), të instaluara në qendrat kryesore.
- Zhvillimi dhe fuqizimi i rrjetit të infrastrukturës energjetike, me vëmendje ndaj ndikimeve të shkaktuara (ndotja elektromagnetike) dhe zhvillimi i burimeve të rinovueshme energjetike.
- Zhvillimi i sistemeve të prodhimit energjetik nga burime të rinovueshme në fushën urbane dhe në mbështetje të impianteve industriale ekzistuese dhe të aktiviteteve ekonomike kryesore urbane.

## 2.2 VIZIONI STRATEGJIK

### 2.2.1 Koncepti territorial

Planifikimi urban me karakter strategjik bazohet shpesh në përdorimin e një koncepti territorial në fazën e tij fillestare. Koncepti territorial është një ideogramë që qëndron në bazë të procesit të hartimit të vizionit, me qëllimin e dyfishtë të:

- Qartësimin për palët në procesin e planifikimit se cilat janë zgjedhjet strategjike të vëna në themel të programit të zhvillimit
- Nisjes së një ballafaqimi të mundshëm me bashkëbiseduesit dhe grupet e interesit duke u nisur nga një ide sintetike për organizimin e hapësirës territoriale.



*Fig. 30 Pamje ajrore e qendrës urbane Vau-Dejës*

Për rastin në fjalë, territori në kompetencën e Bashkisë Vau-Dejës, mund të interpretohet si i përbërë nga dy zona homogjene të dallueshme qartë: një zonë fushore e karakterizuar nga aktivitet bujqësor dhe me vendbanime urbane të përhapura dhe tjetra malore e karakterizuar nga një përdorim i ulët njerëzor i territorit.

Zona fushore përshkohet nga infrastruktura kryesore me karakter kombëtar (rruga Tiranë-Shkodër dhe hekurudha) dhe akomodon qendrat kryesore urbane (Vau-Dejës, Bushat, Hajmel, Barbullush). Zona malore mbizotërohet nga prania e liqeneve artificiale dhe infrastrukturat e hidrocentraleve.

Nga pikëpamja e potencialit të zhvillimit të territorit (resurset e pranishme dhe ndjeshmëria e sistemit lokal) është e padiskutueshme se zona fushore është e prirur për riorganizimin e aktivitetit bujqësor dhe ajo malore për zhvillimin e turizmit mjedisor. Por, në rastin e parë zhvillimi i bujqësisë duhet të krijojë një marrëdhënie të dyanshme dhe sinergjike me fuqizimin e qendrave urbane. Në rastin e dytë, zhvillimi turistik duhet të gjejë forma bashkëjetese inovative me shfrytëzimin energjetik të resurseve ujore.

Pra, mundemi të sintetizojmë si vijon konceptin territorial që do të shërbejë si bazë e vizionit strategjik të PPV-së.

Në zonën fushore:

- Riorganizimi dhe zhvillimi i aktivitetit bujqësor, nëpërmjet vlerësimit të resursit terren dhe implementimit të resursit punë;
- Përforcimi i qendrave urbane, që kanë intensitet në aktivitetin urban por që mund të transformohen edhe në pole për ofrimin e shërbimeve për territorin përreth;
- Marrëdhënie sinergjike ndërmjet sistemit infrastrukturor dhe aktivitetit prodhues, si bujqësor ashtu edhe turistik.

Në zonën malore:


- krijimi i një korridorit lumor plurimodal dhe multi funksional, si rrugë lidhëse me parkun e Alpeve, me qëllime turistike si dhe lidhjeje territoriale të komuniteteve lokale.
- Rigjallërimi dhe specializimi i rolit funksional të vendbanimeve të pranishme përgjatë korridorit lumor dhe integrimi i resurseve të ndryshme të disponueshme (natyrore, kulturore, historike, arkeologjike, etj.).

Ky koncept i thjeshtë strategjik, përveç identifikimit të sistemit të organizimit të hapësirave dhe funksioneve territoriale, lejon që realiteteve të ndryshme urbane që përbëjnë Bashkinë e Vau-Dejës, t'u përcaktohen role specifike në brendësi të vizionit të zhvillimit:



- qendra territoriale dhe rilindje urbane në njësitë administrative Vau-Dejës, Bushat, Hajmel:
- qendra lokale dhe me veçori turistike në njësitë administrative Vig-Mnelë, Shllak dhe Temal.

Transformimi i konceptit territorial në vizionin strategjik është hapi teknik i radhës i cili, mbi bazën analizave dhe udhëzimeve nga reagimet e komunitetit lokal, do të çojë në përcaktimin e hollësishëm të programit të zhvillimit nga pikëpamja e “objektivave” “programeve” dhe “projekteve” .






Fig. 31 Hartat e vizionit strategjik

## 2.2.2 Objektivat strategjike, programet dhe projektet

Procesi i planifikimit të PPV-së aktuale vepron nëpërmjet identifikimit të “objektivave” strategjike, që shtjellohen në “programe” dhe “projekte”. Objektivat strategjike janë ato përbëjnë dhe përcaktojnë vizionin e zhvillimit, në bazë të rakordimit mes potencialit të identifikuar nga tregu dhe mundësi të vërteta që paraqet territori.

Vizioni i zhvillimit të Vau-Dejës përbëhet nga “objektivat strategjike” vijuese:

### 1 PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË

- 2 LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME
- 3 QENDRAT URBANE
- 4 TURIZMI
- 5 BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
- 6 ENERGJIA

Objektivi i parë strategjik (“Pajisja me shërbimet bazë”) përfshin ato veprime të nevojshme për të pajisur territorin me kushtet minimale të strukturimit dhe funksionimit për të sjellë komunitetin lokal në gjendje për të ndërmarrë rrugën e zhvillimit. Bëhet fjalë për veprime që kryhen për të garantuar infrastrukturën bazë, shërbimet sociale thelbësore, sigurinë dhe gjallërinë. Ai artikullohet në programet e mëposhtme:

- 1.1. Përmirësimi i rrjeteve teknike
- 1.2. Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit
- 1.3. Shërbimet ndaj qytetarëve

Objektivi i dytë strategjik (“Lëvizja me mënyra të ndryshme”) përmban veprime të nevojshme në përmirësimin e lëvizjes, edhe nëpërmjet formave të përshtatshme të integritit të modaliteteve të ndryshme. Kjo artikullohet në programet e mëposhtme:

- 2.1. Rrugët automobilistike
- 2.2. Korridori lumor
- 2.3. Ndërhyrje të tjera për lëvizjen

Objektivi i tretë strategjik (“Qendrat urbane”) synon të ndjekë objektivin për të realizuar në territor pole urbane, të afta për të ofruar funksionet komplekse të sistemit urban. Duke qenë përballë një situatë në të cilën zhvillimi i vendbanimeve ka ndjekur trende spontane dhe jo të udhëhequra, ky objektivi kërkon të krijojë një hierarki funksionale të qendrave të banuara, i konsideruar si kusht thelbësor që struktura urbane të kryejë një funksion aktiv në mbështetje të zhvillimit të komunitetit lokal. Programet që e përbëjnë atë janë:

- 3.1. Pole shërbimi për territorin përreth
- 3.2. Zhvillimi i qendrave lokale
- 3.3. Rikualifikimi urban

Objektivi i katërt strategjik (“Turizmi”) paraqet elemente të zhvillimit socio-ekonomik bazuar në mundësinë e përdorimit për qëllime turistike të burimeve të rinovueshme në territor. Bëhet fjalë për veprime që ndërmerrin për të dhënë vlera potenciale natyrore dhe kulturore që ekzistojnë në territor. Programet në mbështetje të këtij objektivi janë:

- 4.1. Turizmi mjedisor

- 4.2. Turizmi kulturor
- 4.3. Ndërhyrjet e tjera për zhvillimin e turizmit

Objektivi i pestë strategjik (“Bujqësia, blegtoria dhe kultivimi i peshkut”) ka tendencë të zhvillojë potencialin e lidhur me prodhimin primar, të lidhur pikërisht me aktivitetin bujqësor, blegtoral dhe me kultivimin e peshkut. Programet e identifikuar janë:

- 5.1. Strukturat e shërbimit
- 5.2. Rritja e prodhimit

Objektivi i fundit strategjik (“Energjia”) kërkon të përqendrohet në zhvillimin e një ressuri tjetër që është i pranishëm në mënyrë tradicionale në territor, atë të prodhimit të energjisë elektrike. Bëhet fjalë për veprime të ndërmarra për të zhvilluar prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, edhe nëpërmjet diferencimit të cikleve të saj prodhuese. Programet e identifikuar janë:

- 6.1. Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme
- 6.2. Diferencimi i prodhimit të energjisë

Bashkimi sinergjik dhe plotësues i gjashtë objektivave strategjike të identifikuar, konsiderohet i përshtatshëm në përcaktimin e një vizioni të aftë për t’i dhënë komunitetit lokal një rrugë rritjeje dhe zhvillimi, duke u bazuar në efektin shumëfishues të veprimeve të veçanta.

Duke i atribuar veprimeve të ndryshme ndërhyrjet e identifikuar edhe në bazë të analizave në terren dhe fazave të dëgjësive lind një strategji e përgjithshme e hartuar si më poshtë:

*Tabela 15 Ndërhyrjet strategjike sipas objektivave*

OBJEKTIVAT	PROGRAMET	PROJEKTET
<b>1- PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË</b>	1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike	1.1.1 Përmirësimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale 1.1.2 Mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë 1.1.3 Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemit të kanalizimeve 1.1.4 Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza me gropa septike në zonat periferike
	1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit	1.2.1 Sistemi për mbledhjen e mbetjeve të ngurta urbane 1.2.2 Sistemi i pastrimit të rrugëve të qytetit 1.2.3 Realizimi i veprave për mbrojtjen e qendrave të banuara nga përmytjet

OBJEKTIVAT	PROGRAMET	PROJEKTET
	1.3 Shërbimet publike	1.3.1 Shërbimet bazë (kopshte, shkolla fillore, qendrat shëndetësore bazë, kujdesi për të moshuarit) 1.3.2 Shërbimi i autobusëve shkollorë 1.3.3 Përmirësimi i shërbimeve administrative të ofruara 1.3.4 Qyteti mik i fëmijëve
<b>2- LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME</b>	2.1 Rrugët automobilistike	2.1.1 Përmirësim i rrugës Shkodër – Pukë – Kukës 2.1.2 Përmirësimi i rrugës përgjatë rrëzës së maleve 2.1.3 Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës – Bushat-Velipojë - Shëngjin 2.1.4 Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Koman 2.1.5 Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Vig 2.1.6 Përmirësim i rrugës Koman-UkBibaj 2.1.7 Realizimi i bypass-it të Vau-Dejës 2.1.8 Rehabilitim i urës Hajmel
	2.2 Korridori lumor	2.2.1 Realizimi i linjës së transportit uJOR Vau-Dejës – Koman 2.2.2 Lidhja rrugore e stacioneve të trageetit me fshatrat 2.2.3 Kalimi i lumit me zgjidhje të ndryshme në pjesët e territorit të ndara nga lumi
	2.3 Ndërhyrje të tjera për lëvizjen	2.3.1 Stacion shkëmbimi intermodal në Vau-Dejës dhe Mjedë 2.3.2 Përmirësim i dy stacioneve hekurudhore në Mjedë dhe Hajmel 2.3.3 Sistemi i transportit publik Vau-Dejës, Bushat, Barbullush, Hajmel 2.3.4 Realizim i pistave të biçikletave
<b>3- QENDRAT URBANE</b>	3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth	3.1.1 Pol për shërbime turistike, ekonomike, kulturore, shoqërore shëndetësore dhe teknike (Vau-Dejës/Mjedë) 3.1.2 Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë)
	3.2 Zhvillimi i qendrave lokale	3.2.1 Zhvillim i qendrës urbane Vau-Dejës 3.2.2 Zhvillim i qendrës urbane Mjedë 3.2.3 Zhvillim i qendrës urbane Bushat 3.2.4 Zhvillim i qendrës urbane Rranxë 3.2.5 Zhvillim i qendrës urbane Barbullush 3.2.6 Zhvillim i qendrës urbane Koman 3.2.7 Zhvillim i qendrës urbane Hajmel 3.2.8 Zhvillim i qendrës urbane Nënshatë 3.2.9 Zhvillim i qendrës urbane Ashtë 3.2.10 Zhvillim i qendrës urbane Kosmaç 3.2.11 Zhvillim i qendrës urbane Vig 3.2.12 Zhvillim i qendrës urbane Benë

OBJEKTIVAT	PROGRAMET	PROJEKTET
	3.3 Rikualifikimi urban	3.3.1 Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës 3.3.2 Rikualifikim i qendrës urbane Bushat
<b>4- TURIZMI</b>	4.1 Turizmi mjedisor	4.1.1 Park lumor rajonal: krijimi i një korridori të mbrojtur mjedisor mes zonave të mbrojtura të Alpeve dhe Bunës/Velipojës për realizimin e një itinerari turistik 4.1.2 Lidhje funksionale me Planin e Alpeve nëpërmjet ndërhyrjeve për zhvillimin e ekskursionizmit dhe sporteve ujore 4.1.3 Zhvillimi i plazheve dhe rekreacionit përgjatë liqenit 4.1.4 Realizimi i një korridori të gjelbër në lumin Gjadër 4.1.5 Zhvillimi dhe promovim i vlerave turistike të Fushës së Liqethit
	4.2 Turizmi kulturor	4.2.1 Realizim i një itinerari për turizmin kulturor Vig – Sapë – Danjë – Sardë – Koman 4.2.2 Promovim i vlerave arkeologjike të Komanit 4.2.3 Realizim i një itinerari për turizmin energjetik 4.2.4 Projekt për rehabilitimin dhe ruajtjen e ndërtesave tradicionale dhe ansambleve urbane 4.2.5 Projekt ndriçimi skenografik i kështjellave (Sapë, Danjë, Sardë) 4.2.6 Krijimi i një tregu artizanal dhe etnografik për rajonin e Zadrimës, në Vau-Dejës
	4.3 Ndërhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit	4.3.1 Realizim qendrash për agro - turizëm dhe turizëm eno - gastronomik 4.3.2 Projekt për pyllëzimin mjedisor të kodrës së Zefjanës 4.3.3 Projekt për brandimin e prodhimeve lokale 4.3.4 Projekt për koordinimin ndërkufitar me bashkinë Tropojë për zhvillimin e integruar të turizmit
<b>5- BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT</b>	5.1 Strukturat e shërbimit	5.1.1 Realizimi i qendrave agro - ushqimore në Bushat për grumbullimin, magazinimin dhe shpërndarjen e prodhimit.
		5.1.2 Zona tregtare me prodhime me km zero
		5.1.3 Përmirësim dhe zhvillim i rrjetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese në zonat fushore si dhe masat kundër erozionit dhe përmytjeve në zonat malore.
		5.1.4 Organizimi i degës së prodhimit bujqësor dhe blegtoral pranë bashkisë.
		5.1.5 Nxitja e shoqërizimit të punës, domosdoshmëri për rritjen e prodhimit bujqësor.
		5.1.6 Qendër përpunimi, standardizimi, magazinimi për gështenjën dhe eterovajoret në Shllak dhe Temal.



OBJEKTIVAT	PROGRAMET	PROJEKTET
	5.2 Rritja e prodhimit të prodhimtarisë	5.2.1 Zhvillimi i kultivimit të orizit në fshatrat Barbullush, Kukël dhe Dheu i Lehte 5.2.2 Zhvillimi i komplekseve blegtorale në Bushat dhe Vau-Dejës 5.2.3 Zhvillimi i peshkimit dhe rezervateve në Vau-Dejës 5.2.4 Zhvillimi i serave të perimeve në Kosmaç dhe në fshatra të tjera të bashkisë. 5.2.5 Zhvillimi i baxhoje në Hajmel dhe Vig-Mnelë 5.2.6 Zhvillimi i vreshtave në Hajmel ,Bushat, Vau-Dejës, Vig –Mnelë 5.2.7 Asistence Part-Time e veçantë teknike me specialistë të profilizuar për dy asete me rëndësi të bashkisë (shkolla profesionale): <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kultivimi i perimeve në sera</li> <li>• Kultivimi i vreshtave dhe teknologjia e përpunimit të rrushit.</li> </ul> 5.2.8 Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shege në zona kodrinore, në 6-te fshatra me nga 25 ha në bllok. 5.2.9 Park bletësh në Shllak dhe Temal
<b>6- ENERGJIA</b>	6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme	6.1.1 Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë fotovoltaike 6.1.3 Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë së biomasës
	6.2 Diferencimi i prodhimit të energjisë	6.2.1 Modernizim i landfillit të Bushatit nëpërmjet ndërhyrjeve për ripërdorimin, riciklimin, prodhimin e biogazit dhe pyllëzimin e kurorës 6.2.2 Program për nxitjen e realizimit të impianteve për vetëkonsum energjetik

### 2.2.3 Tipologjitë e projekteve strategjike

Qasja inovative urbane, që synon të përftojë një kualitet më të lartë të rezultateve, bazohet në hartimin e bashkërenduar të strategjisë dhe të projekteve operative. Projektimi i zonave të veçanta përcaktohet njëkohësisht dhe në koherencë me vizionin e përgjithshëm strategjik, me synim maksimizimin e bashkëveprimit mes dinamikave të zhvillimit dhe karakterit hapësinor të zonave.

Kjo lidhje e ngushtë mes planifikimit strategjik dhe projekteve operative është kushti kryesor për të siguruar efikasitetin e proceseve dhe cilësinë e rezultateve. Për këtë arsye, Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV), përveç koherencës së kuadrit të përgjithshëm, duhet të përmbajë edhe projektin e zonave të konsideruara me interes strategjik. Projekti i tyre duhet



konsideruar si emblematik dhe si një shembull i drejtimeve të ndryshme që mund të ndiqen për rigjenerimin urban dhe zhvillimin e territorit, gjithashtu duhet të jetë një pikë referimi dhe udhëzues për ndërhyrjet e ardhshme në territor.

Projektet strategjike mund të jenë të llojeve të ndryshme. Edhe pse të gjitha kanë si synim zhvillimin e përgjithshëm të territorit, ato mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme në arritjen e objektivave strategjike.

Në radhë të parë, mund të themi se ekzistojnë projekte që janë të nevojshme për të siguruar kushtet nga ku mund të nisnin proceset e zhvillimit. Këto janë projekte që duhet të kenë si synim pajisjen e territorit me shërbimet bazë, siç janë shërbimet parësore, qëndrueshmëria mjedisore, jetueshmëria e qyteteve (përshtatja e rrjeteve teknike, pastrimi i territorit nga mbetjet urbane, kontrolli i shfrytëzimit të burimeve ujore etj.). Këto lloje projektesh mund t'i quajmë "projekte bazë".

Pastaj qëndrojnë projektet që i dedikohen në mënyre më të veçantë zhvillimit. Këto projekte trajtojnë tematika specifike, brenda sektorëve të përcaktuar si strategjikë, për zhvillimin e komunitetit vendor. Si rregull, këto janë të paktë në sasi por mjaft të rëndësishëm dhe të aftë për të nxitur proceset spontane dhe vetë-financuese të zhvillimit. Këto lloje projektesh mund t'i quajmë "projekte zhvillimi" (dhe mund t'i ndajmë në kategori të ndryshme: projekte infrastrukturore, projekte urbane, projekte prodhimi, e kështu me radhë).

Brenda kategorisë së projekteve të zhvillimit qëndrojnë projekte më të vogla, por shumë të rëndësishme për nivelin e tyre të prioritetit dhe për aftësinë e tyre për të qenë shembull për projektet e ardhshme. Janë projekte shumë të rëndësishme për arsye të shikueshmërisë së tyre dhe aftësisë komunikuese, të cilat marrin rolin e "projekteve pilot".

Në përfundim, projektet strategjike mund ti ndajmë në këto tre kategori:

- Projekte Bazë
- Projekte Zhvillimi
- Projekte Pilot

#### 2.2.3.1 Projektet bazë

"Projektet bazë/parësore" janë ata projekte, që konsiderohen të domosdoshëm për sigurimin e kushteve fillestare për zhvillim. Këto projekte nevojiten për të mundësuar arritjen e atyre kushteve fillestare që konsiderohen të domosdoshme për nisjen e çfarëdo programi zhvillimi, duke siguruar efikasitetin minimale të sistemit territorial, pa të cilën është e pamendueshme nisja dhe nxitja e proceseve të zhvillimit të sistemit prodhues.

Këto projekte kanë të bëjnë me kushtet minimale të funksionimit dhe të jetueshmërisë së sistemit territorial, si për shembull efienca funksionale e sistemit urban, qëndrueshmëria mjedisore e sistemit të transportit, jetueshmëria e sistemit urban etj.

Projektet bazë/parësore, jo domosdoshmërisht kanë përmbajtje “strategjike”, por shpeshherë kanë të bëjnë me pajisjen normale me elementet bazë të një territori. Në fakt, në rastet kur territori paraqet mungesa të mëdha nga pikëpamja e pajisjes me elementët bazë, mund të jetë e drejtë (në mos e domosdoshme) që t’u jepet ndërhyrjeve për zgjidhjen e këtyre mungesave një karakter strategjik.

Në rastin specifik të sistemeve urbane në fjalë, arritja e një gjendjeje minimale të funksionalitetit të territorit është padyshim një para-kusht i nevojshëm për çfarëdolloj programi zhvillimi.

#### 2.2.3.2 Projekte zhvillimi

“Projektet e zhvillimit” janë projektet të mirëfillta me karakter strategjik, të cilave plani kërkon t’iu caktojë detyrën e nisjes së proceseve të zhvillimit të sistemit territorial dhe atij socio-ekonomik.

Bëhet fjalë, në përgjithësi, për projekte që kanë disa karakteristika bazë: i) janë të lidhura ngushtë me potencialin që plani i njeh kontekstit të konsideruar; ii) kanë një rëndësi të lartë dhe aftësi të mëdha nxitëse; iii) prej tyre pritët një impuls i fortë në ndihmë të proceseve të zhvillimit.

Këto projekte përfaqësojnë përgjigjen operative ndaj drejtimit që plani sheh si potencial (ose kërkon të zhvillojë) në një territor të caktuar: i japin forcë potencialeve ekzistuese ose të evidentuara në kontekstin lokal. Është kjo arsyeja pse këto projekte janë të rëndësishme dhe me peshë të madhe, si nga pikëpamja e përqendrimit të resurseve, ashtu edhe nga ajo e pritshmërisë së zhvillimit.

Për shkak të natyrës së tyre të veçantë, këto projekte nuk mund të jenë të shumtë në numër, për të njëjtin territor. Situata me optimale do të ishte që, plani të përcaktojë pak ndërhyrje, pra ato që cilësohen si më prioritare nga administratorët lokalë dhe palët e interesit.

#### 2.2.3.3 Projekte pilot

Në kuadër të projekteve të zhvillimit, është e domosdoshme të identifikohen ata që kanë për detyrë të shfaqin, me fakte, potencialet e zhvillimit të identifikuar për territorin përkatës (“projektet pilot”). Këto ndërhyrje, janë të lidhura ngushtë me strategjinë e zhvillimit të identifikuar për zonën në studim, por janë të një përmase më të vogël, edhe pse me domethënie dhe ndikim të fortë komunikues. Karakteristika kryesore e këtyre projekteve është, që të realizohen shpejt dhe me pak fonde: bëhet fjalë kryesisht për projekte

demonstruese, për të cilat nuk është e nevojshme që të ketë shpenzime të mëdha kapitale, ndërkohë që është e rëndësishme të jenë në gjendje të nisin menjëherë, dhe të jenë në gjendje të tregojnë, sa më shpejt, në kohë të shkurtër, frytet e veprimeve të zhvillimit të identifikuar në planin e propozuar.

#### 2.2.4 Projektet strategjike

Në faqet vijuese paraqiten projektet e përcaktuar në strategjinë e Planit në raport me objektivin e tyre strategjik.

Ky përcaktim i parë i projekteve zhvillohet duke vënë në dukje aspektet e mëposhtme:

- Objektivi
- Programi i përgjithshëm të cilit i përket
- Emërtimi i projektit
- Lokalizimi
- Një përshkrim i shkurtër i vetë projektit
- Të dhëna përmbledhëse (zërat më përfaqësues)
- Rezultatet e pritshme
- Interesat publike dhe private që janë bazë e projektit
- Kostot e realizimit
- Burimet e mundshme të financimit
- Projekte të ngjashme në Shqipëri, së bashku me raste referencë kombëtare ose ndërkombëtare, që përfshihen në referencat bibliografike dhe sitografike.
- Institucionet që lëshojnë lejet e nevojshme për ndërtim
- Shkalla e prioritetit të vetë projektit

Në lidhje me pikën e fundit, është edhe referenca e mundshme me objektivat e përgjithshme të Axhendës së OKB-së 2030, mbi supozimin se respektimi i objektivave të tillë mund të jetë një kusht i favorshëm për konkurrencë në kanalet e financimit të lidhura me kanale ndërkombëtare dhe bashkëpunimi.

Në draftin fillestar të këtij raporti, disa nga pikat e tabelës (veçanërisht ato që kanë të bëjnë me volumet kryesore dhe kostot) janë lënë për një thellim të mëtejshëm të studimit, gjithsesi paraparak për fazën e pjesëmarrjes dhe prezantimit të Strategjisë së Planit përpara palëve të interesuara.

Një fazë e tillë do të përfitojë edhe nga portali WEBGIS i zhvilluar nga grupi i punës, për të favorizuar pjesëmarrje të informuar dhe interaktive për hartimin e kësaj strategjie.

#### **Axhenda 2030**

Axhenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm është një program veprimi për njerëzit, planetin dhe prosperitetin e nënshkruar në shtator 2015 nga qeveritë e 193 vendeve anëtare të OKB-

së. Ajo përfshin 17 objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm – Sustainable Development Goals, SDGs – në një program të madh veprimi me një total prej 169 'objektiva' ose qëllime. Nisja zyrtare e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm përkoi me fillimin e vitit 2016, duke drejtuar botën në rrugën që duhet të ndjekë gjatë 15 viteve të ardhshme: Vendet janë zotuar për t'i përmbushur deri në vitin 2030.

Objektivat e Zhvillimit ndjekin rezultatet e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (Millennium Development Goals) përpara tyre, dhe përfaqësojnë objektiva të përbashkëta të një sërë çështjesh të rëndësishme për zhvillim: lufta kundër varfërisë, eliminimi i urisë dhe lufta për ndryshimin e klimës, për të përmendur vetëm disa.

"Objektiva të përbashkët" do të thotë ato që lidhen me të gjitha Vendet dhe me të gjithë individët: asnjë nuk është i përjashtuar dhe as nuk duhet lënë pas gjatë rrugës së nevojshme për ta çuar botën në rrugën e qëndrueshmërisë.

Burimi:

[http://www.unric.org/it/images/Agenda\\_2030\\_ITA.pdf](http://www.unric.org/it/images/Agenda_2030_ITA.pdf)

<https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>

### **Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm**

- Objektivi 1. Eliminimi i varfërisë së çdo forme dhe kudo
- Objektivi 2. Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë së ushqimit dhe ushqyerje e përmirësuar dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme
- Objektivi 3. Sigurimi i jetesës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat
- Objektivi 4. Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë
- Objektivi 5. Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat
- Objektivi 6. Të sigurohet disponueshmëria dhe menaxhimi i qëndrueshëm i ujit dhe kanalizimeve për të gjithë
- Objektivi 7. Sigurimi i aksesit në energji me çmim të përballueshëm, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë
- Objektivi 8. Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë dhe produktiv dhe punës së denjë për të gjithë
- Objektivi 9. Ndërtimi i infrastrukturës fleksibël, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit
- Objektivi 10. Zvogëlimi i pabarazisë brenda dhe mes vendeve
- Objektivi 11. Të arrihen qytete dhe vendbanime njerëzore përfshirëse, të sigurta, elastike dhe të qëndrueshme
- Objektivi 12. Sigurimi i konsumit dhe modeleve të prodhimit të qëndrueshëm
- Objektivi 13. Të ndërmerren masa urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e saj \*

- Objektivi 14. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillim të qëndrueshëm
- Objektivi 15. Mbrojtja, rivendosja dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta ndaj shkretëtirëzimit dhe ndalimi dhe përmbyjsja e degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit
- Objektivi 16. Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i aksesit për drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet
- Objektivi 17. Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm



Fig. 32 Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

### 2.2.5 Skdat e Projekteve

Skdat e projekteve strategjike paraqiten në Aneksin 1 bashkëngjitur këtij raporti.

### 2.2.6 Strategjia e zhvillimit lokal

Vizioni hapësinor “lokal” evidenton në territor temat e mëdha strategjike të sistemit urbanistik, të nevojshme për përcaktimin e kushteve të favorshme për arritjen e objektivave të zhvillimit. Një sistem urbanistik funksional dhe i qëndrueshëm, si në shkallë territoriale ashtu edhe urbane, është një nga kushtet e domosdoshme për favorizimin e realizimit të programit. Por projektimi i vizionit hapësinor lokal ka nevojë për strategji specifike për t’u realizuar. Këto strategji duhet, nga njëra anë të ndjekin përmbajtjen e propozimit strategjik të

shkallës së gjerë dhe nga ana tjetër të përcaktojnë veçoritë funksionale për territore specifike, por pa krijuar ekskluzivitet funksionesh apo përdorimesh.

Për territorin e marrë në studim, “parakushti” strukturor për nisjen e zhvillimeve strategjike është tejkalimi i mungesave në sisteme dhe infrastruktura ekzistuese. Asnjë program nuk mund të zhvillohet në një territor i cili nuk garanton nivelet minimale të funksionalitetit të sistemeve të tij bazë. Nevoja e përmbushjes së hendeqeve të territorit lokal është një parakusht i pamënjanueshëm për nisjen e programeve të zhvillimit strategjik.

Në këtë kuptim, mund të konsiderohen si strategji të mirëfillta themelore:

- politikat që synojnë zgjidhjen e nyjeve strukturore të komunitetit lokal (përcaktimi i aseteve të pronësisë, rregullat për taksimin lokal, normat për qeverisjen e miratuar të transformimeve);
- programet që synojnë të garantojnë kushtet minimale të funksionimit teknik të vendbanimeve urbane (efiçenca e rrjeteve, efikasiteti i mënyrave të menaxhimit, akses i lirshëm ndaj resurseve);
- ndërhyrjet që kanë për synim garantimin e qëndrueshmërisë së zonave të banuara (vënia në siguri e territorit, mbrojtja e trupave ujore, mbrojtja e resurseve mjedisore);
- projektet që synojnë sigurimin e një sistemi urban të jetueshëm (organizimi i sistemit të transportit, krijimi i qendrave urbane, pajisja me shërbime).

Tabela 16 Strategjitë bazë

<b>STRATEGJITË BAZË (kushtet fillestare për zhvillim)</b>	
Politikat strukturore	Përcaktimi i aseteve të pronësisë
	Rregulla për taksimin lokal
	Norma për qeverisjen e miratuar të transformimeve
Funksionimi teknik	Efiçenca e rrjeteve
	Efikasiteti i mënyrave të menaxhimit
	Akses i lirshëm ndaj resurseve
Qëndrueshmëria e zonave të banuara	Vënia në siguri e territorit
	Mbrojtja e trupave ujorë
	Mbrojtje e resurseve mjedisore
Jetueshmëria e sistemit urban	Organizimi i transportit
	Krijimi i qendrave urbane
	Pajisja me shërbime

Për territorin duhet përcaktuar *misioni* kryesor i programit afatmesëm strategjik të zhvillimit. Bëhet fjalë për përcaktimin e sektorit (ose sektorëve) në të cilët do të investohet në një periudhë afatshkurtër, për të shpresuar që në periudhën afatmesme të konstatohen efektet pozitive që do të kenë aftësinë nxitëse të cikleve të zhvillimit.

Evidentimi i këtyre sektorëve kyçe nuk përjashton mundësinë, që të njëjtat aktivitete të mund të jenë të zbatueshme diku tjetër. Bëhet fjalë për evidentimin e prioriteteve dhe veçorive të secilit territor, të cilat ndihmojnë në orientimin e investimeve publike dhe private.

Së fundmi, strategjia lokale duhet të mbështetet në disa projekte të cilat duhet të jenë të realizueshme në një kohë të shkurtër, me qëllim që të tregojnë aftësinë vepruese të zgjedhjeve të bëra, nëpërmjet disa ndërhyrjeve të cilat do të shërbejnë edhe si shembuj për projektet e ardhshme (projekte pilot).

### 2.2.7 Hartëzimi i projekteve

Hartat vijuese bëjnë një paraqitje fillestare të tërësisë së projekteve strategjike të planit.

Harta e projekteve përmbledh të gjitha projektet e prezantuara, duke vënë në dukje shpërndarjen territoriale.

Imazhe të tilla të sintezës përbëjnë hyrje për materialet e konsultueshme dhe interaktive që do të ekspozohen dhe do të dorëzohen për konsultim publik nëpërmjet portalit WEBGIS të Planit të Përgjithshëm Vendor të ri të Vaut-Dejës.

Ideja është që të hartohet një projekt që mund ndjekë “ndërtimin” e planit nëpërmjet mjeteve të ofruara nga rrjeti, dhe më pas të zhvillohet në një “Observator të Transformimeve Territoriale” në mbështetje të mënyrave moderne të “monitorimit civil” të projekteve nga ana e përdoruesve finalë të këtyre transformimeve, pra për ata që banojnë dhe ruajnë marrëdhënie të interesit lokal me territorin e tyre.






Fig. 33 Harta e projekteve

Mjete të tilla i përkasin një filozofie të re të administratës publike, të njohur si *open-government*<sup>4</sup> sot e favorizuar shumë nga agjencitë e zhvillimit ndërkombëtar dhe në veçanti nga Bashkimi Evropian.

---

<sup>4</sup> “open government” (fjalë për fjalë “qeveri e hapur”) nënkupton një mënyrë të ushtrimit të pushtetit në nivel si qendror ashtu edhe lokal, bazuar në modele, mjete dhe teknologji që




Fig. 34 Parimi i "open government"

## 2.3 PROJEKTET STRATEGJIKE PRIORITARE

### 2.3.1 Zgjedhja e prioriteteve

Një listë shumë e gjerë e projekteve për zhvillimin nuk përfaqëson një zgjedhje strategjike. Nëse një plan propozon të gjitha ndërhyrjet e mundshme që teorikisht përputhen me qëllimet e supozuara pa dhënë një zgjedhje të prioriteteve, nuk mund të konsiderohet të jetë një plan strategjik. "Të bësh strategji" do të thotë të zgjedhësh, domethënë të vendosësh (me vetëdije dhe kolektivisht) se cilat veprime janë më të dobishme në terma të kapacitetit të tyre dhe efektshmërisë në arritjen e objektiveve.

lejojnë administratat të jenë "të hapura" dhe "transparente" drejt qytetarëve. Në veçanti, open government parashikon që të gjitha aktivitetet e qeverive dhe administratave të shtetit duhet të jenë të hapura dhe të disponueshme, për të favorizuar veprime të efektshme dhe për të garantuar një kontroll publik mbi punën: [https://it.wikipedia.org/wiki/Open\\_government](https://it.wikipedia.org/wiki/Open_government)

Në rastin tonë objektivat që përbëjnë vizionin strategjik janë gjashtë:

- 1 PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË
- 2 LËVIZJA ME MËNYRA të NDRYSHME
- 3 QENDRAT URBANE
- 4 TURIZMI
- 5 BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
- 6 ENERGJIA

Ndër këta, nuk ka dyshim që i pari (“Pajisja me shërbimet bazë”), për vetë natyrën e tij specifike që përfshin të gjitha projektet që kanë si synim arritjen e para-kushteve të cilat janë thelbësore për nisjen e zhvillimit të territorit, është ai më urgjenti dhe më i nevojshmi.

Megjithatë ai përmban ndërhyrjet që, për nga natyra e tyre, duhet të kryhen me mjetet “e zakonshme” të programimit dhe shpenzimeve të bashkisë.

Objektivat që sipas gjykimit tonë duhet të konsiderohen prioritare për nisjen e strategjisë së zhvillimit janë, sipas radhës:

- Qendrat urbane (ndërhyrje për rikualifikimin e qendrave kryesore)
- Bujqësia, blegtoria dhe kultivimi i peshkut (ndërhyrje për zhvillimin e aktivitetit prodhues)
- Turizmi (ndërhyrje për zhvillimin e korridorit lumor)

Me fjalë të tjera jemi të bindur se territori në shqyrtim, përveç një parapërgatitjeje të veçantë për zgjidhjen e mangësive bazike, ka nevojë të themelojë projektin e vet të zhvillimit në një ngritje të fuqishme të aftësive të sistemit urban për të luajtur rolin e “qendrës” për territorin përreth, në kuptimin social (hapësira urbane) dhe ekonomike (pole shërbimi), dhe më pas të synojë zhvillimin e sektorëve të prodhimit bujqësor dhe turizmit.

Sipas kësaj logjike duhen konsideruar “projekte strategjike prioritare” (pra që futen në programin afat shkurtër) ndërhyrjet e mëposhtme, që shfaqin koherence me objektivat e parashtruara:

## **QENDRAT URBANE**

### 3.2.1 Zhvillim i qendrës urbane Vau-Dejës

### 3.3.1 Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës

### 3.2.3 Zhvillim i qendrës urbane Bushat

## **BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT**

5.1.1 Realizimi i qendrave agro-ushqimore në Bushat për grumbullimin, magazinimin dhe shpërndarjen e prodhimit

3.1.2 Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë)

5.2.7 Asistence Part-Time e veçantë teknike me specialistë të profilizuar për dy asete me rëndësi të bashkisë (shkolla profesionale):

- Kultivimi i perimeve në sera
- Kultivimi i vreshtave dhe teknologjia e përpunimit të rrushit.

5.2.8 Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shege në zona kodrinore, në 6-te fshatra me nga 25 ha në bllok

## **TURIZMI**

2.2.1 Realizimi i linjës së transportit ujqor Vau-Dejës – Koman

2.1.4 Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Koman

4.2.1 Realizim i një itinerari për turizmin kulturor Vig - Sapë – Danjë – Sardë – Koman

## 3 BURIME FINANCIARE, PLANI I VEPRIMIT

### 3.1 Burimet e disponueshme

#### 3.1.1 Burimet lokale

Disponueshmëria e burimeve financiare të Bashkisë së Vaut të Dejës është vlerësuar në bazë të Parashikimit të Pasqyrave Financiare 2017 (DETAJIMI I BUXHETIT 2017 për THESARIN DHE MINISTRINË E FINANCAVE). Buxheti nuk ka një tepricë operative dhe as rezerva të akumuluar në vitet e mëparshme, për të financuar ndërhyrjet e parashikuara në këtë PPV. Megjithatë, është e qartë nga pasqyrat financiare se komuna ka autoritet të plotë për destinacionin e përdorimit të dy mjeteve: transfertat e pakushtëzuara (fleta nr.2 e Buxhetit) dhe burimet lokale (fleta nr.1 e Buxhetit). Për vitin 2017, transfertat e pakushtëzuara janë 202.644.000 lekë, ndërsa shuma e burimeve lokale për 153.000.000 lekë, për një total prej 357.644.000 lekë. Këto fonde janë tashmë plotësisht të destinuar drejt investimeve dhe projekteve për vitin aktual. Është e mundur që Bashkia mund të ketë një shifër të ngjashme ose më të lartë, në lidhje me fondet për të cilat mund të vendosë lirisht destinacionin si për vitin 2018 ashtu edhe për vitet që vijnë. Këto fonde mund të përdoren, të paktën pjesërisht, për të financuar ose bashkëfinancuar projektet e PPV-së.

#### 3.1.2 Burimet kombëtare

Qeveria vendos në dispozicion të njësive administrative Fondin e Zhvillimit Rajonal (FZHR). Ky fond u krijua në nëntor 2009 me ligjin nr. 10190 dhe që nga viti 2010 ka qenë përdorur për të mbështetur investimet në nivel rajonal dhe lokal. Qasja në financimin nga Fondi është e administruar nga një grant i dhënë sistemit konkurruese (grantet konkurruese). Projektet vlerësohen mbi bazën e një rrjeti të vlerësimit, duke përdorur tregues të ndryshëm dhe rezultatet e tyre përkatëse, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre për prioritetet strategjike të zhvillimit të Njësive Administrative. Një nga kriteret e vlerësimit është prania e bashkëfinancimit nga Bashkia. Ky nuk është një kusht i domosdoshëm pasi mungesa e mundësisë për bashkë-financim nuk është arsye e mjaftueshme për të përjashtuar financimin e një projekti nga ana e FZHR, por prania e tyre është sigurisht një element në avantazhues. Sugjerohet, për këtë arsye, të përdoren fondet lokale, relativisht të pakta, për të bashkë-financuar projektet që do i paraqiten për shqyrtim Fondit të Zhvillimit Rajonal.

#### 3.1.3 Burimet Evropiane dhe Ndërkombëtare

Ka disa programe të ndihmës për zhvillimin e ekonomisë shqiptare, të financuara nga organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndër më të rëndësishmet janë programet e financuara nga Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe Qeveria Italiane.

### **Ndihma nga Banka Botërore**

Banka Botërore dhe qeveria shqiptare kanë themeluar në fillim të vitit 1993, Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një agjenci publike misioni i të cilës është të inkurajojë zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik, të balancuar dhe koheziv në nivel lokal dhe rajonal.

Objektivat kryesore të FSHZH janë:

1. Përmirësimi i infrastrukturës social-ekonomike lokale;
2. Përmirësimi i shërbimeve publike vendore;
3. Forcimi institucional i njësive të qeverisjes vendore;
4. Ndihma për një qeverisje të mirë në nivel lokal;

Kompetencat e FSHZH përfshijnë:

1. Administrimin e projekteve të financuara nga Qeveria shqiptare dhe/ose nga donatorë të ndryshëm të cilët kanë për qëllim të mbështesin zhvillimin ekonomik lokal dhe rajonal;
2. Ndihmën financiare për qeveritë lokale – në forma të tilla si grante, kredi, garanci, etj. – në mënyrë që të përmirësojnë infrastrukturën social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore;
3. Mbështetjen teknike për zbatimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e investimeve që synojnë përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike lokale;
4. Ofrimin e asistencës teknike dhe trajnimin me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale të pushtetit lokal;
5. Realizimin e aktiviteteve të ndryshme në shërbim të zbatimit të politikave dhe instrumenteve për zhvillimin lokal dhe rajonal.

Aktivitetet FSHZH janë të ndarë në linja të ndryshme të veprimit. Projektet e FSHZH aktualisht aktive janë të ndryshme. Ndër këto janë, për qëllimet e PPV-së, projekti IPATECH, i dedikuar për rritjen e sektorit agro-industrial, dhe projekti *Secondary e Local Roads Program* (Programi i rrugëve dytësore dhe lokale) për të mbështetur zhvillimin e rrjeteve rrugore lokale.

### **Fondet nga Bashkimi Evropian**

Në prill të vitit 2009, Shqipëria paraqiti kërkesën zyrtare të saj për anëtarësimin në BE, duke filluar procesin që çoi, në qershor të vitit 2014, Këshillin e Bashkimit Evropian në dhënien e statusit e kandidatit për pjesëmarrjen në Bashkimi Evropian. Duke u mbështetur në këtë



status, Shqipëria ka akses në financimet e parashikuara nga plani i dyte i masave të par-anëtarësimit (IPA II). Ky plan, i cili është pjesë e politikave të pranimit në BE, përfshin periudhën 2014-2020 dhe i dedikon një buxhet prej 11.7 miliardë euro për ndërhyrje në pesë fushat e mëposhtme:

- i) Mbështetje në tranzicionin dhe përforcimet e institucioneve me anën e reformës së Administratës Publike;
- ii) Bashkëpunimi ndërkufitar me shtetet anëtare të BE dhe vendeve të tjera të pranueshme nga IPA (Maqedoni, Turqi, Shqipëri, Mali i Zi, Serbi, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë);
- iii) Zhvillimi rajonal, në aspektin e zhvillimit ekonomik, të transportit dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- iv) Vlerësimi i burimeve njerëzore dhe lufta kundër përjashtimit social dhe varfërisë;
- v) Zhvillimi rural dhe i sistemeve bujqësore.

Në veçanti, Shqipërisë i është çelur një fond prej 649,4 milionë euro për periudhën 2014-2020. Sektorët që konsiderohen si prioritarë nga BE-ja për kreditë e dhëna në këtë fazë të dytë të IPA's janë:

#### 1. Demokracia dhe Qeverisja:

Forcimi i institucioneve demokratike; Reformimi i shërbimit civil dhe ofrimi i shërbimeve publike; Përmirësimi i administrimit të ekonomisë; Përmirësimi i menaxhimit të financave publike;

#### 2. Shteti i të drejtës dhe të drejtat themelore:

Pavarësia dhe efikasiteti i sistemit gjyqësor; Mbështetja e policisë në luftën kundër krimit të organizuar; Luftimi i korrupsionit; Pajtueshmëria me konventat e të drejtave të njeriut.

#### 3. Mjedi dhe veprimet klimatike:

Përafrimi me legjislacionin dhe standardet e BE-së; Përmirësimi i trajtimit të mbeturinave dhe ujit; Kontrollin e ndotjes atmosferike.

#### 4. Transportet:

Përmirësimi i infrastrukturës dhe ndërlidhjes rajonale; Siguria më e mirë rrugore; Ndërveprimi më efikas (përputhshmëri teknike ndërkufitare).

#### 5. Konkurrencë dhe Inovacion:

Mbështetje e konkurrueshmërisë së kompanive shqiptare; Integrimi më i ngushtë me ekonominë e tregut; Zhvillimi i turizmit.

#### 6. Arsimi, punësimi dhe politikat sociale:

Mbështetje për trajnim profesional; Shërbime në mbështetje të punësimit dhe të politikave të tregut të punës; Përfshirja e njerëzve në nevojë; Shërbime shëndetësore dhe sociale efikase

#### 7. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural:

Përmirësimi i aftësisë konkurruese të sektorit agro-ushqimor; Aplikimi i standardeve të sigurisë ushqimore; Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale.

#### 8. Bashkëpunimi rajonal dhe territorial:

Promovimi i rrjeteve rajonale, pajtimi dhe përmirësimi i marrëdhënieve fqinjësore; Inkurajimi i zhvillimit të qëndrueshëm lokal në zonat kufitare.

### **Ndihmat e Qeverisë Italiane**

Qeveria italiane ka ndërmarrë forma të ndryshme bashkëpunimi dhe ndihme të zhvillimit të ekonomisë shqiptare. Me një angazhim total prej 300 milion euro, Italia është sot donatori i parë dypalësh dhe i treti pas Bashkimit Europian dhe Bankës Botërore, me mbi 70 iniciativa aktive. Agjencia e Bashkëpunimit Italian për Zhvillimin është një nga institucionet zbatuese të politikave të tilla, aktive në Shqipëri që nga viti 1991. Sipas Memorandumit të Mirëkuptimit, të viteve 2014-2016, ndërmjet Agjencisë dhe Qeverisë Shqiptare, fushat strategjike të ndërhyrjes janë riorganizuar në përputhje me kornizën e re kombëtare strategjike për zhvillimin e Shqipërisë, në bazë të katër shtyllave kryesore:

1. Programet në mbështetje të rritjes së qëndrueshme, rritje inteligjente dhe përfshirëse nëpërmjet stimujve të konkurrencës dhe inovacionit në sektorët kryesorë të mëposhtme: Zhvillimi ekonomik të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Mbështetje për zhvillimin social, të burimeve njerëzore, përfshirjes dhe kohezionit territorial. Kjo shtyllë parashikon një fazë të dytë të Programit të konvertimit të borxhit, si dhe një program të veçantë në mbështetje të arsimit dhe trajnimit profesional.

3. Veprimet për të mbështetur qeverisjen e mirë, demokratizimin dhe sundimin e ligjit, të cilat ofrojnë ndërhyrje në mbështetje të reformës territoriale dhe administrative në progres dhe antikorrupsionin.

4. Mbështetje Teknike falas, për të gjithë menaxhimin e Planifikimit Vendor sipas një qasje të bazuar në rezultate.

Bashkëpunimi mes qeverisë shqiptare dhe italiane ka çuar edhe në krijimin e "Programit për zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri" (PRODAPS). Ky program mbështet projektet e investimeve të kompanive shqiptare duke lehtësuar qasjen në kredi nëpërmjet një linje të subvencionuar krediti dhe një fondi garancie që menaxhohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Shqipërisë. Deri tani programi ka lehtësuar zbatimin e 109 projekteve të investimeve në kompanitë shqiptare. Këto investime kanë mundësuar krijimin e rreth 1500 vende të reja pune. Ky program i përbashkët i Qeverisë Italiane dhe Qeverisë Shqiptare për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) shqiptare përbëhet prej ndërhyrjeve që synojnë: i) lehtësimin e aksesit në sistemin e kredive bankare; ii) përmirësimin e teknologjive të prodhimit; dhe iii) rritjen e konkurrencës në tregun vendor dhe ndërkombëtar, nëpërmjet inovacionit teknologjik dhe përmirësimin e standardeve të prodhimit. Programi përfshin tre instrumente kryesore financiare: i) një linjë të kredisë prej 25 milion euro ndihmë, si një fond qarkues; ii) një fond garancie prej 2.5 milionë dhe iii) një fond prej 1.7 milionë donacion për Asistencë Teknike.

Janë përfitues të mundshëm të programit të gjitha NVM-të të cilat plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Kompania duhet të regjistrohet në Shqipëri;
- Jo më pak se 51% të kapitalit të shoqërisë duhet të jetë në pronësi të qytetarëve shqiptarëve;
- Kompania nuk duhet të ketë një qarkullim vjetor prej më shumë se 5 milionë euro;
- Kompania duhet të ketë jo më shumë se 250 të punësuar.

## 3.2 PLANI I VEPRIMIT

### 3.2.1 Burimet e shfrytëzueshme

Projektet në të cilat artikuloohen programet e objektivave strategjike të kësaj PPV kanë profile të ndryshme të cilave u korrespondojnë burime të ndryshme të mundshme financimi.

Tre akset e para strategjike – Pajisja me Shërbimet Bazë, Lëvizja me Mënyra të Ndryshme dhe Qendrat Urban – përbëhen kryesisht nga projekte infrastrukturore të financuara nga fondet publike të autoriteteve lokale dhe kombëtare, duke u mbështetur nga Fondi i Zhvillimit Rajonal dhe nga kontributi i programeve ndihmuese ndërkombëtare.

Investimet për Pajisjen me Shërbimet Bazë dhe ndërhyrjet në Qendrat Urbane bëjnë pjesë në ato të parashikuara nga kapitulli 2 i Memorandumit të Mirëkuptimit i viteve 2014-2016 ndërmjet Agjencisë Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Qeverisë Shqiptare: Mbështetje për zhvillimin social, të burimeve njerëzore, përfshirja dhe kohezioni territorial; dhe për këtë arsye mund të përfitojnë nga kontributet qeverisë italiane. Në mënyrë të ngjashme, ndërhyrjet nga 1.1.2 deri nderi në 1.2.3 (Mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të

ujësjellësit, Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemit të kanalizimeve, Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza me gropa septike në zonat periferike, Sistemi për mbledhjen e mbetjeve të ngurta urbane, Sistemi i pastrimit të rrugëve të qytetit, dhe në fund, Realizimi i veprave për mbrojtjen e qendrave të banuara nga përmbytjet) bëjnë pjesë në sektorët prioritarë të destinacionit të ndihmave nga BE-ja me programin IPA II në pikën 3: Mjediti dhe veprimi klimatik. Për këtë arsye mund të përmbushin kushtet për të përfituar nga të ardhura në formë granti të këtij programi.

Një pjesë e shpenzimeve të ndërhyrjeve në rrugët e kalimit të mjeteve automobilistike (GLP) 2.1 do të mbulohet nga dy linjat e ndihmës së huaj. Në fondet e ardhur nga Banka Botërore, nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, bën pjesë edhe ai i programit Secondary and Local Roads (Programi për Rrugët Dytësore dhe Lokale). Ky program, i bashkë-financuar nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë për 400 milionë dollarë, ka për qëllim të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend dhe për të rritur qasjen në shërbime dhe tregje, veçanërisht në zonat rurale, nëpërmjet rehabilitimit të 1500 km të rrjetit rrugor. Përveç kësaj, programi IPA II për periudhën 2014-2020, në hapin 4, *Transportet*, ofron ndihmë për "përmirësimin e infrastrukturës dhe lidhjes rajonale".

Objektivi i katërt strategjik, Turizmi, përbëhet kryesisht nga ndërhyrje të një natyre publike, të tilla si 4.1.1 (Park lumor rajonal: krijimi i një korridori të mbrojtur mjedisor mes zonave të mbrojtura të Alpeve dhe Bunës/Velipojës për realizimin e një itinerari turistik) dhe 4.2.1 (Realizim i një itinerari për turizmin kulturor Sapë – Vig – Danjë – Sardë – Koman), të cilat mund të financohen nga fonde publike dhe ndihmë ndërkombëtare, si ato të tre akseve të para strategjike. Ndërhyrjet që lidhen me shfrytëzimin e burimeve turistike nga ndërmarrjet private, të tilla si, për shembull, pika 2.2.1 (Realizimi i linjës së transportit ujor Vau-Dejës – Koman), mund të realizohet nga financimi i projektit përmes koncesioneve. Projekte të tjera që mund të zbatohen me investimet private, të tilla si 4.3.1 (Realizim qendrash për agro-turizëm dhe turizëm eno-gastronomik), do të promovohet nëpërmjet lehtësimeve tatimore.

Objektivi i pestë strategjik, Bujqësia, Blegtoaria dhe Peshkimi është përqendruar kryesisht në zhvillimin e burimeve bujqësore, agro-industriale dhe agro-turistike. Edhe në këtë rast, ndërhyrjet e planifikuara janë të ndara në dy lloje: projekte infrastrukturore (5.1 Strukturat e Shërbimit) në ushtrimin e plotë të autoritetit publik, si dhe ndërhyrjet produktive (5.2 Rritja e prodhimtarisë) që do të ndërmerren nga investimet private, të mbështetura nga lehtësitë tatimore dhe kredi të subvencionuara. Për më tepër, investimet në bujqësi dhe agro-industri që synojnë transferimin e teknologjisë dhe eksperiencës mund të përfitojnë nga ndihma e propozuar, brenda FSHZH, nga programi IPATECH, qëllimi i të cilit është të forcojë aftësitë në hulumtim dhe inovacion në sektorin agro-ushqimor në mënyrë që të kontribuojnë në konkurrencë dhe që të rrisin zhvillimin e zonës së Adriatikut nëpërmjet bashkëpunimit ekonomik, social dhe institucional.

Së fundi, në sajë të Programit të Qeverisë Italiane për zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri (PRODAPS), ndërhyrjet e financuara nga investimet private, si në sektorin e turizmit dhe agroturizmit ashtu edhe në atë të bujqësisë dhe agro-ushqimor, do të gëzojë kredi bankare në normat e subvencionuara dhe Grantet (Fondi i Dhurimit për asistencë teknike).

### 3.2.2 Plani i veprimit

<b>PLANI I VEPRIMIT PROJEKTET E ZHVILLIMIT – BASHKIA VAU-DEJËS</b>								
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK NR.1: PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË</b>								
Nr	Emërtimi i Projektit	Territori që preket Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preket	Vlera e projektit	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit
<b>Programi: 1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike</b>								
1.1.1	Përmirësimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale	Të gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor		Fondet e bashkisë	Fazat e realizimit të punimeve	Bashkia	
1.1.2	Mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë	Të gjitha njësitë administrative	Turistët		AZHR 1		Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	
1.1.3	Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemit të kanalizimeve	Bushat Vau-Dejës Hajmel	Operatorët tregtarë	Për t'u vlerësuar	Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Aksesueshmëria, numri i automjeteve në transit	ARRSH	
1.1.4	Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza me gropa septike në zonat periferike	Shllak Temal Vig-Mnelë	Sipërmarrje bujqësore			Cilësia e ujërave	Ministria e Zhvillimit Urban	
<b>Programi: 1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit</b>								
1.2.1	Sistemi për mbledhjen e mbeqjeve të ngurta urbane	Të gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor		Fondet e bashkisë	Fazat e realizimit të punimeve	Bashkia	
1.2.2	Sistemi i pastrimit të rrugëve të qytetit	Bushat Vau-Dejës Hajmel	Turistët		AZHR 1		Ministria e Zhvillimit Urban	
1.2.3	Realizimi i veprave për mbrojtjen e qendrave të banuara nga përmblytjet	Vig-Mnelë Bushat Hajmel Vau-Dejës	Operatorët tregtarë	Për t'u vlerësuar	Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Niveli i ndotjes së ambientit		
<b>Programi: 1.3 Shërbimet publike</b>								
1.3.1	Shërbimet bazë (kopshte, shkolla fillore, qendrat shëndetësore bazë, kujdesi për të moshuarit)	Të gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor		Fondet e bashkisë	Fazat e realizimit të punimeve	Bashkia	
1.3.2	Shërbimi i autobusëve shkollor	Të gjitha njësitë administrative		Për t'u vlerësuar	Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Sondazhe të qytetarëve	Ministria e Zhvillimit Urban	
1.3.3	Përmirësimi i shërbimeve administrative të ofruara	Të gjitha njësitë administrative						
1.3.4	Qyteti mik i fëmijëve	Të gjitha njësitë administrative						



OBJEKTIVI STRATEGJIK NR.2: LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME									
Nr	Emërtimi i Projektit	Territori që preket Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preket	Vlera e projektit	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit	
<b>Programi: 2.1 Rrugët automobilistike</b>									
2.1.1	Përmirësimi i rrugës Shkodër-Pukë-Kukës	Vau-Dejës Vig-Minelë Bashkitë Pukë, Shkodër	Komuniteti lokal		Fondet e bashkisë. AZHR 1	Fazat e realizimit të punimeve	Bashkia		
2.1.2	Përmirësimi i rrugës përgjatë rrëzës së maleve	Vau-Dejës Hajmel	Turistët		Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare	Numri i automjeteve në transit	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës		
2.1.3	Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Bushat-Velipojë-Shëngjin	Vau-Dejës Bushat	Operatorët tregtarë	Për t'u vlerësuar	FSZH, (programi rrugë sekondare dhe lokale), IPA II dhe AICS		ARRSH		
2.1.4	Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Koman	Vau-Dejës Shllak Temal Bashkia Pukë	Sipërmarrje bujqësore						
2.1.5	Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Vig	Vau-Dejës Vig-Minelë	Sipërmarrje turistike						
2.1.6	Përmirësimi i rrugës Koman-UkëBibaj	Temal Shllak	Sipërmarrjet e minierave						
2.1.7	Realizimi i bypass-it të Vau-Dejës	Vau-Dejës							
2.1.8	Rehabilitimi i urës Hajmel	Hajmel							
<b>Programi: 2.2 Korridor lumor</b>									
2.2.1	Realizimi i linjës së transportit ujor Vau-Dejës-Koman	Vau-Dejës Shllak Temal Bashkitë Pukë, Shkodër	Komuniteti vendor Turistët	45.000.000 lekë investim fillestar	Investitorë privat për financimin e projekteve	Numri i pasagjerëve dhe automjeteve të kryera	Bashkia		
2.2.2	Lidhja rrugore e stacioneve të tragetit me fshatrat	Vau-Dejës Shllak Temal	Operatorët tregtarë Sipërmarrje bujqësore	Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1	Numri i turistëve Fazat e realizimit të punimeve	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës		
2.2.3	Kalimi i lumit me zgjidhje të ndryshme në pjesët e territorit të ndara nga lumi	Vau-Dejës Shllak Temal Bashkitë Pukë, Shkodër	Sipërmarrje turistike Sipërmarrje e minierave	Për t'u vlerësuar	Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Numri i automjeteve në transit			

Nr	Emërtimi i Projektit	Territori që preket Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preket	Vlera e projektit	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit
<b>Programi: 2.3 Ndërrhyrje të tjera për lëvizjen</b>								
2.3.1	Stacion shkëmbimi intermodal në Vau-Dejës dhe Hjedë	Vau-Dejës	Komuniteti vendor Turistët Operatorët tregtarë		Fondet e bashkisë AZHR 1	Fazat e realizimit të punimeve		
2.3.2	Përmirësim i dy stacioneve hekurudhore në Vau-Dejës dhe Hajmel	Vau-Dejës Hajmel	Sipërmarrje bujqësore	Për t'u vlerësuar	Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSZH, IPA II dhe AICS	Numri i automjeteve dhe pasagjerëve në transit		
2.3.3	Sistemi i transportit publik Vau-Dejës, Bushat, Barbullush, Hajmel	Bushat Hajmel Vau-Dejës	Sipërmarrje turistike					
2.3.4	Realizimi i pistave të biçikletave	Të gjitha njësitë administrative	Sipërmarrje e minierave					

OBJEKTIVI STRATEGJIK NR.3: QENDRAT URBANE								
Nr	Emërtimi i Projektit	Territori që preket Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preket	Vlera e projektit	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit
<b>Programi: 3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth</b>								
3.1.1	Pol për shërbime turistike, ekonomike, kulturore, shoqërore shëndetësore dhe teknike (Vau-Dejë/Mjedë)	Vau-Dejës	Komuniteti vendor Turistët Operatorët tregtarë	Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1 Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Fazat e realizimit të punimeve Sondazhe të qytetarëve	Bashkia Ministria e Zhvillimit Urban	
3.1.2	Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë)	Bushat	Sipërmarrje bujqësore Sipërmarrje turistike					
<b>Programi: 3.2 Zhvillimi i qendrave lokale</b>								
3.2.1	Zhvillimi i qendrës urbane Vau-Dejës	Vau-Dejës	Komuniteti vendor Turistët Operatorët tregtarë Sipërmarrje turistike	Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1 Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Fazat e realizimit të punimeve Sondazhe të qytetarëve	Bashkia Ministria e Zhvillimit Urban	
3.2.2	Zhvillimi i qendrës urbane Mjedë	Vau-Dejës						
3.2.3	Zhvillimi i qendrës urbane Bushat	Bushat						
3.2.4	Zhvillimi i qendrës urbane Rranxa	Bushat						
3.2.5	Zhvillimi i qendrës urbane Barbullush	Bushat						
3.2.6	Zhvillimi i qendrës urbane Koman	Temal						
3.2.7	Zhvillimi i qendrës urbane Hajmel	Hajmel						
3.2.8	Zhvillimi i qendrës urbane Nënshatë	Hajmel						
3.2.9	Zhvillimi i qendrës urbane Ashtë	Bushat						
3.2.10	Zhvillimi i qendrës urbane Kosmaç	Bushat						
3.2.11	Zhvillimi i qendrës urbane Mnelë e Madhe	Vrg-Mhelë						
3.2.12	Zhvillimi i qendrës urbane Benë	Sllak						

PPV Bashkia Vau-Dejës  
Strategjia Territoriale. Vizioni Strategjik, Objektivat e Zhvillimit

Nr	Emërtimi i Projektit	Territori që preket Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preket	Vlera e projektit	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit
<b>Programi: 3.3 Rikualifikimi urban</b>								
3.3.1	Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës	Vau-Dejës	Komuniteti vendor Turistët	Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1	Fazat e realizimit të punimeve	Bashkia	
3.3.2	Rikualifikim i qendrës urbane Bushat	Bushat	Operatorët tregtarë Sipërmarrje turistike		Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Sondazhe të qytetarëve Numri i turistëve	Ministria e Zhvillimit Urban	

OBJEKTIVI STRATEGJIK NR.4: TURIZMI									
Nr	Emërtimi i Projektit	Territori që preket Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preket	Vlera e projektit	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit	
<b>Programi: 4.1 Turizmi mjedisor</b>									
4.1.1	Park lumor rajonal: krijimi i një korridori të mbrojtur mjedisor mes zonave të mbrojtura të Alpeve dhe Buntës/Velipojësis për realizimin e një itinerari turistik	Bushat Vau-Dejës Shllak Temal Bashkitë Tropojë, Shkodër, Pukë, Fushë-Arrëz	Komuniteti vendor Turistët Operatorët tregtarë	Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1 Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtarë FSHZH, IPA II dhe AICS Investime privat (me dhe pa financim të projekteve)	Fazat e realizimit të punimeve Numri i turistëve	Bashkia Ministria e Mjedisit		
4.1.2	Lidhje funksionale me Planin e Alpeve nëpërmjet ndërhyrjeve për zhvillimin e ekskurSIONIZMIT dhe sporteve ujore	Bushat Vau-Dejës Shllak Temal Bashkitë Tropojë, Shkodër, Pukë, Fushë-Arrëz	Sipërmarrje turistike						
4.1.3	Zhvillimi i plazheve dhe rekreacionit përgjatë liqenit	Vau-Dejës Shllak Temal							
4.1.4	Realizimi i një korridori të gjelbër në lumin Gjader	Vau-Dejës Vig-Mhelë							
4.1.5	Zhvillimi dhe promovim i vlerave turistike të Fushës së Liqethit	Shllak Temal							
<b>Programi: 4.2 Turizmi kulturor</b>									
4.2.1	Realizimi i një itinerari për turizmin kulturor Sapë-Danjë-Sardë-Koman	Hajmel Vau-Dejës Temal	Komuniteti vendor Turistët Operatorët tregtarë	Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1 Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtarë FSHZH, IPA II dhe AICS	Fazat e realizimit të punimeve Numri i turistëve	Bashkia Ministria e Kulturës		
4.2.2	Promovim i vlerave arkeologjike të Komanit	Temal	Sipërmarrje bujqësore						
4.2.3	Realizimi i një itinerari për turizmin energjetik	Bushat Vau-Dejës Temal	Sipërmarrje turistike						
4.2.4	Projekt për rehabilitimin dhe ruajtjen e ndërtesave tradicionale dhe ansamble urbane	Bushat							

PPV Bashkia Vau-Dejës  
Strategjia Territoriale. Vizioni Strategjik, Objektivat e Zhvillimit

Nr	Emërtimi i Projektit	Territori që preket Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preket	Vlera e projektit	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit
4.2.5	Projekt ndriçimi skenografik i kështjellave (Sapë, Danjë, Sardë)	Hajmel Vau-Dejës Temal	Komuniteti vendor Turistët Operatorët tregtarë	Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1 Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Fazat e realizimit të punimeve Numri i turistëve	Bashkia Ministria e Kulturës	
4.2.6	Krijimi i një tregu artizanal dhe etnografik për rajonin e Zadrimës, ne Vau-Dejës	Vau-Dejës	Sipërmarrje bujqësore Sipërmarrje turistike					
<b>Programi: 4.3 Ndërhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit</b>								
4.3.1	Realizim qendrash për agro-turizëm dhe turizëm eno-gastronomik	Hajmel Vau-Dejës Bushat	Komuniteti vendor		Fondet e bashkisë AZHR 1 Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Fazat e realizimit të punimeve Numri i turistëve	Bashkia Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	
4.3.2	Projekt për përlëvizim mjedisor të kodrës së Zeifjanës	Bushat	Turistët Operatorët tregtarë	Për t'u vlerësuar				
4.3.3	Projekt për brandimin e prodhimeve lokale	Hajmel Vau-Dejës Bushat	Sipërmarrje bujqësore					
4.3.4	Projekt për koordinimin ndërkufitar me bashkinë Tropojë për zhvillimin e integruar të turizmit	Temal Bashkia Tropojë	Sipërmarrje turistike		Investime private (me dhe pa financim të projekteve)			

OBJEKTIVI STRATEGJIK NR.5: BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT									
Nr	Emërtimi i Projektit	Territori që preket Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preket	Vlera e projektit	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit	
<b>Programi: 5.1 Strukturat e shërbimit</b>									
5.1.1	Realizimi i qendrave agroushqimore në Bushat për grumbullimin, magazinimin dhe shpërndarjen e prodhimit	Bushat	Komuniteti vendor	Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1	Fazat e realizimit të punimeve	Bashkia		
5.1.2	Zona tregtare me prodhime me km zero	Bushat	Turistët	Për t'u vlerësuar	Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II e IPATECH dhe AICS	Numri i turistëve	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave		
5.1.3	Përmirësim dhe zhvillim i rrjetit të kanaleve ujifese dhe kulluese në zonat fushore si dhe masat kundër erozionit dhe përmbytjeve në zonat malore	Bushat Hajmel Vau-Dejës Vig-Minelë Shllak Temal	Operatorët tregtarë	80.000.000 lek	Investime private (me kosto vjetore 8.000.000 lek dhe pa financim të projekteve)	Rritja e prodhimit bujqësor e blegtoral në terma sasiorë dhe cilësorë			
5.1.4	Organizim i degës së prodhimit bujqësor dhe blegtoral pranë bashkisë	Të gjitha njësitë administrative	Sipërmarrje bujqësore	Për t'u vlerësuar					
5.1.5	Nxitija e shoqëzimit të punës, domosdoshmëri për rritjen e prodhimit bujqësor	Të gjitha njësitë administrative		8.000.000 lek					
5.1.6	Qendër përpunimi, standardizimi, magazinimi për gësitë dhe eterovajoret në Shllak dhe Temal	Shllak Temal							
<b>Programi: 5.2 Rritja e prodhimtarisë</b>									
5.2.1	Zhvillimi i kultivimit të orizit në fshatrat Barbullush, Kukël dhe Dheu i Lehte	Hajmel Bushat	Komuniteti vendor	Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1	Fazat e realizimit të punimeve	Bashkia		
5.2.2	Zhvillimi i komplekseve blegtorale ne Bushat dhe Vau-Dejës	Bushat Vau-Dejës	Operatorët tregtarë	Për t'u vlerësuar	Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II e IPATECH dhe AICS	Rritja e prodhimit bujqësor e blegtoral në terma sasiorë dhe cilësorë	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave		
5.2.3	Zhvillimi i peshkimit dhe rezervateve në Vau-Dejës	Vau-Dejës Shllak Temal	Sipërmarrje bujqësore dhe agroturistike	Për t'u vlerësuar	Investime private (me kredo koncesionare dhe me ndihmën e programit PRODAS)				



PPV Bashkia Vau-Dejës  
Strategjia Territoriale. Vizioni Strategjik, Objektivat e Zhvillimit

Nr	Emërtimi i Projektit	Territori që preket Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preket	Vlera e projektit	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit
5.2.4	Zhvillimi i serave të perimeve në Kosmaç dhe në fshatra të tjera të bashkisë	Bushat Vau-Dejës Hajmel		1.000.000 lek për hektarë serrë				
5.2.5	Zhvillimi i baxhove në Hajmel e Vig-Mnelë	Hajmel Vig-Mnelë		Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1			
5.2.6	Zhvillimi i vreshtave në Hajmel, Bushat, Vau-Dejës e Vig-Mnelë	Bushat Vau-Dejës Vig-Mnelë Hajmel	Komuniteti vendor	investim fillestare 500.000.000 lek, për t'u shpërndarë në 10 vjet	Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtarë FSHZH, IPA II e IPATECH dhe AICS	Fazat e realizimit të punimeve	Bashkia	
5.2.7	Asistencë Part-Time e veçantë teknike me specialistë të profilizuar për dy asete me rëndësi të bashkisë: a) Kullivimi i perimeve në sera b) Kullivimi i vreshtave dhe teknologjia e përpunimit të rrushit	Bushat Vau-Dejës Hajmel	Operatorët tregtarë Sipërmarrje bujqësore dhe agroturistike	300.000 lek për vit, kohëzgjatja totale për dy vjet	Investime private (me dhe pa financim të projekteve) Kredi koncesionare dhe me ndihmën e programit PRODAS	Rritja e prodhimit bujqësor e blegtoral në terma sasiorë dhe cilësorë	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	
5.2.8	Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shëgë në zona kodrinore, në 6-të fshatra me nga 25 ha në bllok	Bushat Vau-Dejës Hajmel		82.500.000 lek në 10 vjet				
5.2.9	Park bletësh në Shllak e Temal	Shllak Temal		Për t'u vlerësuar				

OBJEKTIVI STRATEGJIK NR.6: ENERGJIA									
Nr	Emërtimi i Projektit	Territori që preket Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preket	Vlera e projektit	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit	
<b>Programi: 6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme</b>									
6.1.1	Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë fotovoltaike	Bushat Vau-Dejës	Komuniteti vendor Sipërmarje agroturistike	Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1 Kontribute nga programe ndihmëse ndërkombëtare Investime private (me dhe pa financim të projekteve) Kredi koncesionare dhe me ndihmën e programit PRODAS	Fazat e realizimit të punimeve  Kuota e kërkesës energjetike lokale i përbushur nga fonde alternative	Bashkia  Ministria e Energjisë dhe Industrisë		
6.1.2	Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë së biomasës	Bushat Vau-Dejës Hajmel Vig-Mhelë							
<b>Programi: 6.2 Diferencimi i prodhimit të energjisë</b>									
6.2.1	Modernizim i landfillit të Bushatit nëpërmjet ndërhyrjeve për ripërdorimin, riciklimin, prodhimin e biogazit dhe pyllëzimin e kurorës	Bushat	Komuniteti vendor Sipërmarje agroturistike	Për t'u vlerësuar	Fondet e bashkisë AZHR 1 Kontribute nga programe ndihmëse ndërkombëtare Investitorë privat (me dhe pa financim të projekteve) Kredi koncesionare dhe me ndihmën e programit PRODAS	Fazat e realizimit të punimeve  Kuota e kërkesës energjetike lokale i përbushur nga fonde alternative	Bashkia  Ministria e Energjisë dhe Industrisë		
6.2.2	Program për nxitjen e realizimit të impianteve për vetëkonsum energjetik	Të gjitha njësitë administrative							

## 4 ANEKSE

### 4.1 Materiali hartografik

- U/II-01 Harta e Vizionit Lokal të Përgjithshëm
- U/II-02 Harta e Strategjisë së Sistemit Natyror
- U/II-03 Harta e Strategjisë së Sistemit Ujor
- U/II-04 Harta e Strategjisë së Sistemit Bujqësor
- U/II-05 Harta e Strategjisë së Sistemit Urban
- U/II-06 Harta e Strategjisë së Sistemit Infrastrukturor
- U/II-07 Harta e Identifikimi dhe Hartëzimit të Projekteve
- U/II-08 Harta e Projektionit Demografik
- U/II-09 Harta e Fazimit të Projekteve
- U/II-10 Harta e Potencialit Energjetik
- U/II-11 Harta e Konsumit të Ujit
- U/II-12 Harta e Fluksit të Ujit
- U/II-13 Harta e Fluksit të Ushqimit
- U/II-14 Harta e Flukseve

### 4.2 Skedat e projekteve

### 4.3 Konsultat publike gjatë hartimit të PPV